



KOMENTI I SURES

NUR

Titulli i librit: Komenti i sures Nur

Autor: Llukman Neziri

Kryeradaktor: Rafet Zaimi

Redaktor profesional: Prof. Dr. Hajredin Hoxha

Redaktor gjuhësor: Arjan Koçi

Për Botuesin: Bekir Halimi

Botues: NUN

ISBN 978-608-4955-97-9

Tirazhi:1000

Shtypi:

Shtypshkronja "Aj-Graf Matbaa"

rr. Atanas Babata nr. 26 - Shkup

Tel. +389 70 222 557,

e-mail: info@ajgraf.mk

Katalogizimi i librit gjindet në bibliotekën kombëtare në Shkup. © NuN-2022

Shtëpia botuese "NuN"

rr. Petre Georgiev nr. 6.

1000 Shkup/Maqedoni

tel&fax: +389 77 944 911

www.nun.com.mk

nunbotime@gmail.com

LLUKMAN NEZIRI

KOMENTI I SURES
NUR



Shkup, 2022

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِنَّ الْحَمْدَ لِلَّهِ نَحْمَدُهُ وَنَسْتَعِينُهُ وَنَسْتَغْفِرُهُ وَتَعُوذُ بِاللَّهِ مِنْ شُرُورِ أَنْفُسِنَا
وَمِنْ سَيِّئَاتِ أَعْمَالِنَا مَنْ يَهْدِهِ اللَّهُ فَلَا مُضِلَّ لَهُ وَ مَنْ يَضِلَّ فَلَا هَادِيَ
لَهُ وَأَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ
وَرَسُولُهُ،

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُوا إِلَّا وَأَنْتُمْ مُسْلِمُونَ»
(آل عمران 102)

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا
زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ
وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا (النساء 1)

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ
وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا
(الاحزاب 70 - 71)

Falënderimi i takon Allahut, Atë e falënde-
rojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë.
Kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej të këqijave
të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon
Allahu, s'ka kush që e lajthit dhe kë e largon nga
rruga e vërtetë, s'ka kush që e udhëzon. Dëshmoj

se s'ka të adhuruar me meritë përveç Allahut, që është një, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij.

“O ju që keni besuar, kini frikë nga Allahu me një frikë të denjë dhe mos vdisni, pos duke qenë muslimanë!” (Ali Imran, 102)

“O ju njerëz! Kini frikë nga Zoti juaj që ju ka krijuar prej një veteje dhe nga ajo krijoi palën e saj, e prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra. Dhe kini frikë nga Allahu që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisn, se Allahu është Mbikëqyrës mbi ju.” (En-Nisa, 1)

“O ju besimtarë, kini frikë nga Allahu dhe thoni fjalë të drejta. Ai (Allahu) ju mundëson të bëni vepra të mira, jua shlyen mëkatet tuaja, e kush respekton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ka shpëtuar me një shpëtim të madh.” (El-Ahzab, 70-71)

Thënia më e vërtetë është thënia e Allahut, kurse udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Veprat më të këqija janë ato të shpikura, çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat është lajthitje, e çdo lajthitje çon në zjarr...

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

1- سُورَةُ أَنْزَلْنَاهَا وَفَرَضْنَاهَا وَأَنْزَلْنَا فِيهَا آيَاتٍ بَيِّنَاتٍ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ

2- الزَّانِيَةُ وَالزَّانِي فَاجْلِدُوا كُلَّ وَاحِدٍ مِنْهُمَا مِائَةَ جَلْدَةٍ وَلَا تَأْخُذْكُمْ بِهِمَا رَأْفَةٌ فِي دِينِ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَلَيْشَهِدَ عَذَابُهُمَا طَائِفَةٌ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ

مقدمة السورة

HYRJE NË SUREN EN-NUR

Të gjithë dijetarët janë të një mendimi se kjo sure është shpallur në Medinë dhe përbëhet prej 64 ajetesh, ndërsa në Kuran është surja e njëzetekatërt sipas radhës.

Ç'PËRMBAN KJO SURE?

Pikësëpari, nga vetë emri i sures kuptojmë se fjala “**Nur**” në gjuhën shqipe do të thotë **Dritë**. Mbi të gjitha, emri i sures ceket me një cilësi të Allahut të Lartmadhëruar, e ajo është drita.

“**Allahu është dritë e qiejve dhe e tokës**”, e pas kësaj kjo dritë lë gjurmë, ndriçon zemrat dhe shpirtrat,

duke pranuar edukatën dhe moralin me të cilat ngrihet një familje, e ajo është edukata morale personale e familjare dhe bashkëkohore, e cila ndriçon zemrat, ndriçon jetën dhe me këtë lidh dritën në hapësirë të pafundme – dritë në shpirtra – ndriçim në zemra.

Po ashtu, kjo sure përmbledh disa dispozita të përgjithshme, të cilat kanë të bëjnë me familjen dhe aty janë cekur rregullat bashkëshortore, të cilave njeriu duhet medoemos t’u përmbahet, siç janë marrja e lejes për të hyrë në shtëpi, ruajtja e syve nga shikimi, mbrojtja e organit nga imoraliteti, ndalimi i përzierjes mes dy gjinive, po ashtu janë përmendur disa rregulla që duhet t’i përmbajë një familje muslimane: pastërtia, mbulesa dhe mbrojtja nga fenomenet copëtuese dhe nga shkatërrimi i moralit (të familjes).

Në këtë sure (kaptinë) janë cekur disa dispozita të sheriatit, si dispozita e imoralitetit (zinasë), e shpifjes, njëherësh edhe rregullat mbi mallkimin.

Të gjitha këto dispozita janë theksuar për pastrimin e shoqërisë nga çrregullimet dhe nga problemet që kanë të bëjnë me moralin dhe për ruajtjen e shoqërisë islame nga prishjet e moralit dhe nga gjërat që çojnë në shkatërrim, të cilat shkaktojnë humbjen farefisnore dhe humbjen e nderit.

Pra, shkurtimisht, ky kapitull ka shqyrtuar çështjen më kryesore të jetës – e ajo është çështja e familjes.

Imam el-Kurtubiu thotë: “Qëllimi i kësaj sureje është theksimi i rregullave të pastërtisë dhe mbulimi i çështjeve morale.

Nga Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem (transmetohet se ka thënë hjeke se dy here eshte e perseritur transmetohet se ka thënë: “...Mësojuani burrave suren El-Maide dhe mësojuani grave tuaja suren En Nur!”

Omeri radijAllahu anhu banorëve të Kufës (në Irakun e sotëm) u shkroi një letër dhe u tha: u shkroi një letër dhe u tha: “Mësojuani grave tuaja suren En-Nur”.

KOMENTIMI I SURES

1 - سُورَةُ أَنْزَلْنَاهَا وَفَرَضْنَاهَا وَأَنْزَلْنَا فِيهَا آيَاتٍ بَيِّنَاتٍ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ

Fjala sure në gjuhën arabe merr kuptimin e çdo sendi që meriton të ngrihet lart dhe për këtë arsye të gjitha suret e Kuranit e kanë marrë këtë emër, për shkak se e meritojnë të ngrihen lart.

Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj sureje, Allahu ka filluar me këtë emër duke thënë – **Suretun Enzelnaha.**

Në terminologjinë e Kuranit fjala sure merr kuptimin – grup ajetesh që kanë fillim dhe mbarim, si p.sh. *suretu el-Ihlas* etj..

Enzelnaha أَنْزَلْنَاهَا d.m.th. ta kemi shpallur ty, o Muhamed, mirëpo kuptimi i drejtpërdrejtë është: ta kemi zbritur – d.m.th. prej lart (qiell) e deri në tokë, që ta argumentojmë se ky Kuran është zbritur nga Allahu e nuk është shkrim apo thënie e Muhamedit, ashtu si mendonin idhujtarët e Mekës.

Ferednaha وَفَرَضْنَاهَا Muxhahidi dhe Katadeja kanë thënë se kuptimi i kësaj fjale është se Allahu ka sqaruar hallallin dhe haramin (urdhrat, ndalesat dhe dispozitat), gjëra të domosdoshme për zbatimin e tyre.

Dhe ne parashtroam në të argumente të qarta.

وَأَنْزَلْنَا فِيهَا آيَاتٍ بَيِّنَاتٍ

Në mënyrë që të merrni mësim

لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ

2 - الرّٰزِيَةُ وَالزّٰنِي فَاجْلِدُوا كُلَّ وَاحِدٍ مِّنْهُمَا مِائَةً جَلْدَةٍ

2. Laviren dhe lavirin për marrëdhënie të paligjshme t'i rrihni secilin prej tyre nga njëqind kamxhikë.

Pasi Allahu i Lartmadhëruar tregoi për shpalljen e kësaj kaptine dhe e bëri të detyrueshme dhe të domosdoshme zbatimin e këtyre dispozitave, menjëherë ka filluar me rregullat e zinasë (imoralitetit) duke thënë se lavirja dhe laviri në rast se bëjnë zina (imoralitet), çdonjëri prej tyre të rrihet me njëqindë të rëna.

Në qoftë se ndalemi dhe shikojmë me vëmendje, do të shohim se i Lartmadhëruar pikësëpari ka përmendur gjininë femërore duke thënë *laviren*, për shkak se në shumicën e rasteve ato janë shkaktaret kryesore që të tërheqin në zina (imoralitet).

Mirëpo, sipas rregullores së sheriatit në raste të zinasë, duhet pasur parasysh zinaja e atij (e asaj) që është i pamartuar dhe i atij (asaj) të martuar; nëse individi është i pamartuar, dënimi i tij është njëqindë goditje, të cilin e dëshmon ajeti kuranor i lartpërmendur.

Nëse personi është i martuar (e martuar), atëherë dënimi është me gurëzim (deri në vdekje).

Nëse parashtrohet pyetja se për të pamartuarin u bazuam në ajetin kuranor, atëherë ku qëndron argumenti që për të martuarin të gurëzohet?!

Përgjigjen e kësaj e gjejmë:

A – Në ajetin kuranor i cili është fshehur si shkrim, por ka ngelur ligji i tij.

Ky ajet i cili ka qenë në Kuran me këtë citat: “I martuari dhe e martuara, në qoftë se bëjnë zina, gurëzoni deri në vdekje¹”.

وَلَا تَأْخُذْكُمْ بِهِمَا رَأْفَةٌ فِي دِينِ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ

“Dhe në zbatimin e dispozitave të Allahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre dyve në qoftë se besoni në Allahun dhe Ditën e Gjykimit”.

“Mos u tregoni zemërbutë” kur të zbatohet kjo dispozitë ose çdo dispozitë tjetër e Allahut. Nuk duhet të bëhemi zemërbutë për shkak se Allahu është më i butë dhe për këtë shkak ka urdhëruar një dispozitë të tillë, që

1 Në Kuran kemi disa lloje ajetesh:

- a) ajete që janë me shkrim dhe ligjësimi i tyre vazhdon normalisht;
- b) ajete që gjenden me shkrim, por ligjësimi i tyre është shfuqizuar;
- c) ajete që u është abroguar shkrimi, por ka ngelur ligji, p.sh. ajeti i cekur më lart: “I martuari dhe e martuara, nëse kanë bërë amoralitet, duhet të gurëzohen”.

aço vepër e shëmtuar të gjykohet në këtë botë, gjykim i cili është më i lehtë, e të mos ngelë për në botën tjetër, sepse dënimi atje është më i rëndë se në këtë botë”.

Zemërbutësia mund të përdoret derisa çështja të mos ngrihet në gjykatë e muslimani t’ia mbulojë muslimanit turpin, edhe pse është parë.

E nëse ngrihet akuza në gjykatë, patjetër nevojiten katër dëshmitarë të singertë që e kanë parë gjendjen mirë e jo me hamendje, sepse në gjykatë dëshmia duhet të jetë e saktë, përndryshe mund të bjerë dëshmia dhe akuza të kalojë kundër akuzuesit. Nëse çështja ngrihet në gjykatë, atëherë nuk bën të fshihet diçka e as të kryhet ndonjë dënim me rrahje (të zbutet dënimi).

“Nëse jeni nga ata të cilët besoni në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit” – mos bëni gjëra të tilla.

وَلْيَشْهَدْ عَذَابُهُمَا طَائِفَةٌ مِّنَ الْمُؤْمِنِينَ

“Dhe le të dëshmojë një grup prej besimtarëve ndëshkimin e tyre²”.

Për ta urryer një gjë të shëmtuar edhe më shumë, gjatë zbatimit të kësaj dispozite, Allahu i Lartmadhëruar na urdhëron që dënimi të kryhet publikisht, me praninë e një numri besimtarësh.

2 Ajetet me përkthim në gjuhën shqipe janë marrë nga dy përkthyes: Sherif Ahmeti dhe Hasan Nahi.

Sa i përket numrit të besimtarëve, dijetarët janë në dilemë se sa duhet të jetë numri i tyre, ndërsa mendimi më i afërt është prej tre veta e më shumë.

Pra, le të bëhet sa më publike nëpërmjet mjeteve bashkëkohore, që të marrin të tjerët mësim nga ky krim.

3 - الزَّانِي لَا يَنْكِحُ إِلَّا زَانِيَةً أَوْ مُشْرِكَةً وَالزَّانِيَةُ لَا يَنْكِحُهَا إِلَّا زَانٍ أَوْ مُشْرِكٌ

3. “Lavirit nuk i takon të martohet, përveçse me një lavire ose idhujtare, e as lavires nuk i takon të martohet, përveçse me një lavir ose idhujtar”.

Para se të përmendim shkakun e zbritjes së këtij ajeti, vlen të theksohet se Allahu në ajetin e parë në fillim të këtij libri, fillimisht përmendi laviren (gjininë femërore), kurse në këtë ajet Ai përmendi lavirin (gjininë mashkullore), sepse në ajetin e parë gruaja në përgjithësi bëhet shkaktare për nxitje deri te zinaja, plus një gjë e tillë nuk ndodh pa pranimin dhe pa pëlqimin e saj. Ndërkaq, në ajetin e dytë (te dispozitat) përmendi gjininë mashkullore, për shkak se zakonisht, kur çështjet kanë të bëjnë me dispozita, atëherë ajetet fillojnë me burrat, sepse në esencë, rregullat dhe dispozitat i mbajnë burrat.

SHKAKU I ZBRITJES

Sa i përket shkakat të zbritjes së këtij ajeti, dijetarët kanë cekur disa shkaqe, por më afër së vërtetës janë tre shkaqe që do t'i cekim në pika të shkurtra, të cilat janë me transmetime të shëndosha.

Transmetohet se një njeri i ashtuquajtur Merthed el-Ganevij bartte njerëz prej Mekës për në Medinë. Në Mekë ishte një grua lavire e ashtuquajtur Anake, e cila ishte shoqja e tij në injorancë. Një natë prej netëve, ai kishte premtuar bartjen e një njeriu prej Mekës për në Medinë dhe kështu duke shkuar për tek ai njeri, ishte takuar me këtë lavire dhe në terrin e natën i kishte thënë: “A je Merthedi?” Tha “Po.” “Mirë se vjen, urdhëro sonte ta kalojmë natën bashkë”, ndërsa ky i tha: “Oj Anake, Allahu i Lartmadhëruar e ka bërë haram zinanë!”

Kur u ktheva në Medinë, e pyeta Pejgamberin duke i thënë:

“O i Dërguari i Allahut, a të martohem me Anaken?” Pejgamberi heshti, nuk iu përgjigj. Allahu i Lartmadhëruar shpalli ajetin kuranor:

“Laviri nuk bën të martohet, përveçse me një lavire apo idhujtare...” dhe Resulullahu ma lexoi mua këtë ajet e pastaj më tha: “O Merthed, mos u marto!”

(Transmeton Tirmidhiu, Ebu Davudi dhe Nesaiu)

2. Imam Ahmedi transmeton nga Abdullah ibën Omeri se një njeri nga besimtarët kërkoi leje nga Resullullahu, alejhi selam, që të martohej me një grua që quhej Umi Mehzul, e cila bënte zina (prostitucion) dhe e kishte kushtëzuar që ajo t'i mbulonte shpenzimet e martesës.

Pejgamberi alejhi selam ia lexoi këtë ajet kuranor

“Laviri nuk bën të martohet përveçse me një lavire apo idhujtare...”

Dijetarët islamë të ky ajet kuranor janë thelluar shumë, duke i komentuar gjerësisht këto dispozita. Nga e gjithë kjo mund të themi se lavirja ose laviri mendojnë se një gjë e tillë është e përjetshme dhe vazhdojnë me një bindje të tillë, mirëpo në rast pendimi, atëherë atij individ i falet dhe ky emër i shlyhet.

Por, nëse një besimtar a besimtare bën një vepër të tillë, ai individ nuk e merr këtë emër pasi ai në vetvete e di se një vepër e tillë është e ndaluar ose e shëmtuar.

Allahu i Lartmadhëruar një vepër të shëmtuar e ka barazuar me të njëjtën masë, madje edhe më të poshtër, duke thënë se laviri nuk duhet të martohet tjetër përveçse me një lavire a idhujtare, se atij nuk i takon as gruaja e krishterë apo ajo çifute, por një idhujtare, që është shkalla më e ulët e njerëzimit.

Kjo vazhdon për të dyja gjinitë me të njëjtat dispozita.

وَحُرِّمَ ذَلِكَ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ

“Dhe një gjë e tillë është e ndaluar për besimtarët”.

Dijetarët islamë këtë pjesë të ajetit e kanë komentuar në dy mënyra:

1. Zinaja e lartpërmendur është e ndaluar-haram për besimtarët.

2. Martesa me lavire të tilla është e ndaluar-haram për besimtarët. Kuptohet që nëse pendohen me pendim të sinqertë, ky emër bie prej tyre.

4 - وَالَّذِينَ يَرْمُونَ الْمُحْصَنَاتِ ثُمَّ لَمْ يَأْتُوا بِأَرْبَعَةِ شُهَدَاءَ فَاجْلِدُوهُمْ ثَمَانِينَ جَلْدَةً وَلَا تَقْبَلُوا لَهُمْ شَهَادَةً أَبَدًا وَأُولَئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ

4. “Ata të cilët bëjnë shpifje ndaj grave të ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, të rrihen me nga tetëdhjetë kamxhikë, tani prej tyre mos e pranoni dëshminë më kurrë. Të tillët janë të pabesueshëm”.

Para se të vazhdojmë me këtë, të ndalemi pak në pjesën e parë të ajetit, ku Allahu i Lartmadhëruar ka përmendur gjininë femërore (shpifja ndaj grave të ndershme). Por, nëse vallë ndodh e kundërta?! Është e njëjta gjë, mirëpo Allahu e ka përdorur këtë metodë duke

pasur parasysh shumicën, sepse gratë në përgjithësi janë ato ndaj të cilave shpifet.

Le të vazhdojmë me komentimin e ajetit. Nëse ata shpifin për gratë e ndershme dhe në atë rast nuk sjellin katër dëshmitarë, dënohen me tetëdhjetë të rëna. Përndryshe, atyre kurrë më nuk u pranohet dëshmia e të tillët janë mëkatarë të pabesueshëm.

Allahu i Lartmadhëruar duke e ditur se sa precizitet kërkon kjo çështje (dëshmia) dhe sa korrekt duhet të jetë njeriu, ka përcaktuar disa kushte për dëshmim.

Fillimisht ai duhet të sjellë katër dëshmitarë. Në të gjitha dispozitat e tjera ka kërkuar nga dy dëshmitarë, përveç zinasë ose shpifjes.

Me fjalë më të qarta, kur bëhet fjalë për nderin e muslimanëve, Allahu i Lartmadhëruar ka kërkuar katër dëshmitarë, që do të thotë se edhe pse e sheh (zinanë) me sytë e tu, duhen edhe tre dëshmitarë të tjerë ose duhet të heshtësh.

Islami na mëson mospublikimin apo mosshfaqjen e krimit, të mëkatit dhe të së keqes, për hatër të palëve, edhe të mëkatarit edhe të shoqërisë. Kjo nuk nënkupton hile apo dredhi.

Mëkatet personale nuk bëhen publike dhe kjo çështje mbetet mes njeriut dhe Zotit xh.sh..

Por në atë moment kur bëhet publik një mëkat dhe ekzistojnë provat dëshmuese, atëherë këtu duhet

ekzekutimi ligjor për hir të Allahut e të shoqërisë, përndryshe e kap dënimi si vijon:

1. të rrihet me tetëdhjetë të rëna (kamxhikë),
2. dëshmia e tij nuk pranohet më kurrë
3. përgjithmonë është i pabesueshëm (nuk i beson më askush - mëkatar).

Disa komentues të Kuranit thonë se shkak i zbritjes së këtij ajeti është shpifja që bënë ndaj Aishes, radijAllahu anha, besnikes, bijës së besnikut dhe gruas së Resulullahut, sal-lAllahu alejhi ve selem, mirëpo e vërteta është ajo që ka përmendur imam El-Kurtubiu, po ashtu edhe Taberiu, se ky ajet është i zbritur përgjithësisht për shpifjen dhe nuk ka të bëjë aspak me ngjarjen e Aishes, radijAllahu anha, një ngjarje (shpifje) që theu kurrizet e besimtarëve në atë kohë dhe që do të ceket në ajetet e ardhshme.

5 - إِلَّا الَّذِينَ تَابُوا مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ وَأَصْلَحُوا فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ

5. “Me përjashtim të atyre që më vonë pendohen dhe përmirësohen, vërtet Allahu është që shumë fal e mëshiron”.

Për këtë ajet dijetarët kanë rënë në dilemë lidhur me atë se shpifësit a i pranohet dëshmia pas pendimit të tij apo jo.

Grupi i parë kanë thënë se po qe se ai pendohet, dëshmia i pranohet dhe i hiqet emri a titulli mëkatar dhe i pabesueshëm, pasi pendimi e shlyen mëkatin, sado i madh qoftë.

Grupi i dytë thonë se ata janë mëkatarë të përhershëm, duke u bazuar në fjalën e Allahut të Lartmadhëruar në ajetin e katërt:

“Mos ua pranoni më dëshminë kurrë!”

Këtu Allahu i ka cilësuar se janë mëkatarë përgjithmonë e për atë arsye nuk u pranohet dëshmia.

Mendimi më i saktë është mendimi i grupit të parë. Argumenti i këtij grupi është se Allahu i Lartmadhëruar ka cekur ajetin e pendimit, pas ajetit që i cilëson ata si mëkatarë të përhershëm.

إِلَّا الَّذِينَ تَابُوا مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ وَأَصْلَحُوا فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ

“Me përjashtim të atyre që më vonë pendohen dhe përmirësohen, vërtet Allahu është që shumë fal e mëshiron”.

Ndërsa mendimtarëve të grupit të dytë u thuhet kuptimi i ajetit: **“Ata janë mëkatarë të përhershëm”** – d.m.th. përderisa ata nuk pendohen dhe vazhdojnë në mendime të tilla, e nëse pendohen, atëherë pendimi e shlyen kufrin, e lëre më mëkatin.

Këtë mendim e përkrahin shumica e dijetarëve, në mesin e tyre El-Kadij Shurej, Ibrahim en-Nehiu, Hasan el-Basriu, Said ibën Xhubejri, Sufjan eth-Thevrij, Ebu Hanifja etj..

6 - وَالَّذِينَ يَرْمُونَ أَزْوَاجَهُمْ وَلَمْ يَكُنْ لَهُمْ شُهَدَاءُ إِلَّا أَنْفُسُهُمْ فَشَهَادَةُ أَحَدِهِمْ أَرْبَعُ شَهَادَاتٍ بِاللَّهِ إِنَّهُ لَمِنَ الصَّادِقِينَ

6. “Ata të cilët shpifin gratë e veta dhe nuk kanë dëshmitarë përpos vetvetes - dëshmia e tyre është që të dëshmojë katër herë në Allahun se ai është prej tyre që thotë të vërtetën...”

7 - وَالْحَامِسَةُ أَنَّ لَعْنَتَ اللَّهِ عَلَيْهِ إِنْ كَانَ مِنَ الْكَاذِبِينَ

7. “E në të pestën herë të thotë: “Mallkimi i Allahut qoftë mbi atë, nëse ai është gënjeshtar”.

Pasi Allahu ka përmendur shpifjen e grave të ndryshme në përgjithësi, vlen të ceket edhe ajo që mund të ndodhë edhe në rrethin më të ngushtë, d.m.th. në gratë e tyre (apo te familjet) e tyre. Sa u përket shpifjeve ndaj grave në përgjithësi (jashtë familjes), me këtë rast patjetër duhet të sillen katër dëshmitarë. Por, si të sillen katër dëshmitarë në shtëpi a në familje, gjë e cila pa dyshim është shumë e vështirë, sepse si t’i thërrasësh katër dëshmitarë duke u thënë: “Ejani dhe shihni a dëshmoni se çfarë po ndodh në shtëpinë ose në familjen time”?

Për këtë, mëshira dhe drejtësia e Allahut bëri që kjo dispozitë e sheriatit të shndërrohet në dëshmi individuale.

SHKAKU I SHPALLJES SË KËTIJ AJETI

Buhariu, Tirmidhiu dhe Ibën Maxhe transmetojnë nga Ibën Abasi, radijAllahu anhu, se “Hilal ibën Umeje ka akuzuar gruan e tij për tradhti me Sherik ibën Sahmaën dhe shkoi te Pejgamberi, alejhi selam, i cili i tha: “Ke argument (sqarim) për atë që thua apo dënimi është mbi shpinën tënde?” Ndërsa ai tha: “O i Dërguari i Allahut. Në qoftë se ndokush prej nesh sheh njeri te gruaja e vet, a i duhet argument (sqarim)?” Kurse Pejgamberi, alejhi selam, sërish ia përsëriti të njëjtën fjalë: “Sqarim në atë që po thua apo dënim mbi shpinën tënde.” El-Hilali i tha: “Pasha Atë që të ka dërguar me të vërtetën se unë jam duke thënë një gjë të vërtetë dhe jam i bindur që Allahu do të zbresë diçka që e mbron shpinën time nga dënimi!”

Papritmas Allahu shpalli këtë ajet:

“Ata të cilët akuzojnë gratë e veta dhe nuk kanë dëshmitarë përpos vetvetes - dëshmia e tyre është që të dëshmojë katër herë në Allahun se ai është prej tyre që thotë të vërtetën”.

Pejgamberi, alejhi selam, i thirri këta të dy për në gjykim. Erdhi Hilali dhe dëshmoi katër herë dhe në të pestën herë

tha: “Mallkimi i Allahut qoftë mbi mua nëse jam duke gënjyer”. Në këtë rast Resulullahu, alejhi selam, tha:

“Allahu dëshmon se ndonjëri prej jush është duke gënjyer. A është dikush që pendohet?” Pastaj erdhi edhe ajo (gruaja e tij) dhe dëshmoi. Mirëpo, kur erdhi te hera e pestë për të thënë “Hidhërimi i Allahut qoftë mbi të në qoftë se gënjen”, e ndalën dhe i thanë se është i detyrueshëm (hidhërimi i Allahut). Ajo e ndërroi vendin dhe prapë u ul, derisa (të pranishmit) menduan se do të kthehej (bëhej pishman).

Pastaj tha: *“Nuk e turpëroj fisin tim kurrë dhe vazhdoi (të pestën herë).”* Pejgamberi, alejhi selam, tha: “Vëzhgojeni, në qoftë së lind me sy të kaltër, në anën e pasme i mbushur e me gjunjë të trashë, ai është i Sherik ibën Sahmaut”, dhe ndodhi një gjë e tillë.

Ka të tjera transmetime të ngjashme, por na mjaftojnë, pasi ky është më i vërtetë dhe më i përhapur në librat e tefsireve.

Vlen të ceket se:

1. Kur të vërehet ndonjë grua e huaj duke bërë zina, është më mirë t'i mbulohet ai turp, mirëpo kur ndodh në familje, një gjë e tillë nuk tolerohet për shkak se pas vetes tërheq fillimisht turpin, pastaj përzierjen e fëmijëve ose të fisit etj..

2. Në përgjithësi burri nuk dëshiron ta turpërojë gruan e vet sepse një turp i tillë e përfshin edhe atë dhe

për shkak se është e padurueshme, ndërsa Islami e ka lejuar një gjë të tillë.

3. Pasi të gjykohet, më në fund mallkohen këta të dy (burri dhe gruaja) dhe përnjëherë ndahen dhe nuk u kthehet kurora (nikahu) kurrë, çfarëdo rasti qoftë.

4. Forma e mallkimit – ajetet e Kuranit kanë cekur metodën e mallkimit dhe formën e saj, shumë qartë duke thënë:

“Betohem në Allahun, unë jam i drejtë (besnik) ndaj asaj që po e akuzoj me zina” – dhe në të pestën herë thotë: “Allahu më mallkoftë në qoftë se jam duke gënjyer (ose nuk jam i vërtetë në atë që po e flas).”

Kjo vlen për burrin. Ndërsa për gruan, ajo dëshmon në Allah katër herë duke thënë:

“Dëshmoj në Allahun se ai është duke gënjyer me atë që më shpif për zina” – dhe përfundon me herën e pestë duke shprehur: “Hidhërimi i Allahut qoftë mbi mua, në qoftë se është besnik në atë që më shpif”.

8 – وَيَذَرُ عَنْهَا الْعَذَابَ أَنْ تَشْهَدَ أَرْبَعَ شَهَادَاتٍ بِاللَّهِ إِنَّهُ لَمِنَ الْكَاذِبِينَ

8. “E do të shmanget dënimi nga ajo që akuzon burri i saj, që ajo të dëshmojë katër herë në Allahun se ai (burri i saj) gënjen”.

9 - وَالْحَامِسَةُ أَنَّ غَضَبَ اللَّهِ عَلَيْهَا إِنْ كَانَ مِنَ الصَّادِقِينَ

9. “Dhe në të pestën herë të thotë: “Hidhërimi i Allahut të më godisë mua nëse ai është më të vërtetë”.

Pas kësaj, Allahu ka cekur mëshirën e Tij mbi krijesat e Veta në dispozitat që ka vendosur, për të pasur rrugëdalje nga ajo vështirësi dhe ngushticë duke thënë:

10 - وَلَوْلَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ وَأَنَّ اللَّهَ تَوَّابٌ حَكِيمٌ

10. “Po të mos ishte dhuntia dhe mëshira e Allahut ndaj jush (*shumë gjëra do t'i kishit vështirë dhe të pazgjidhura*), Allahu është Pendues në robërit e Vet dhe i Urtë”.

Në qoftë se ndalemi dhe shikojmë ajetet te mallkimi i burrit ndaj gruas dhe ajetet e gruas ndaj burrit, do të gjejmë një mrekulli kuranore.

“Dhe në të pestën herë të betimit duhet të thotë: “Mallkimi i Allahut qoftë mbi atë nëse ai është gënjeshtar”.

Kurse te mallkimi i gruas thotë:

“Dhe në të pestën herë të thotë: “Hidhërimi i Allahut më goditë mua nëse ai është në të vërtetë”.

Shtrohet pyetja: Pse burrat thonë “Mallkimi i Allahut” kurse gratë “Hidhërimi i Allahut”?

Përgjigjja është se te gjinia mashkullore pak përdoret mallkimi, kurse te gjinia femërore, siç dihet, ato për shumë sende të thjeshta mallkojnë.

Po të kishte qenë edhe këtu mallkimi për gratë, atëherë shumë lehtë do të përbetoheshin. Allahu i Madhëruar tha “hidhërimi” sepse gratë rrallëherë e përdorin një term të tillë, mirëpo mrekullia e Kuranit dhe preciziteti i tij kanë sjellë shprehje sa më korrekte për këtë gjë. Allahu e di më së miri.

11 - إِنَّ الَّذِينَ جَاءُوا بِالْإِفْكِ عُصْبَةٌ مِّنْكُمْ لَا تَحْسَبُوهُ شَرًّا لَّكُم بَلْ هُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ لِكُلِّ امْرِئٍ مِنْهُمْ مَا اكْتَسَبَ مِنَ الْإِثْمِ وَالَّذِي تَوَلَّى كِبْرَهُ مِنْهُمْ لَهُ عَذَابٌ عَظِيمٌ

11. “S’ka dyshim se ata që trilluan shpifjen janë një grup prej jush. Mos e llogaritni këtë dëm për ju, përkundrazi, ajo do të jetë në favorin tuaj. Çdokush prej tyre do të shpërblehet sipas pjesëmarrjes në mëkat. Dhe ai i cili mori më së shumti pjesë në këtë çështje atij do t’i takojë dënimi më i madh”.

Në këtë ajet Allahu i Lartmadhëruar na tregon për një ngjarje të trilluar, e cila i ka tronditur muslimanët

prej momentit të ngjarjes e deri në këto momente dhe do të zgjasë deri në Ditën e Gjykimit.

Është ngjarje tronditëse për atë që e konsideron veten musliman dhe ka një thërrmijë xhelozie, për shkak se këtu është shpifur ndaj gruas së Pejgamberit, alejhi selam, e jo ndaj çdo gruaje, ndaj bijës së Ebu Bekrit, radijAllahu anhu, e jo ndaj çdo bijë, ndaj Aishes, radijAllahu anha, e jo ndaj çdo Aisheje, ndaj nënës së të gjithë besimtarëve, pasi gratë e Pejgamberit, alejhi selam, janë nënat e besimtarëve.

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

النَّبِيِّ أُولَىٰ بِالْمُؤْمِنِينَ مِنْ أَنْفُسِهِمْ وَأَزْوَاجُهُ أُمَّهَاتُهُمْ

“Pejgamberi është më parësor ndaj besimtarëve sesa ata ndaj vetvetes së tyre, ndërsa gratë e tij janë si nënat e tyre”. (El-Ahzab, 6)

Ky ajet na e bën të qartë pozitën e Resulullahut, alejhi selam, te besimtarët, po ashtu edhe të grave të tij, saqë Resulullahu është më parësori se çdokush, kurse gratë e tij janë nënat tona.

Këtu cekim ngjarjen që e transmeton Abdullah ibën Hishami, radijAllahu anhu, i cili tha: “Ishim me Resulullahun, alejhi selam, dhe e kapi për dore Omeri dhe i tha: -O i Dërguari i Allahut, ti je më i dashur për mua se çdo send përveç vetes sime!

Resulullahu, alejhi selam, ia ktheu duke i thënë: -Jo, pasha Atë që shpirti im është në dorë të Tij, derisa të mos jem më i dashur se vetja jote! Omeri ia ktheu: -Nga tani, o i Dërguari i Allahut, je më i dashur edhe se vetja ime! Resulullahu, alejhi selam, ia ktheu: -Tani, o Omer, u kompletua besimi yt! (Transmeton Buhariu).

Këtu shihet pozita e Resulullahut, alejhi selam, te besimtarët.

Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Dashuria e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij është nga obligimet më parësore të besimit, bile është baza e çdo vepre që ka të bëjë me besimin, prandaj Allahu i Lartmadhëruar thotë:

قُلْ إِنْ كَانَ آبَاؤُكُمْ وَأَبْنَاؤُكُمْ وَإِخْوَانُكُمْ وَأَزْوَاجُكُمْ وَعَشِيرَتُكُمْ وَأَمْوَالٌ
اقتَرَفْتُمُوهَا وَتِجَارَةٌ تَخْشَوْنَ كَسَادَهَا وَمَسَاكِينُ تَرْضَوْنَهَا أَحَبَّ إِلَيْكُمْ
مِنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ وَجِهَادٍ فِي سَبِيلِهِ فَتَرْتَصُّوا حَتَّى يَأْتِيَ اللَّهُ بِأَمْرِهِ وَاللَّهُ لَا
يَهْدِي الْقَوْمَ الْفَاسِقِينَ (التوبة 24)

“Thuaj (o i Dërguar): Në qoftë se prindërit, djemtë, vëllezërit, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria që fituat, tregtia që frikësoheni se do të dështojë, vendbanimet me të cilat jeni të kënaqur, (të gjithë këto) janë më të dashura për ju, se Allahu dhe i Dërguari i tij dhe se lufta për në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu ta sjellë dënimin e Tij, Allahu nuk vë në rrugën e drejtë njerëzit të prishur” .

Vlen të ceket se gratë e Resulullahut meqë janë nënat e besimtarëve, Allahu ua ndaloi martesën besimtarëve me gratë e Resulullahut pas vdekjes së Resulullahut.

11 - إِنَّ الدِّينَ جَاءُوا بِالْإِفْكِ عُصْبَةٌ مِنْكُمْ لَا تَحْسَبُوهُ شَرًّا لَكُمْ بَلْ هُوَ خَيْرٌ لَكُمْ لِكُلِّ امْرِئٍ مِنْهُمْ مَا اكْتَسَبَ مِنَ الْإِثْمِ وَالَّذِي تَوَلَّى كِبْرَهُ مِنْهُمْ لَهُ عَذَابٌ عَظِيمٌ

11. “Me të vërtetë, ata që bënë shpifje (ndaj bashkëshortes së Muhamedit), janë një grup prej jush. Mos e konsideroni këtë (shpifje), të keqe për ju. Jo, kjo është mirë për ju. Çdonjëri prej tyre, do të dënohet për atë që ka bërë, e atë, prej tyre që ka bërë më së shumti, e pret dënimi i madh”.

Duhet theksuar se ky ajet u shpall kur Pejgamberit alejhi selam në vitin e pestë të hixhretit (ky vit është më i sakti) i erdhi lajmi se fisi Beni Mustalik donte ta sulmonte dhe kryetari i tyre ishte El-Harith ibën Ebi Sirar. Pasi Pejgamberi, alejhi selam, dëgjoi për një përgatitje të tillë, u doli atyre përballë derisa u takuan në një vend të ashtuquajtur “el-Murejsië”. Përnjëherë këtu filloi përleshja. Allahu i ndihmoi besimtarët, kështu që pabesimtarët humbën.

Në këtë luftë morën pjesë edhe një numër i madh munafikësh, të cilët nuk e kishin traditë të merrnin pjesë nëpër luftëra, por kur panë se muslimanët po

fitonin në çdo luftë dhe përfitimet e luftës po i ndanin, atëherë munafikët lakmuan në emër të famës, pozitës dhe pasurisë.

Pas kthimit nga lufta Muhamedi, alejhi selam, me shokët e tij u ndalën në një vend që të pushonin dhe aty i zuri nata. Pasi u terrua, Aishja, radijAllahu anha, u largua pak për nevoja personale, por kur u kthye, hetoi se kishte humbur qaforen. U brengos për një gjë të tillë dhe u kthye që ta kërkonte. Atje u vonua duke e kërkuar, por ndërkohë erdhi urdhri që karvani të nisej. Arka në të cilën qëndronte Aishja, radijAllahu anhu, u ngarkua mbi deve³ duke menduar se ajo ishte brenda, meqë ajo ishte grua fizikisht e dobët dhe e lehtë, prandaj ata nuk e hetuan mungesën e saj dhe u nisën.

Kur Aishja, radijAllahu anha, pa se karvani ishte nisur, ajo u brengos dhe u ndal e tha me vete se kur ta hetonin, do të ktheheshin në vendin ku e kishin lënë.

Duke ndenjur dhe pritur e brengosur, papritmas pa një njeri me deve dhe ai menjëherë e njohu, pasi e njihte para se të zbriste urdhri për mbulesën.

Ky ishte Safvan ibën Muattili, i cili kishte traditë që të vonohej sepse ishte njeri që flinte shumë dhe interesohej për gjërat e muslimanëve pasi niseshin ata. Ai

3 Këtë e përdornin arabët në atë kohë për shkak të udhëtimit dhe e bënë në formë shtëpize të vogël, meqenëse udhëtimet ishin të gjata me javë a muaj – dhe i vendosnin mbi deve të përgatitura special – e kur çlodheshin, i zbritnin prej devesë.

bënte një kontroll në rast se ata harronin diçka dhe ua mblidhte sendet e harruara. U ndal pak më larg dhe tha:

“Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi, gruaja e Resulullahut!”

E përgatiti devenë e vet, Aishja, radijAllahu anha, hipi në të dhe u nisën.

Aishja, radijAllahu anha, ka thënë: “Vallahi nuk kam biseduar asnjë fjalë e as nuk kam dëgjuar asnjë fjalë përpos zërit të gjumit (duke gërhitur), sepse ai ishte njeri që flinte shumë.

Vazhduam udhëtimin derisa arritëm ushtrinë në mes të ditës, kur ishin ndalur për pushim. Kështu, ai që dëshmoi në çështjen time është ai që barti pjesën më të madhe të shpifjes – Abdullah ibën Ubej bin Seluli”.

Aishja, radijAllahu anha, vazhdon:

“Pasi u ktheva në Medinë, u sëmura për një muaj. Njerëzit po merreshin me këtë çështje, ndërsa unë nuk dija gjë, vetëm se harmonia dhe mëshira që kishte Pejgamberi, alejhi selam, me mua, nuk ishte më. Kur hynte në shtëpi, më jepte selam dhe më pyeste si isha. Pasi u shërova, dola një natë me Umi Mistah që të kryeja gjërat personale⁴. Gjatë kthimit për në shtëpi, Umi Mistah u pengua dhe mallkoi burrin e vet, ndërsa unë

4 Arabët e kishin traditë në atë kohë që nevojtoresh të posaçme të mos kishin, por dilnin vetëm natën dhe largoheshin larg shtëpive që t'i kryenin nevojat, në veçanti gjinia femërore, dhe këtë e bënin vetëm në terr (natën). Më vonë pastaj i kanë bërë nevojtoresh afër shtëpive.

(Aishja) e qortova se si po e qortonte një njeri që kishte qenë i pranishëm në Bedër (Luftën e Bedrit)."

Ajo iu drejtua Aishes duke i thënë: "A nuk ke dëgjuar se çfarë thotë ai për ty?!"

"Menjëherë më tregoi për lajmin (shpifjen), ndërsa unë për herë të parë po dëgjoja një lajm të tillë.

Përnjëherë m'u shtua sëmundja mbi sëmundje. Kur u ktheva në shtëpi, hyri tek unë Resulullahu, alejhi selam, më përshëndeti e më tha: "Si jeni?" Unë i thashë atij të më lejonte të shkoja te prindërit e mi. Dëshiroja të shkoja tek ata që të vërtetoja se ç'po ndodhte. Pejgamberi, alejhi selam, më lejoi të shkoja tek ata.

Me të arritur tek ata, iu drejtova nënës: "Oj nëna ime, pse njerëzit po flasin për një çështje të tillë?" Ajo m'u drejtua duke i thënë: "Oj bija ime, lehtësoja vetes (mos u dëshpëro) se për Zotin, çdo grua e cila ka pozitë të lartë te burri i saj dhe ai e do, ortaket e saj me çdo kusht duan që ta rrëzojnë atë pozitë."

Aishja tha: "Subhanallah, a janë ende duke folur njerëzit për një gjë të tillë?"

Aishja tregon: "Atë natë qava deri në mëngjes, nuk m'u ndalën lotët e as më merrte gjumi".

Pejgamberi, alejhi selam, filloi te konsultohet me shokët e tij për këtë çështje, e thirri Aliun, dhe Usamen, të birin e Zejdit, radijAllahu anhumu, mirëpo në atë kohë edhe shpallja ishte e ndërprerë.

I pyeti dhe u konsultua me ta për shkurorëzimin e Aishes.

Aishja rrëfen duke thënë se Usame ibën Zejdi i tha Pejgamberit, alejhi selam, se Aishja nuk është aso gruaje për të cilën flasin njerëzit. Usameja për respektin që kishte ndaj familjes së Pejgamberit, alejhi selam, tha: “O i Dërguari i Allahut, ne për familjen tënde nuk dimë gjë vetëm se mirë!” Ndërsa Aliu, radijAllahu anhu, tha:

“O i Dërguari i Allahut, Allahu nuk ta ka kufizuar çështjen vetëm se në të, gra të tilla ka plot, e në qoftë se do ta pyesësh shërbëtoren e saj (Burejren), ajo do të tregojë edhe më mirë”.

Pejgamberi, alejhi selam, iu drejtua Burejres (shërbëtore) duke e pyetur: “A mos ke hasur në gruan time ndonjë çështje e cila të dërgon në dyshim?” Burejra iu përgjigj:

“Pasha Allahun, që të ka dërguar me të vërtetën, nuk kam mundur të has në të gjë, përpos se ajo është një robëreshë e vogël e Allahut”. Doli e hipi në minber, iu drejtua të pranishmëve duke u thënë:

“O ju besimtarë, kush më arsyeton për një njeri për të cilin e dini edhe ju vetë se më ka dëmtuar në familje? Për Zotin, nuk di për familjen time vetëm se gjëra të mira (hair). Më kanë lajmëruar për një njeri (Safuan ibën Muattil) për të cilin unë nuk di për të vetëm se mirë dhe kurrë nuk ka hyrë te familja ime vetëm se me mua”.

Në këtë moment ndodhi një mosmarrëveshje mes shokëve të Pejgamberit, alejhi salam, derisa për pak u përleshën.

Aishja vazhdonte duke qarë, derisa prindërit e saj menduan se vaji ia shkëputi mëlçinë, e ata qëndronin pranë meje, ndërsa unë isha në atë pozitë, kur papritmas një grua nga ensarët kërkoi leje për të hyrë.

E lejova për të hyrë, kështu që edhe ajo filloi të qante bashkë me mua. Në atë çast hyri edhe Resulullahu, alejhi salam, na përshëndeti dhe u ul.

Pejgamberi nuk ishte ulur pranë meje që nga dita kur njerëzit kishin filluar të flisnin për këtë çështje. Kaloi një muaj, kurse për çështjen time asgjë nuk i ishte shpallur Resulullahut, alejhi salam.

Pasi u ul, Pejgamberi alejhi salam tha dëshminë (shehadetin), m'u drejtua e më tha:

“Oj Aishe, më ka ardhur lajmi për atë që po flitet për ty. Në qoftë se je e pastër, Allahu do të të pastrojë, në qoftë se ke bërë mëkat, kërko falje tek Allahu e pendohu, sepse kur robi i Allahut bën ndonjë mëkat e pendohet, Allahu ia fal atij”.

Kur Pejgamberi, alejhi salam, mbaroi fjalimin e vet, filluan të më rridhnin lotët derisa nuk më ngelën më lot në sy (edhe sytë m'u thanë). Pas kësaj iu drejtova prindit tim (Ebu Bekrit) duke i thënë:

“Përgjigju Pejgamberit, alejhi selam, në vendin tim”. Kurse ai (Ebu Bekri) më tha: “Vallahi nuk di se çfarë t’i them Pejgamberit, alejhi selam.” Atëherë iu drejtova nënës sime:

“Përgjigju, oj nëna ime, Pejgamberit, alejhi selam, e ajo më tha: “Vallahi nuk po di se çfarë t’i them Pejgamberit të Allahut, oj bija ime.” Atëherë edhe unë u thashë se edhe unë jam një vajzë e re, e cila nuk di shumë nga Kurani.

Ju keni dëgjuar edhe më herët për këtë çështje, derisa ju gati i keni besuar këtij lajmi – e në qoftë se unë do t’ju kisha thënë se jam e pastër nga kjo akuzë – Allahu e di se unë jam e pastër, kurse ju nuk do të më besonit, e në qoftë se do ta pranoja një gjë të tillë - Allahu e di se unë jam larg asaj që po flitet, atëherë ju do të më kishit besuar. Pasha Allahun, nuk kam zgjidhje tjetër mes vetes sime dhe jush vetëm se atë që tha Jusufi, alejhi selam:

فَصَبِّرْ جَمِيلًا وَاللَّهُ الْمُسْتَعَانُ عَلَىٰ مَا تَصِفُونَ. يوسف 18

“Halli im është durimi i mirë – Allahu është nga i cili kërkohet ndihmë për këtë që përshkruani ju”. (Jusuf, 18)

Pastaj vazhdoi duke thënë: “Për Zotin, nuk e ndërroj vendin e Pejgamberit, alejhi selam, e as nuk dal nga shtëpia.

Pas një kohe Allahu i Lartmadhëruar shpalli ajetet kuranore që më pastruan dhe i përgënjeshtruan shpifësit.”

Kur papritmas Pejgamberi, alejhi selam, buzëqeshi dhe të parën fjalë që tha ishte përgëzimi duke më thënë: “Allahu të pastroi!”

Atëherë nëna ime më tha: “Ngrihu e falënderoje Pejgamberin, alejhi selam,” e unë i thashë: “Jo, për Zotin, nuk i ngrihem atij e as nuk e falënderoj askënd përpos Allahut.

Ai ma zbriti pastrimin”, dhe vazhdoi: “Allahu shpalli këtë ajet:

11- إِنَّ الَّذِينَ جَاءُوا بِالْإِفْكِ عُصْبَةٌ مِنْكُمْ لَا تَحْسَبُوهُ شَرًّا لَكُمْ بَلْ هُوَ خَيْرٌ لَكُمْ لِكُلِّ امْرِئٍ مِنْهُمْ مَا اكْتَسَبَ مِنَ الْإِثْمِ وَالَّذِي تَوَلَّى كِبْرَهُ مِنْهُمْ لَهُ عَذَابٌ عَظِيمٌ

11. “S’ka dyshim se ata që trilluan shpifjen janë një grup prej jush. Ju mos e merrni atë si ndonjë dëm për ju, përkundrazi ajo do të jetë në dobinë tuaj. Secilit prej tyre do t’i takojë dënimi sipas pjesëmarrjes në mëkat e atij që e barti pjesën e madhe të shpifjes i takon dënimi i madh”.

Kur zbritën këto ajete, Ebu Bekri t ishte duke e financuar një të afërm të tij i cili quhej Mistah që ishte i varfër.

Ebu Bekri tha: “Për Zotin, unë do t’ia ndërpres ndihmat atij, pasi që ai tha çmos për Aishen.” Allahu zbriti ajetin tjetër:

وَلَا يَأْتَلِ أُولُو الْفَضْلِ مِنْكُمْ وَالسَّعَةِ أَنْ يُؤْتُوا أُولِي الْقُرْبَىٰ وَالْمَسَاكِينَ
وَالْمُهَاجِرِينَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَلْيَعْمُوا وَلِيَصَفَّحُوا أَلَا تَحِبُّونَ أَنْ يَغْفِرَ اللَّهُ
لَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ . النور 22

22. “Të ndershmit dhe të pasurit nga ju të mos betohen se nuk do t’ju japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që për hir të Allahut lanë vendlindjet e tyre, po le t’ua falin (gabimin) dhe të mos ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që Allahu t’ju falë ju? Allahu fal dhe mëshiron shumë.” (En Nur, 22)

Ebu Bekri pasi e dëgjoi këtë ajet, menjëherë tha: “Po, vallahi, unë dua të më falë Allahu!” Menjëherë ia ktheu ndihmat Mistahut dhe filloi ta financonte si më parë.

Pas kësaj Pejgamberi, alejhi selam, doli para njerëzve dhe mbajti një fjalim, ua lexoi ajetet që posa ishin shpallur për pastërtinë e Aishes dhe urdhëroi që disa prej shokëve të tij, të cilët kishin marrë pjesë në shpifje, të ndëshkoheshin. Ata ishin Mistah ibën Uthathe, Hasan ibën Thabiti dhe Hamanete bint Xhahshi.

12 - لَوْلَا إِذْ سَمِعْتُمُوهُ ظَنَّ الْمُؤْمِنُونَ وَالْمُؤْمِنَاتُ بِأَنَّهُمْ خَيْرٌ وَقَالُوا هَذَا إِفْكٌ مُّبِينٌ

12. “Përse, me të dëgjuar këtë (shpifje) – besimtarët dhe besimtaret nuk menduan mirë për njëri-tjetrin dhe të thonë: “Kjo është shpifje e hapët!”.

Në këtë ajet Allahu i qortoi besimtarët. Po ashtu, sikur këtë çështje ta analizonin në vetvete, se a mund të ndodhë apo të bënte ndonjëri prej tyre një vepër të tillë, siç bëri Ebu Ejub Halid ibën Zejd el Ensariut me gruan e tij.

Kur gruaja e tij Umi Ejub i tha bashkëshortit të vet: “O Ebu Ejub, a ke dëgjuar se ç’po thonë njerëzit për Aishen?”

Ai iu përgjigj: “Po, mirëpo kjo është gënjeshtër e trilluar.”

Iu drejtua gruas së vet duke e pyetur: “A do të kishe vepruar ti kështu një vepër të tillë?” Ajo iu përgjigj: “Jo, për Zotin, kurrë nuk do ta kisha bërë!”

Ai i tha: “Vallahi, Aishja është më e mirë se ti!”, që tregon se besimtarët duhet të kishin pasur një mendim të tillë.

Pikësëpari të mendonin mirë e të besonin në vetveten e tyre, pastaj ta shprehnin me gojë duke thënë se

ky është lajm i rrejshëm, ashtu siç është rreshtuar në Kuran, ta shprehin haptazi ashtu edhe siç ndodhi ardhja e Aishes në mes të ditës, pasi ushtria ishte ndalur të pushonte, këta mbërritën në mesin e tyre në mes të ditës, kur aty ishin të gjithë njerëzit duke filluar prej Pejgamberit, alejhi selam, që ishte burri i saj, Ebu Bekrit, radijAllahu anhu, prindi i saj, e kështu me radhë.

Po të kishte diçka të fshehtë, do të hynte në mesin e tyre fshehurazi.

13- لَوْلَا جَاءُوا عَلَيْهِ بِأَرْبَعَةِ شُهَدَاءَ فَإِذْ لَمْ يَأْتُوا بِالشُّهَدَاءِ فَأُولَئِكَ عِنْدَ اللَّهِ هُمُ الْكَاذِبُونَ

“Allahu i Lartmadhëruar u hedh poshtë këtë muna-fikëve duke u thënë: **“Pse nuk sollët nga katër dëshmitarë, e pasi nuk i keni sjellë dëshmitarët, atëherë ata tek Allahu janë gënjeshtarë”**.

Nga ky ajet mësojmë se në raste të tilla, në qoftë se nuk sillen dëshmitarët, atëherë ajo akuzë bie. Është interesante se në të gjitha dëshmitë e tjera, prezentë duhet të jenë dy dëshmitarë, kurse te çështja e nderit duhet të sillen katër dëshmitarë.

Por, asaj që duhet t'i kushtojmë rëndësi është ajo se në raste të dëshmisë, ajo duhet të jetë në përputhshmëri me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë qind për qind, në qoftë se dëshmia ndryshon me një ndryshim shumë të

vogël, atëherë ajo bie dhe nuk u pranohet atyre, madje edhe dënohen, sepse kjo çështje ka të bëjë më nderin e besimtarëve dhe se Islami dëshiron një shoqëri të shëndoshë e jo të dyshimtë.

14 - وَلَوْلَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ لَمَسَّكُمْ فِي مَا أَفَضْتُمْ فِيهِ عَذَابٌ عَظِيمٌ

14. “E po të mos ishte mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij në këtë botë dhe në botën tjetër, ju do t’ju kapte dënim i madh për shkak të asaj në të cilën u hodhët”.

Pra, o ju që iu bashkëngjitët një çështjeje të tillë, po të mos ishte mëshira e Allahut, ju do të ishit në buzë të një shkatërrimi, mirëpo, megjithatë, Allahu ju shpëtoi ju nga një dënim i tillë, atëherë le të jetë një mësim për ju në të ardhmen, qoftë për ju të kësaj kohe ose për gjeneratat e ardhshme, sepse një gjë e tillë nuk është e lehtë.

15 - إِذْ تَقَوُّوهُ بِالْعَنَاءِ وَتَقُولُونَ مَا لَيْسَ لَكُمْ بِهِ عِلْمٌ وَتُحْسِبُونَهُ هَيِّئًا وَهُوَ عِنْدَ اللَّهِ عَظِيمٌ

15. “Kur ju (atë shpifjen) e shpërndanit me shpejtësi me gjuhët tuaja dhe flisnit me atë që nuk kishit kurrfarë dije dhe mendonit se ajo është një gjë e thjesht apo e lehtë. Mirëpo, ajo tek Allahu është një çështje (mëkat) shumë e madhe”.

وَلَوْلَا إِذْ سَمِعْتُمُوهُ ظُلْمٌ مَّا يَكُونُ لَنَا أَنْ نَتَكَلَّمَ بِهَذَا سُبْحَانَكَ هَذَا بُهْتَانٌ عَظِيمٌ - 16

16. “Dhe pse nuk thatë kur e dëgjuat (lajmin): Nuk na takon të flasim për këtë, i lartmadhëruar qofsh, Zoti im, assesi nuk mund të ndodhë një gjë e tillë, kjo është një shpifje e madhe”.

Duhet të kishin përgënjeshtuar e refuzuar lajmin dhe assesi të mos mendonin se mund të ndodhte një gjë e tillë, madje të madhërohet Allahu nga ajo çudi e madhe që po ndodhte sepse bëhej fjalë për gruan e Resulullahut, alejhi selam, edhe për bijën e Ebu Bekrit e jo për një njeri të rëndomtë.

17- يَعْظُمُ اللَّهُ أَنْ تَعُودُوا لِمِثْلِهِ أَبَدًا إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ

17. “Allahu ju këshillon (duke ua tërhequr vërejtjen) dhe ju ndalon rreptësisht që të përsëritet edhe një herë një gjë e tillë – nëse jeni besimtarë të vërtetë”.

Allahu i Lartëmadhëruar na e tërheq vërejtjen, që të jetë mësim për ne, madje me këtë rast mund t'i themi se është kërcënim që të mos të përsëritet një gjë e tillë edhe njëherë.

18- وَيُيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ الْآيَاتِ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ

18. “Allahu ua sqaron juve argumentet sepse Allahu është më i Dituri dhe më i Urti”.

Ai është që ua zbriti këto dispozita, u tregoi se si të zbatohen ato, njëherësh na e bën me dije se Ai e di se kush dhe si i zbaton ato rregulla dhe dispozita, qofshin ato urdhëresa a ndalesa dhe se Ai e di çdo gjë dhe se Atij nuk mundet t'i fshihet asgjë, se Ai është i Urti për rregullat dhe dispozitat që ua ka bërë të obligueshme.

19- إِنَّ الَّذِينَ يُحِبُّونَ أَنْ تَشِيعَ الْفَاحِشَةُ فِي الَّذِينَ آمَنُوا لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ

19. “Ata të cilët dëshirojnë që të përhapet imoraliteti (zinaja) te besimtarët – të tillët i pret dënim i dhembshëm në këtë botë dhe në botën tjetër (ahiret) Allahu e di, e ju nuk dini”.

Një vërejtje tjetër ndaj atyre që merren me këtë ves (të cilët bëjnë shpifje ndaj grave të ndershme), me përhapjen e lajmeve të rrejshme qoftë edhe përmes rrjeteve sociale. Atyre u takon i njëjti dënim sepse njeriu duhet të ketë kujdes se çfarë thotë dhe shpërndan.

Në këtë kontekst dënimi është më i madh (i dyfishtë), sepse mëkati është bërë më i madh, për shkak se këtu është akuzuar gruaja e Pejgamberit, alejhi selam, d.m.th. ajo nuk është si çdo grua tjetër. Këtu gabimi u dyfishua: a- bënë shpifje në moral, b- shpifën ndaj gruas së Resullullahut, alejhi selam.

Të tillët do të dënohen dy herë, një herë në këtë botë me tetëdhjetë të rëna (kamxhikë), kurse dënimi i dytë do të jetë në ahiret.

Allahu e di, e ju nuk dini وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ

Nga shpifjet që trilluan ata ju nuk dini fshehtësitë, ndërsa ai që i di fshehtësitë është vetëm Allahu.

D.m.th. realitetin e kësaj ngjarjeje nuk e di askush pos Tij.

20 - وَلَوْلَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ وَأَنَّ اللَّهَ رَءُوفٌ رَحِيمٌ

20. “Sikur të mos ishte mirësia e Allahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, (do ta përjetonit menjëherë dënimin), por Allahu është shumë i butë dhe i mëshirshëm”.

Ibën Abasi, radijAllahu anhumu, për fjalën “**ndaj jush**” thotë se ka për qëllim Mistahun, Hasan ibën Thabitin dhe Hamanete bint Xhahsh, të cilët u dënuan

për shpifje, për shkak se edhe ata morën pjesë në këtë shpifje, por Allahu i mëshiroi dhe ua fali, përndryshe po të mos ishte butësia dhe mëshira e Tij, do të përjetonin një dënim të menjëhershëm për shkak se e meritonin, mirëpo mirësia dhe mëshira e Zotit ua fali.

21 - يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَّبِعُوا خُطُواتِ الشَّيْطَانِ وَمَنْ يَتَّبِعْ خُطُواتِ الشَّيْطَانِ فَإِنَّهُ يَأْمُرُ بِالْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَلَوْلَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ مَا زَكَّى مِنْكُمْ مِنْ أَحَدٍ أَبَدًا وَلَكِنَّ اللَّهَ يُزَكِّي مَنْ يَشَاءُ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ

21. “O ju të cilët keni besuar, mos ndiqni rrugët e djallit. E kush ndjek rrugën e tij (shejtanit) (do të dënohet), atëherë ai urdhëron për vepra të shëmtuara (amoralitet) dhe të irrituara”,

وَلَوْلَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ مَا زَكَّى مِنْكُمْ مِنْ أَحَدٍ أَبَدًا وَلَكِنَّ اللَّهَ يُزَكِّي مَنْ يَشَاءُ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ

“e sikur të mos kishte qenë mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij mbi ju, askush prej jush kurrë nuk do të ishte i pastër (prej mëkateve). Por, Allahu e pastron atë që do Ai dhe Ai është Dëgjues dhe i Ditur”.

Në këtë ajet Allahu i Lartmadhëruar u bën thirrje besimtarëve të cilët besojnë në Allahun dhe të Dërguarin e Tij, duke thënë që të mos ndjekin rrugën e djallit e

as të mos shkojnë pas gjurmëve të tij sepse ai ju dërgon në gjëra të shëmtuara, siç është imoraliteti (zinaja) dhe pirja e alkoolit, një dukuri shumë e përhapur te rinia e sotme, po ashtu edhe lëndët narkotike dhe vepra të tjera të shëmtuara, të cilat bien ndesh me rregullat dhe dispozitat që kërkon Allahu në jetën e njeriut, se çdo vepër e cila bie në kundërshtim me rregullat që e fesë së Allahut. Ato janë ndjekje e shejtanit, kurse Allahu na jep urdhër direkt që të mos ndiqet rruga e shejtanit, përndryshe do të hasim në dënim prej Allahut.

Megjithatë, Allahu robërit e Vet dëshiron t'i mëshirojë dhe u jep mundësi të ndryshme që ata të pendohen dhe këtë e dëshmon më së miri ajo që ndodhi me rastin e Aishes, radijAllahu anha, kur Allahu i mëshiroi besimtarët duke thënë:

وَلَوْلَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ مَا زَكَا مِنْكُمْ مِنْ أَحَدٍ أَبَدًا وَلَكِنَّ اللَّهَ يُزَكِّي مَنْ يَشَاءُ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ

“Po të mos ishte mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij, askush prej jush nuk do të pastrohej kurrë nga mëkatet. Por, Allahu pastron atë që do nga robërit e vet, Allahu dëgjon çdo send atë që e flisni me gojët tuaja dhe e shprehni me gjuhët tuaja. Po ashtu, është Ai që di çdo send mbi atë çka ju mendoni edhe pa e shprehur atë”.

22 - وَلَا يَأْتَلِ أُولُو الْفَضْلِ مِنْكُمْ وَالسَّعَةِ أَنْ يُؤْتُوا أُولَى الْقُرْبَى
وَالْمَسَاكِينَ وَالْمُهَاجِرِينَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَلْيَعْفُوا وَلْيَصْفَحُوا أَلَا تُحِبُّونَ أَنْ
يَغْفِرَ اللَّهُ لَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ

22. “Dhe le të mos betohen të ndershmit dhe të pasurit prej jush se nuk do t’u japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që për hir të Allahut bënë hixhret, le t’ua falin (gabimin) dhe mos t’ua zënë për të madhe. Vallë, a nuk dëshironi t’ju falë Allahu? Allahu është falës dhe mëshirues”.

Ky ajet ka zbritur për Ebu Bekrin, radijAllahu anhu, pasi ndodhi ngjarja me Aishen radijAllahu anha.

Ebu Bekri kishte një të afërm me emrin Mistah, i cili kishte ardhur nga Meka dhe ishte i varfër, ndërsa Ebu Bekri e ndihmonte materialisht. Mirëpo, kur ndodhi problemi i Aishes, ky mori pjesë në shpifje me të tjerët. Pasi Allahu e pastroi Aishen, radijAllahu anha, Ebu Bekri u neverit me të, saqë bëri be që nuk do ta ndihmonte më.

Allahu i Lartmadhëruar e shpalli këtë ajet në mënyrë sa më të butë dhe të ndershme ndaj Ebu Bekrit duke i thënë:

Vallë a nuk dëshironi që Allahu t’ju falë?

أَلَا تُحِبُّونَ أَنْ يَغْفِرَ اللَّهُ لَكُمْ

Ebu Bekri tha: “Po, për Zotin, unë dua të më falë Zoti im!”, dhe përnjëherë filloi t’i jepte ndihma Mistahut dhe premtoi duke thënë: “Vallahi, nuk do t’ia ndërpres ndihmat kurrë Mistahut!”

23 - إِنَّ الَّذِينَ يَرْمُونَ الْمُحْصَنَاتِ الْعَافِيَّاتِ الْمُؤْمِنَاتِ لَعُنُوا فِي الدُّنْيَا
وَالْآخِرَةِ وَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ

23. “Vërtet, ata që akuzojnë (shpifin) gratë e ndershme, besimtare të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër dhe ata i pret një dënim shumë i madh”.

Ajetet kuranore ende janë duke vazhduar mbi shpifjen e përgjithshme, në veçanti ndaj Aishes, radijAllahu anha, duke pasur parasysh se sa gjest i shëmtuar është shpifja, në veçanti ndaj nënave të besimtarëve, grave të Pejgamberit, alejhi selam si Aishja, besnikja, e bija e besnikut (Ebu Bekrit), për shkak se në të gjitha ajetet që janë shpallur në këtë sure e që kanë të bëjnë me shpifjen, është për qëllim Aishja, radijAllahu anha.

Kjo nuk do të thotë se këto ajete vlejnë vetëm për Aishen, por për çdo besimtare. Shkaku i zbritjes ishte për Aishen, por pas kësaj duhet të marrin mësim të gjithë. Dijetarët islamë, qofshin ata të mëhershmit apo ata bashkëkohorë, janë të një mendimi se kush fyen Aishen, radijAllahu anha, kush shpif për të ose ka bindjen apo të paktën edhe dyshimin se mund të ketë ndodhur një gjë

e tillë pasi ta lexojë edhe këtë ajet, pa dyshim se ai është jobesimtar (qafir) për shkak se ai kundërshton atë çka Allahu e ka hedhur poshtë.

Këtu u drejtohem i disave të cilët i mbrojnë disa sekte devijuese që ende kanë mendime të tilla, sado që të jetë afër Islamit, në qoftë se e ka vetëm këtë mendim, ai pa dyshim është qafir, për shkak se përgënjeshtrohet një ajet kuranor ku Allahu thotë:

إِنَّ الَّذِينَ يَرْمُونَ الْمُحْصَنَاتِ الْغَافِلَاتِ الْمُؤْمِنَاتِ لَعُنُوا فِي الدُّنْيَا
وَالْآخِرَةِ وَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ

“Vërtet, ata që akuzojnë (shpifin) gratë e ndershme, besimtare të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër dhe ata i pret një dënim shumë i madh”,

Që do të thotë se ky dënim përfshin pikësëpari ata që kanë shpifur ndaj Aishes, radijAllahu anha, por nuk do të thotë se mjafton vetëm me të, madje vazhdon edhe sot për ata të cilët shpifin edhe ditëve të sotme dhe dënimi i njëjtë do t'i kapë.

Vlen të ceket se Allahu i Lartmadhëruar në fillim të kësaj sure, në fillim të ajetit të katërt, thotë:

وَالَّذِينَ يَرْمُونَ الْمُحْصَنَاتِ ثُمَّ لَمْ يَأْتُوا بِأَرْبَعَةِ شُهَدَاءَ

“Edhe ata të cilët bëjnë shpifje mbi gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë”.

Kurse në këtë ajet i ka cilësuar duke thënë:

23 - إِنَّ الَّذِينَ يَتُومُونَ الْمُحْصَنَاتِ الْعَافِيَّاتِ الْمُؤْمِنَاتِ لُعِنُوا فِي الدُّنْيَا
وَالْآخِرَةِ وَلَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ

**“Vërtet, ata që akuzojnë (shpifin) gratë e
ndershme, besimtare të pafajshme...”**

Qëllimi është se në ajetin e parë nuk i ka përmendur gratë që i ka cekur në ajetin e dytë, se në ajetin e parë janë në përgjithësi gratë e besimtarëve, ndërsa në ajetin e dytë gratë e Pejgamberit, alejhi selam , në veçanti Aishja, radijAllahu anha, se shpifja mbi këto gra është shpifje ndaj shtëpisë së Pejgamberit, alejhi selam, dhe dëmtim i tij.

24 - يَوْمَ تَشْهَدُ عَلَيْهِمْ أَلْسِنَتُهُمْ وَأَيْدِيهِمْ وَأَرْجُلُهُمْ بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ

**24. “Në atë ditë do të dëshmojnë kundër tyre
gjuhët, duart dhe këmbët e tyre për atë që
kanë vepruar”.**

Pasi do t’u sillet atyre dëshmia për çdo vepër dhe për çdo fjalë që e kanë shprehur e do të ndëshkohen me dënim të dhembshëm, atëherë do të mundohen të gënjejnë a t’i gjejnë rrugëdalje vetes, mirëpo Allahu do t’ua vulosë gojët e tyre dhe do të dëshmojnë gjymtyrët për veprat që kanë bërë, siç thotë Allahu në suren Jasin, ajeti 65:

الْيَوْمَ نَخْتِمُ عَلَى أَفْوَاهِهِمْ وَتُكَلِّمُنَا أَيْدِيهِمْ وَتَشْهَدُ أَرْجُلُهُمْ بِمَا كَانُوا يَكْسِبُونَ 65

“Sot Ne ua kemi mbyllur gojët atyre, Neve na flasin duart e tyre, kurse këmbët e tyre dëshmojnë për atë që punuan”. (Jasin, 65)

25 - يَوْمَئِذٍ يُؤْفِقُهُمُ اللَّهُ دِينَهُمُ الْحَقَّ وَيَعْلَمُونَ أَنَّ اللَّهَ هُوَ الْحَقُّ الْمُبِينُ

25. “Atë ditë Allahu ua plotëson shpërblimin e merituar, e ata e dinë se Allahu është Ai i vërteti, i qarti në drejtësi”.

Ky ajet është i lidhur ngushtë me ajetin e lartpërmendur, ku Allahu i Lartmadhëruar pasi do t’i urdhërojë gjymtyrët e trupit të dëshmojnë për veprat e bëra, atëherë menjëherë do t’i shpërblejë sipas veprës që kanë vepruar.

26- الْحَبَشَاتُ لِلْخَيْثِثِ وَالْخَيْثُثُونَ لِلْخَيْثَاتِ وَالطَّيِّبَاتُ لِلطَّيِّبِينَ وَالطَّيِّبُونَ لِلطَّيِّبَاتِ أُولَئِكَ مُبَرَّءُونَ مِمَّا يَقُولُونَ لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَرِزْقٌ كَرِيمٌ

26. “Gratë e pandershme janë për meshkuj të pandershëm; e burrat e pandershëm, janë për femra të pandershme. Gratë e ndershme janë për meshkuj të ndershëm; e burrat e ndershëm janë për femra të ndershme. Ata të ndershmit, janë

**larg prej atyre thënieve; atyre (të ndershmëve)
u përket falja e mëkateve dhe dhuntia e madhe”.**

Ibën Abasi, radijAllahu anhumu, thotë: “Gratë e këqija janë për burrat e këqij (zinaqarët) dhe burrat e këqij janë për gratë e këqija, ndërsa burrat e mirë janë për gratë e mira dhe gratë e mira janë për burrat e mirë”.

Ai thotë se ky ajet ka zbritur me rastin e Aishes – në ngjarjen e shpifjes. Pjesa dërrmuese e komentuesve thonë se këtu për të këqijtë është qëllimi për munafikët, kurse për të mirët është qëllimi për besimtarët dhe për këtë Allahu thotë:

أُولَئِكَ مُبَرَّءُونَ مِمَّا يَقُولُونَ لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَرِزْقٌ كَرِيمٌ

**“Ata të ndershmit, janë larg prej atyre thënieve,
atyre të ndershmëve u përket falja e mëkateve
dhe dhuntia e madhe (xheneti)”.**

Këtë e vërteton edhe rasti se Allahu nuk do ta lejonte që Pejgamberi, alejhi selam, të martohet vetëm se më një grua të ndershme dhe të mirë sepse është për njeriun më të mirë. Po të kishte qenë e keqe, nuk do të përsh-tatej për Pejgamberin e Allahut. Allahu thotë:

Ata të ndershmit, janë larg prej atyre thënieve

أُولَئِكَ مُبَرَّءُونَ مِمَّا يَقُولُونَ

Kjo do të thotë se ata janë shumë larg asaj që pretendojnë hipokritët dhe për këtë Allahu do t'i shpërblejë me falje dhe begati të mëdha në xhenet:

لَهُمْ مَغْفِرَةٌ وَرِزْقٌ كَرِيمٌ

“Atyre të ndershmëve u përket falja e mëkateve dhe dhuntia e madhe (xheneti)”.

Kjo na jep të kuptojmë se të ndershmëve në këtë botë u takon falja e mëkateve, ndërsa në ahiret xheneti.

Ky ajet dëshmon se Resulullahu, alejhi selam, ishte nga të ndershmit dhe i takojnë të ndershmet, kurse Aishja, radijAllahu anha, ishte nga të ndershmet dhe i takoi të ndershmit (Resulullahut).

Sa i përket dhuntisë që do t'u takojë, këtu mund të konstatojmë se Aishja do të jetë banore e xhenetit pasi Allahu ua premtoi xhenetin.

Resulullahu, alejhi selam, e përgëzoi Aishen se do të jetë gruaja e tij në xhenet. Për përgëzimin e Aishes se është banore e xhenetit dhe grua e Resulullahut, alejhi selam, në këtë botë dhe në ahiret, ka shumë hadithe, por ne do të cekim vetëm disa.

Në mustedrekun e Hakimit transmetohet se Resulullahu, alejhi selam, i ka thënë Aishes, radijAllahu anha:

“A don të jesh gruaja ime në këtë botë dhe në ahiret?”
Aishja ia ka kthyer duke i thënë:

“Po, vallahi (dua të jem)!” Resulullahu, alejhi salam,
ia ka kthyer duke i thënë: “Ti je gruaja ime në këtë botë
dhe në ahiret”.

Në një tjetër transmetim thuhet se Aishja e pyeti
Resulullahun, alejhi salam, duke i thënë:

“O i Dërguari i Allahut, cila nga gratë do të jenë me
ty në xhenet?” Resulullahu, alejhi salam, ia ktheu duke i
thënë se “ti je njëra nga ato”.

Në një tjetër transmetim thotë: “Aishja është gruaja
ime në xhenet”.

Ka shumë hadithe të tjera që argumentojnë për
Aishen se ajo do të jetë nga gratë e Resulullahut, alejhi
salam, në xhenet.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَدْخُلُوا بُيُوتًا غَيْرَ بُيُوتِكُمْ حَتَّى تَسْتَأْذِنُوا
وَتُسَلِّمُوا عَلَى أَهْلِهَا ذَلِكَ خَيْرٌ لَكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ

**27. “O ju që keni besuar mos hyni në shtëpitë
e huaja pa kërkuar leje dhe pa përshëndet-
tur njerëzit e saj. Kjo është më mirë për ju në
mënyrë që të merrni mësim”.**

Vlen të ceket se shkaku i zbritjes së këtij ajeti është
se një grua erdhi te Pejgamberi, alejhi salam, dhe i tha:
“O i Dërguari i Allahut, unë jam në shtëpinë time dhe

ka raste kur nuk dua të më shikojë askush, as prindi e as fëmija, në atë moment vjen dikush. Çka të bëj?” Menjëherë u shpall ky ajet.

Allahu i Lartmadhëruar e ka begatuar këtë sure me gjëra shumë të nevojshme për besimtarin në jetën e përditshme.

Pasi përfunduan ajetet që kishin të bënin me akuzat ndaj Aishes, radijAllahu anha, dhe rregullat e dispozitat për imoralitetin (zinanë), tani e tutje një numër i konsiderueshëm i ajeteve flasin për gjërat a rrugët që mund të shpien deri te zinaja apo shpifja.

Pasi Allahu i Lartmadhëruar na tregoi sa çështje të shëmtuara janë shpifja apo zinaja, Ai dëshiron t’i mbyllë të gjitha rrugët që shpien deri aty.

Duke filluar nga ky ajet flitet për edukatën e shtëpisë, si të thirret ose të merret leja për të hyrë në shtëpinë e huaj. Pra, kjo është edukatë fetare. Allahu me këtë i edukoi robërit e Tij besimtarë, që assesi të mos hyjnë në shtëpitë e huaja pa kërkuar leje. Në qoftë se u jepet leja për të hyrë, atëherë të përshëndeten banorët e asaj shtëpie. Për këtë rregull ekzistojnë edhe disa hadithe se si Pejgamberi, alejhi selam , ua mësonte shokëve të tij rregullën për hyrje në shtëpi.

Imam Ahmedi transmeton nga disa shokë të Pejgamberit, alejhi selam, se njëherë Pejgamberi, alejhi selam,

shkoi te Sad ibën Ubadeh dhe kur u afrua te dera, tha:
“Esselamu alejke ve rahmetullah!”

Sadi nuk e ktheu përgjigjen,

Pejgamberi, alejhi salam, e përsëriti tri herë këtë përshëndetje, ndërsa Sadi tri herë ia ktheu përshëndetjen, por me zë të ulët që të mos e dëgjonte Pejgamberi, alejhi salam. Më në fund Pejgamberi, alejhi salam, u kthye pas.

Sadi i shkoi nga pas Pejgamberit, alejhi salam, dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut, të kam në vend të babait dhe të nënës sime! Sa herë që më ke përshëndetur, unë i kam dëgjuar të gjitha.

Unë çdo përshëndetje ta ktheja me zë të ulët që të mos më dëgjoje sepse desha që ta shtojë sa më shumë paqen dhe bereqetin në shtëpinë time. E tani hyr në shtëpinë time”. Pastaj i ofroi rrush të thatë dhe Pejgamberi, alejhi salam, hëngri dhe në fund bëri lutje duke thënë:

وَأَكَل طَعَامَكُمْ الْأَبْرَارُ وَصَلَتْ عَلَيْكُمْ الْمَلَائِكَةُ أَفْطَرُ عَنْدَكُمْ
الصَّائِمُونَ

“E ngrënçin ushqimin tuaj agjëruesit! E ngrënçin ushqimin tuaj të devotshmit, melaiket le të luten për ju dhe ne!”

Nga ky hadith konstatojmë se duhet të merret leje tri herë për të hyrë në shtëpi. Në qoftë se të jepet leja, hyr. Në qoftë se jo, atëherë duhet të kthehesh, edhe pse pronari i shtëpisë është aty. Po ashtu, duhet ta dish se ai që dëshiron të hyjë në shtëpi (kërkon leje), duhet të rrijë anash, qoftë në anën e djathtë ose të majtë, e nuk bën assesi të rrijë drejt derës.

Ja hadithi i Pejgamberit, alejhi salam, të cilin e transmeton Ebu Davudi nga Abdullah ibën Bishri: “Kur Pejgamberi, alejhi salam, thërriste te dera e ndokujt, nuk rrinte para derës, mirëpo rrinte djathtas ose majtas dhe thoshte: Es selamu alejkum!”

Të gjithë e kanë transmetuar një hadith nga Xhabiri, radijAllahu anhu, i cili thotë: “Shkova te Pejgamberi, alejhi salam, të laja një borxh të cilin ia kishte babai im dhe trokita në derë. Pejgamberi alejhi salam pyeti: “Kush është?” Iu përgjigja: “Unë.” Pejgamberi, alejhi salam, tha: “Unë, unë”, sikur e urreu një gjë të tillë.”

E urreu një gjë të tillë sepse me atë fjalë nuk njihet personi përderisa nuk e tregon emrin a llagapin (nofkën) me të cilin njihet. Përndryshe, me fjalën “unë” çdokush mund të paraqitet dhe me atë nuk arrihet qëllimi i duhur për të marrë leje që të hyhet në shtëpi.

Po ashtu imam Tirmidhiu transmeton se Safvan ibn Umeje shkoi te Muhamedi, alejhi salam, pasi e pranoi

Islamin, dhe i ofroi ushqim Resulullahut, alejhi salam, kështu që hyri te Resulullahu, alejhi salam, pa i dhënë salam dhe marrë leje. Muhamedi, alejhi salam, i tha: “Kthehu e thuaj: -Eselamu alejkum, a mund të hyj?”

Ka shumë argumente të ngjashme që tregojnë se nuk lejohet të hyhet brenda shtëpive apo oborreve të huaja pa marrë leje.

Ekzistojnë edhe të tjera argumente që i qortojnë ata që hyjnë në oborre pa marrë leje.

28 - فَإِنْ لَمْ تَجِدُوا فِيهَا أَحَدًا فَلَا تَدْخُلُوهَا حَتَّى يُؤْذَنَ لَكُمْ وَإِنْ قِيلَ لَكُمْ ارْجِعُوا فَارْجِعُوا هُوَ أَزْكَى لَكُمْ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ عَلِيمٌ

28. “Po nëse nuk gjeni aty asnjë, atëherë mos hyni në to derisa t’u jepet leje, e nëse u thuhet kthehuni, ju pra kthehuni. Kjo është më e ndershme për ju. Allahu di çdo gjë që veproni ju”.

Nga kjo kuptojmë se edhe pse ndoshta dikush është aty e nuk përgjigjet, atëherë duhet të kthehet, kurse leja për të hyrë është tri herë.

Këtë e vërteton ngjarja e Pejgamberit, alejhi salam, me Sadin. Edhe në qoftë se të përgjigjet duke të thënë: “Kthehu” – ose diçka që u përngjan këtyre fjalëve, atëherë kthehu se nuk e di se çfarë problemi mund të ketë. Kjo është më e ndershme për ju që ai të mos ndiejë në vetvete pengesë.

Nga udhëzimet e Resulullahut, alejhi selam, është që kur të shkohet te dikush, duhet të thirret apo të merret lejë për hyrje deri tri herë, e nëse nuk ka përgjigje, duhet të kthehet, edhe pse ndoshta pronari apo zotëria është në shtëpi.

Duhet shtuar se leja për të hyrë nuk është vetëm për të rriturit apo për të vegjlit, por në këtë çështje përfshihen të gjithë, duke u bazuar tek Enes ibën Maliku, se ai kur hynte te Pejgamberi, alejhi selam, kërkonte leje, edhe pse ishte fëmijë.

Pjesa e fundit e ajetit: **“Allahu di çdo gjë që veproni ju”**, është një vërejtje ndaj atyre që cilët spiunojnë a shikojnë nëpër shtëpitë e huaja dhe përvjedhin shikimet pas shpine. Allahu ua bën me dije se Zoti e di atë që veprojnë, edhe pse nuk i shohin të tjerët, por mjafton t'i shohë Allahu.

29 - لَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ أَنْ تَدْخُلُوا بُيُوتًا غَيْرَ مَسْكُونَةٍ فِيهَا مَتَاعٌ
لَكُمْ وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا تَبْذُونَ وَمَا تَكْتُمُونَ

29. “Nuk është mëkat nëse ju hyni (pa leje) nëpër godinat të cilat janë të pabanuara e në to që keni ndonjë dobi. Allahu di atë që mbani hapur dhe fshehurazi.”

Me këtë lloj shtëpie ka për qëllim shtëpitë e ndër-
tuara për udhëtarët, qofshin ato hotele, qendra tregtare
e të tjera, në vende të caktuara për pushimin e mys-
firëve dhe udhëtarëve.

30 - قُلْ لِلْمُؤْمِنِينَ يَعْضُوا مِنْ أَبْصَارِهِمْ وَيَحْفَظُوا فُرُوجَهُمْ ذَلِكَ أَزْكَى
هُمُ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا يَصْنَعُونَ

**30. “Thuaju besimtarëve le t’i ndalin shikimet
e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të
tyre se kjo është më pastër për ta. Allahu është
i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata”.**

Në këtë ajet Allahu i Lartmadhëruar i urdhëron
besimtarët me urdhër të prerë që t’i ulin shikimet dhe
t’i mbrojnë organet e tyre që të mos bien në haram. Të
shumta janë hadithet që na e ndalojnë një gjë të tillë,
si për shembull Resulullahu, alejhi selam, thotë: “Nuk
i lejohet mashkullit të shikojë avretin e mashkullit e as
gruas që të shikojë avretin e gruas”. Transmeton Muslimi
në librin e shikimit të avretit, nr. 338.

Përderisa ndalesa e shikimit vlen për të njëjtën gjini,
si është puna me gjinitë e kundërta?

Po ashtu kur Xheriri e pyeti Resulullahun, alejhi
selam, për shikimin spontan (pa dashje), Resulullahu,

alejhi selam, i tha: “Largoje shikimin!” Transmeton Muslimi në librin e tij “El – Edeb”, nr. 2159.

Në një tjetër hadith Resulullahu, alejhi selam, iu drejtua Aliut duke i thënë: “O Ali, mos e ndiq shikimin njëri pas tjetrit sepse shikimi i parë (i rastësishëm) është i yti (pasi është bërë pa dashje), ndërsa shikimi i dytë (vazhdimi në shikim) është kundër teje”. Transmeton Ebu Daudi në librin “En-Nikah”, nr. 2777.

Shtrohet pyetja: Pse të ulet shikimi? Sepse shikimi është mjeti apo hapi i parë që ngacmon epshin edhe mund të ndodhë mosfrenimi i epshit, prandaj Allahu në një tjetër ajet ka thënë: **“As mos ju ofroni amoralityt”**. Nëse nuk merren masat parandaluese, është e vështirë që njeriu të përmbahet. Nga kjo konstatojmë se Allahu i Lartmadhëruar i ka urdhëruar robërit e Tij besimtarë t’i ndalin shikimet e tyre në gjërat e ndaluara, por të shikojnë ato që u janë lejuar.

Dijetarët e mëhershëm gjatë komentimit të këtij ajeti dhe të këtyre haditheve kanë thënë se shikimi është shigjetë helmuese në zemër, prandaj Allahu i Lartmadhëruar ka urdhëruar për ruajtjen e organeve, ashtu siç ka urdhëruar për ruajtjen e syve (nga shikimet e ndaluara), që janë dërgues kryesor në atë që është e ndaluar.”

Vlen të ceket se shkaku që janë përcaktuar vetëm besimtarët në fjalët e Allahut “thujë besimtarëve” dhe nuk ka thënë “njerëzve” është:

1. Ndërprerja e të gjitha rrugëve që çojnë deri në imoralitet (zina) për shkak se thamë se syri është hapi i parë që dërgon personin për arritjen e një qëllimi, siç thotë një poet arab me emrin Ahmed Sheukij:

نظرة فإبتسامة فسلام – فكلام فموعد فلقاء

Shikimi, buzëqeshja, përshëndetja, biseda dhe në fund takimi.

2. Nga ajeti konstatojmë se jobesimtarët nuk janë të udhëzuar në këto dispozita sepse nga ata së pari kërkohet besimi e pastaj dispozitat.

Kjo ishte pjesa e parë e ajetit, i cili ka të bëjë mbi shikimin në përgjithësi. Ndërsa pjesa e dytë e ajetit, në të cilin Allahu i Lartmadhëruar thotë: **“Të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre”**, kjo përfshin dy kuptime:

a) mbrojtjen e pjesëve të turpshme të trupit nga imoraliteti (zinaja),

b) mbrojtjen nga shikimi, që do të thotë se ndalohet rreptësisht shikimi i pjesëve të turpshme të njeriut, pa marrë parasysh gjininë, e jo siç bëhen disa lehtësime, veçanërisht nga gjinia femërore, kur shikojnë pjesët e trupit ndërmjet tyre duke mos i kushtuar rëndësi kësaj çështjeje shumë të rëndësishme.

Pra, të dyja qëllimet qëndrojnë në këtë ajet, ndërsa pjesa e tretë ku Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Se kjo është më e pastër për ta”, ذَلِكْ أَزْكَىٰ لَهُمْ

domethënë se është më pastër për zemrat dhe më e devotshme për fenë e tyre, siç thuhet në një proverb arabe:

من حفظ بصره أورثه الله نوراً في قلبه

“Kush ndalon shikimet (ruan sytë e vet), Allahu ia trashëgon një dritë në zemrën e tij.”

Dhe pjesa e fundit e ajetit:

“Allahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë
ata. إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا يَصْنَعُونَ

Këtë ajet e komenton ajeti në suren Gafir, 19.

يَعْلَمُ خَائِنَةَ الْأَعْيُنِ وَمَا تُخْفِي الصُّدُورُ

“Ai (Allahu) di për shikimin me cep të syve, e edhe për atë që e fshehin në zemra”.

Kjo është një vërejtje nga Allahu i Lartmadhëruar sepse sado që të mundohesh t'i fshehësh veprat e tua, mos harro se Zoti e di dhe e sheh atë që ti vjedh me bish-tin e syrit, bile edhe atë që e mban të fshehtë në zemrën tënde.

31- وَقُلْ لِلْمُؤْمِنَاتِ بَعْضُهُنَّ مِنْ أَبْصَارِهِنَّ وَيَحْفَظْنَ فُرُوجَهُنَّ وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَلْيَضْرِبْنَ بِخُمُرِهِنَّ عَلَىٰ جُيُوبِهِنَّ وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا لِبُعُولَتِهِنَّ أَوْ آبَائِهِنَّ أَوْ آبَائِهِنَّ أَوْ أَبْنَائِهِنَّ أَوْ أَبْنَائِهِنَّ أَوْ إِخْوَانِهِنَّ أَوْ بَنِي إِخْوَانِهِنَّ أَوْ نِسَائِهِنَّ

أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُنَّ أَوْ التَّابِعِينَ غَيْرِ أُولِي الْإِزَّةِ مِنَ الرِّجَالِ أَوْ الْطِّفْلِ
الَّذِينَ لَمْ يَظْهَرُوا عَلَى عَوْرَاتِ النِّسَاءِ وَلَا يَضُرُّنَّ بَأَرْجُلِهِنَّ لِيُعْلَمَ مَا
يُخْفِينَ مِنْ زِينَتِهِنَّ وَتُوبُوا إِلَى اللَّهِ جَمِيعًا أَيُّهَ الْمُؤْمِنُونَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ

31. “Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre. Të mos zbulojnë stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme, le të vënë shamitë gjokset e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt, përveç burrave të vet, baballarëve të vet ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta ose grave të tyre (që u përmendën) dhe robëreshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtoreshave nga meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat ose fëmijët nuk kuptojnë ende ndaj grave. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të mos zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë tek Allahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim”.

Ky përkthim është sipas tekstit duke mos u zgjeruar në dispozitat që mban me vete. Në këtë ajet gjenden disa dispozita, të cilat janë lënë pas dore dhe njëri ndër

shkaqet për devijimin e muslimanëve sot është lënia pas shpine e rregullave të këtij ajeti. Para se të zgjerohemi në komentimin e tij dhe në rregullat që mban, vlen të ceket:

SHKAKU I ZBRITJES SË KËTIJ AJETI

Imami dhe komentatori i Kuranit, Ibën Kethiri, rahi-mehullah, transmeton nga Mukalit ibën Hajan, nga Xhabir ibën Abdullah el-Ensarij, i cili ka treguar se Esma, bija e Merthedit, se ajo kishte një kopsht hurmash te Beni Harithët. Filluan të shkonin gratë tek ajo duke qenë jo të mbuluara mirë, u shiheshin këmbët (stolitë që i vendosnin në këmbë) dhe u shiheshin gjinjtë, po ashtu bishtat e flokëve. Esma kur i pa në këtë gjendje, tha: “Sa gjë e shëmtuar është kjo që bëni!” Dhe Allahu shpalli këtë ajet kuranor:

وَقُلْ لِلْمُؤْمِنَاتِ يَعْضُضْنَ مِنْ أَبْصَارِهِنَّ

“Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre...”, deri në përfundim të ajetit.

Në vazhdim le t'i kthehemi ajetit kuranor dhe ta komentojmë më gjerësisht. Allahu i Lartmadhëruar thotë:

وَقُلْ لِلْمُؤْمِنَاتِ يَعْضُضْنَ مِنْ أَبْصَارِهِنَّ

“Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre”.

Imam Esh-Shevkani në tefsirin e vet në komentin e këtij ajeti thotë: “Allahu i Lartmadhëruar e ka urdhëruar ndalimin e shikimeve të të dyja palët para se t’i urdhërojë për ruajtjen e pjesëve të turpshme nga harami (zinaja), për shkak se shikimi është dërguesi kryesor deri te mosruajtja e organit. Me të njëjtin urdhër të cilin ndaloi meshkujt, ashtu i ndaloi edhe femrat – dhe me këtë argumentohet se sa është i ndaluar shikimi i meshkujve të femrat, e njëjta vlen për të kundërtën (që femrat të shikojnë meshkujt)”.

Në këtë kontekst mund të argumentojmë me ngjarjen të cilën e transmetojnë Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, se Ummi Seleme ishte te Pejgamberi, alejhi selam, me Mejmunen e tha: “Ishim duke qëndruar aty kur erdhi Ibën Umi Mektumi (ky shok i Pejgamberit, alejhi selam, ishte i verbër) dhe hyri te Pejgamberi, alejhi selam”. Kjo ndodhi pasi ishte bërë mbulesa obligative dhe Pejgamberi, alejhi selam, i urdhëroi të mbulohen. Umi Selemeja) i tha: “O i Dërguari i Allahut, a nuk është i verbër, ai nuk na sheh e as nuk na njeh?!”

Pejgamberi, alejhi selam, iu tha: “A jeni ju të dyja të verbra? A nuk po e shihni ju atë?”

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

وَحَفَظْنَ فُرُوجَهُنَّ

Të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre

Qoftë ajo ruajtje nga gjërat e shëmtuara apo imoraliteti ose t'i mbulojnë që të mos i shohë ndokush. Allahu i Lartmadhëruar thotë:

وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا مَا ظَهَرَ مِنْهَا

Të mos zbulojnë stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme.

Këtu tregohet për ndalesën e Allahut të Lartmadhëruar për shfaqjen e stolive, por për ato stoli që nuk mund të mbulohen Allahu e ka lejuar apo nuk ua merr për të madhe në qoftë se ato shihen. Ato janë stolitë e jashtme, si manteli apo veshja e jashtme etj.⁵

Imam El Kurtubiu stolitë e jashtme i ndan në dy grupe:

- a) natyrore – siç është fytyra, duart, këmbët;
- b) të përfituara – kozmetika, stolitë, parfumet etj..

Po ashtu ajeti vazhdon duke thënë se bukuria është e brendshme dhe e jashtme. Atë që është e jashtme e sheh

5 Shtrohet pyetja: Të mbuluarit e fytyrës a është obligative apo jo? Dijetarët islamë kanë polemizuar rreth kësaj çështje shumë, qofshin ata të vjetrit apo këta të ditëve të sotme. Të dy palët kanë përdorur argumente të forta e të sakta. Ne, si kërkues të diturisë dhe si përkthyes të mendimeve të tyre, pas një studimi jo të vogël, mund të themi se anojmë kah mendimi i dijetarëve të cilët thonë **se të mbuluarit e fytyrës dhe të duarve nuk është obligative**, mirëpo ajo duhet të insisistojë që sa më shumë të mbulojë trupin e saj. Mbulimi i fytyrës është i preferuar vetëm për shkak të sprovave, rrezikut, fitnes, e kjo është më afër së vërtetës, edhe pse nuk e ka të obligueshme. Në fund, çdokush shpërblehet sipas qëllimit. I këtij mendimi ka qenë edhe Imam Albani, rahimehullahu teala.

i afërmi dhe i huaji, por të brendshmen (bukurinë) nuk i lejohet ta shohë askush përveç familjes më të afërme (bashkëshorti, prindi, vëllai e kështu me radhë).

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

Le të vënë shamitë mbi kraharorin e tyre

وَلْيَضْرِبْنَ حُجُرَهُنَّ

Para se të komentojmë këtë pjesë të ajetit, vlen të ceket shkaku i zbritjes së këtij ajeti, i cili është se gratë e asaj kohe, kur i mbulonin kokat e tyre me shamitë e veta, i mbulonin kokat dhe i hidhnin pas shpine, njëherazi edhe mantelet nuk i mbërthenin, kështu që qafa, veshët dhe një pjesë e gjoksit u mbetej pa mbuluar. Allahu i Lartmadhëruar urdhëroi që të hidhen ato shami prej shpinës në gjokset e tyre apo në pjesën e përparme të trupit. Imam Buhariu transmeton nga Aishja, radijAllahu anha, që thotë: “Allahu i mëshiroftë gratë e muhaxhirëve, se kur zbriti ky ajet

“le të vënë shamitë mbi kraharorin e tyre”

وَلْيَضْرِبْنَ حُجُرَهُنَّ

i grisën mbështjellëset e tyre dhe u mbuluan.”

Buhariu e transmeton në librin e tij “Et Tefsir”, në librin e renditjes sipas Muhamed Fuad Abdulbakij, nr. 4759 (6:109).

Në qoftë se ndalemi edhe njëherë në këtë ajet, veçanërisht te citati arabisht, ku Allahu i Lartmadhëruar thotë:

وَلْيَضْرِبْنَ خُمُرَهُنَّ عَلَىٰ جُيُوبِهِنَّ

“Le t’i hedhin shamitë mbi gjokset (grykat e gjokseve) e jo kraharor...”

do ta gjejmë ajetin shumë të qartë. Në gjuhën arabe fjala *فَجِيَّوْنَ* *xhujubihine* buron nga fjala *جيب* *xhejb*. Fjala *xhejb* komentohet nga të gjithë dijetarët, qofshin ata të gjuhës arabe apo komentues të Kuranit apo dijetarë të hadithit, se për qëllim është gryka e këmishës në të cilën futet koka, madje edhe në gjuhën shqipe fjala xhep d.m.th. një send i çarë ku hyn në të dora apo koka etj..

Nga kjo kuptojmë se të gjithë dijetarët (komentuesit) e këtij ajeti janë të një mendimi se kuptimi i ajetit është që ato shami, me të cilat gratë e atëhershme nuk mbuloheshin mirë dhe i linin mantelet e tyre të hapura, t’i hedhin para dhe le t’i mbulojnë veshët, qafën dhe gjokset e tyre.

Vazhdon ajeti duke thënë:

وَلَا يَبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا لِبُعُولَتِهِنَّ أَوْ آبَائِهِنَّ أَوْ آبَائِهِنَّ أَوْ أَبْنَائِهِنَّ أَوْ
أَبْنَاءِ بُعُولَتِهِنَّ أَوْ إِخْوَانِهِنَّ أَوْ بَنِي إِخْوَانِهِنَّ أَوْ أَخَوَاتِهِنَّ أَوْ نِسَائِهِنَّ

أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُنَّ أَوْ التَّابِعِينَ غَيْرِ أُولِي الْإِزَةِ مِنَ الرِّجَالِ أَوْ الْطُّفُلِ
الَّذِينَ لَمْ يَظْهَرُوا عَلَى عَوْرَاتِ النِّسَاءِ

“Dhe të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të vejnë shomitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet, baballarëve të vet ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmenden) dhe robëreshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtoreve nga meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat ose fëmijët nuk i kanë të pjekur për gra...”

Në goftë se ndalemi dhe lexojmë këtë pjesë të ajetit me vëmendje, precizitet, logjikë të shëndoshë, pa ngutje dhe pa e përdorur hidhërimin, do të bindemi me të vërtetë dhe do ta gjejmë se kush janë më të afërmit e tu. Një ndër shkaqet e devijimit të muslimanëve është lënia pas dore e këtij ajeti, duke përdorur a duke gjykuar me epsh dhe me pëlqim të djallit.

Ne gjithmonë nisemi nga ajo se ky është i afërm apo yni, ose kjo është e afërmja jonë dhe kështu gradua-lisht janë përzier gjinitë, saqë nuk ka ngelur asnjë njeri

i largët. Me këtë argumentohet përzierja e dy gjinive në ceremonitë tona, qofshin dasma apo të tjera, duke pretenduar se kjo nuk bën dëm në fe apo se ne nuk jemi të largët e të tjera, por harrojmë se përzierja mes dy gjinive është e ndaluar dhe mund të ketë pasoja të mëdha, siç edhe po ndodh shpesh si shkak i mosndarjes mes meshkujve dhe femrave.

Allahu i Lartmadhëruar e di më së miri dhe na ka treguar se kush është i afërt e kush i largët. Feja e Zotit nuk duhet të kuptohet e nuk duhet mbajtur me ndjekje të epshit ose me tradita, duke u bazuar në atë se te ne kështu e do vendi – duke lënë pas shpine se si Allahu i Lartmadhëruar do.

Pejgamberi, alejhi selam, thotë: *“Kush ua plotëson njerëzve dëshirat duke e hidhëruar Allahun, Allahu do të jetë i hidhëruar me të”*. Atëherë ne duhet të shkojmë drejt gjërave që Allahu i do, e jo njerëzit, sepse vetëm Ai duhet të adhurohet e të pëlqehet dhe sepse nuk na ka krijuar për ndonjë qëllim tjetër përveçse që ta adhurojmë Atë.

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ

“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë”. (Edh Dharijat, 56)

Nga kjo konstatojmë se bukurinë e saj gruaja mund ta zbulojë vetëm para burrit të vet (bashkëshortit), babait

të vet ose babait të burrit (vjehrrit), djemve ose djemve të burrave (*d.m.th. në qoftë se individ i është martuar me më shumë se një grua – djemtë e burrit me grua tjetër*), vëllezërve ose djemve të vëllezërve, po ashtu djemve të motrave ose grave të tyre, d.m.th. grave të besimtarëve.

Nga kjo kuptohet se gruaja besimtare përveçse duhet të mbulohet nga jobesimtarët, duhet të mbulohet edhe nga gratë e tyre për shkak se ato u tregojnë burrave të tyre duke ua përshkruar pamjen a bukuritë e besimtareve të jobesimtarët.

Po ashtu lejohet shfaqja e bukurisë edhe para robërshave që janë në pronësi të tyre ose shërbëtorëve që janë të moshuar apo që nuk kanë ndjenjë epshi, duke mos ndier nevojë për femra. Shfaqja e bukurisë lejohet edhe para fëmijëve të vegjël, të cilët nuk kanë arritur kohën e pjekurisë. Kjo vlen për fëmijët që janë të vegjël dhe që ende nuk mund t'i dallojnë gjërat dhe nuk i dallojnë bukuritë e grave apo bisedën e tyre, ndërsa para fëmijës që është afër kohës së pjekurisë dhe që di t'i dallojë gjërat nuk duhet të dalë e stolisur.

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

وَلَا يَضْرِبْنَ بِأَرْجُلِهِنَّ لِيُعْلَمَ مَا يُخْفِينَ مِنْ زِينَتِهِنَّ

“Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre”.

Në injorancën e hershme gratë e kishin për traditë që kur dilnin në rrugë, vishnin këpucë të posaçme (me taka të larta), që të kërcisnin e të tërhiqnin shikimet e njerëzve, ndërsa Allahu i Lartmadhëruar ua ndaloi besimtareve një gjë të tillë.

Po ashtu, ato e kishin traditë që nëse kishin ndonjë zbukurim të brendshëm, gjatë ecjes së tyre bënin ndonjë lëvizje e cila do t’ua shfaqte atë stoli që mbanin.

Le të bëjmë një krahasim mes së kaluarës dhe së sotmes. Mund të konstatojmë se moda e sotme, për të cilën mendojmë se është çështje e re, në realitet është shumë e vjetër, që para 14 shekujsh. Nëse themi se të mbuluarit e trupit është kthim në të kaluarën, atëherë ne themi se të zbuluarit e trupit është kthim edhe më shumë në të kaluarën. Për këto “moda”, që mendojmë se janë çështje të reja, le t’i kthehemi Kuranit dhe ta shohim se cilës kohë i takojnë.

Kjo është koha e injorancës së hershme, modë e djallit, i cili ndjek një metodë që prej kohës së Ademit e deri në Ditën e Gjykimit. Na kujtohet rasti i Ademit, alejhi selam, dhe bashkëshortes së tij, kur djalli u bëri vesvese dhe i mashtroi, sa që ua hoqi petkun që mbulonte trupin e tyre (pra i zhveshi). Këtë më së miri Allahu na e tregon në Kuranin Famëlartë, në suren A’raf, ajeti 20:

فَوَسَّوَسَ لَهُمَا الشَّيْطَانُ لِيُبْدِيَ لَهُمَا مَا وُورِيَ عَنْهُمَا مِنْ سَوَآئِهِمَا .
الأعراف 20

“Shejtani i nxiti ata të dy (i mashtroi), që t’ua zbulonte atyre pjesët e turpshme, që ishin të mbuluara...” (A’raf, 20)

Kurse në një tjetër ajet Allahu i Lartmadhëruar thotë:

يَا بَنِي آدَمَ لَا يَفْتِنَنَّكُمُ الشَّيْطَانُ كَمَا أَخْرَجَ أَبَوَيْكُم مِّنَ الْجَنَّةِ يَنزِعُ عَنْهُمَا لِبَاسَهُمَا لِيُرِيَهُمَا سَوَآئِهِمَا إِنَّهُ يَرَاكُمْ هُوَ وَقَبِيلُهُ مِنْ حَيْثُ لَا تَرَوْنَهُمْ إِنَّا جَعَلْنَا الشَّيَاطِينَ أَوْلِيَاءَ لِلَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ.

“O bijtë e Ademit, të mos ju mashtrojë kurrsesi shejtani sikurse i nxori prindërit tuaj nga xheneti, zhveshi prej tyre petkun e tyre që t’u dalë në shesh lakuriqësia e tyre. Vërtet ai dhe shoqëria e tij ju sheh, ndërsa ju nuk e shihni. Ne i kemi bërë shejtanët miq të atyre që nuk besojnë”. (A’raf, 27)

وَتُوبُوا إِلَى اللَّهِ جَمِيعًا أَيُّهَ الْمُؤْمِنُونَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ

“...Pendohuni të gjithë tek Allahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim”.

Në fund, të gjitha zemrat i kthehen Allahut të Lartmadhëruar që t’ua hapë derën e pendimit dhe t’ua falë

atë që ndodhi, qoftë ajo në injorancë qoftë ajo pas Islamit, por që është bërë nga padituria. Ajo zemër që dëshiron shpëtim në këtë botë dhe në botën tjetër duhet të kthehet tek Allahu dhe pikësëpari të kërkojë falje e të pendohet për mëkatet e bëra e pastaj të vazhdojë në zbatimin e rregullave të fesë.

32 - وَأَنْكِحُوا الْأَيَامَىٰ مِنْكُمْ وَالصَّالِحِينَ مِنْ عِبَادِكُمْ وَإِمَائِكُمْ ۚ إِنَّ يَكُونُوا فُقَرَاءَ يُغْنِيهِمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ

32. “Dhe martoni të pamartuarat (të pamartuarit) edhe robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme. Nëse janë të varfër, Allahu i begaton nga mirësitë e Tij, Allahu është Bujar i madh, i Gjithëdijshtëm”.

Kur Allahu i Lartmadhëruar urdhëroi për ruajtjen e shikimeve dhe pjesët e turpshme të trupit, menjëherë i udhëzoi robërit e Vet tek ajo që u është lejuar atyre për martesë, me të cilën arrihet plotësimi i epshit dhe qetësimi i çështjeve që çojnë në imoralitet, d.m.th. pas martesës lehtësohet ndalimi i shikimit nga haramet, po ashtu edhe mbrojtja e nderit.

Duhet theksuar se Allahu i Lartmadhëruar për çdo ndalesë që ka përmendur në Kuranin Famëlartë, i ka bërë zëvendësim, p.sh. Allahu i Lartmadhëruar ka ndaluar kamatën, por ka lejuar tregtinë (shitblerjen), ka ndaluar

zinanë, por ka lejuar martesën, bile dha urdhër për një gjë të tillë⁶.

Në këto nuk ka bërë dallime as në gjini e as në pozitë, bile edhe në qoftë se janë të varfër, ata nuk duhen të ndalohen nga martesë e as nuk duhet pasur frikë për një gjë të tillë sepse Allahu i Lartmadhëruar e begaton atë njeri që dëshiron t'u largohet mëkateve për hir të Tij.

Nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu, transmetohet të ketë thënë se Resulullahu, alejhi selam, ka thënë: *"Allahu ua ka borxh tre njerëzve që t'i ndihmojë:*

1. muxhahidit që bën xhihad për hir të Allahut,
 2. borxhliut që dëshiron ta lajë borxhin dhe
 3. atij që dëshiron të martohet për t'iu larguar hara-mit".
- Transmeton Tirmidhiu me nr. 1655 dhe Ibën Maxheh, 2518.

33- وَلَيْسْتَغْفِرَ الَّذِينَ لَا يَجِدُونَ نِكَاحًا حَتَّى يُعْطِيَهُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ
وَالَّذِينَ يَتَّبِعُونَ الْكِتَابَ بِمَا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ فَكَاتِبُوهُمْ إِنْ عَلِمْتُمْ فِيهِمْ
خَيْرًا وَأَتَوْهُمْ مِنْ مَالِ اللَّهِ الَّذِي آتَاكُمْ وَلَا تُكْرِهُوا فَسِيَّاتِكُمْ عَلَى الْبِغَاءِ
إِنْ أَرَدْتُمْ تَحْصُنَا لَنَتَّبِعُوا عَرْضَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَمَنْ يُكْرِهْنَّ فَإِنَّ اللَّهَ مِنْ
بَعْدِ إِكْرَاهِهِنَّ غَفُورٌ رَحِيمٌ

33. "E ata që nuk kanë mundësi martesë, le të përmbahen derisa Allahu t'i begatojë me të"

- 6 Nuk deshëm të zgjerohemi e të cekim mendimet e dijetarëve për çështjen e martesës, se a është obligative për çdo individ apo jo, por duhet të dimë se martesë është një vepër e preferuar në Islam dhe njëra prej traditave pejgamberike. Martesë për dikë është farz, për dikë sunet, për dikë haram e për dikë e preferuar. Ky është mendimi i Imam Ibën Kajimit.

mirat e veta. E ata që i keni në pronësinë tuaj dhe kërkojnë prej jush t'i lironi në bazë të kompensimit, atëherë ua bëni këtë të mundshme me marrëveshje, nëse e dini se janë të besueshëm dhe jepuni nga pasuria që u ka dhënë Allahu juve. Mos i detyroni robëreshat tuaja të bëjnë imoralitet, e për shkak të ndonjë fitimi të kësaj bote, derisa ato dëshirojnë të jenë të pastra. E kush i detyron me dhunë të bëjnë atë, Allahu i fal ato pas atij detyrimi. Allahu fal dhe është mëshirues”.

Siç dihet, Allahu i Lartmadhëruar në Kuranin Famëlartë ka cekur gjërat edhe më intime, ku në ajetin kuranor thotë:

مَا قَرَطْنَا فِي الْكِتَابِ مِنْ شَيْءٍ . الْأَنْعَامُ 38

“Asgjë nuk kemi lënë pas dore në libër”.

(El-En’am: 38)

Ja edhe zgjidhja për ata që nuk kanë mundësi martese. Allahu i Lartmadhëruar u thotë: **“...le të përmbahen (durojnë)”**, derisa Allahu i Lartmadhëruar t'i begatojë e t'i pasurojë nga të mirat e Tij.

Te fjala “begatojë” dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme. Disa thonë t'i begatojë me kurorë, nikah

(gra), e disa thonë t'i begatojë me pasuri që të mund të martohen.

وَالَّذِينَ يَبْتَغُونَ الْكِتَابَ مِمَّا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ

“E ata që i keni në pronësi tuaj dhe kërkojnë prej jush që t'i lironi...”

Këtu janë për qëllim shërbëtorët, skllëvërit, të cilët duan të lirohen në bazë të kompensimit. Atëherë këtyre duhet t'u mundësohet një gjë e tillë me marrëveshje⁷, bile duhen ndihmuar nga pasuria juaj, se ajo pasuri në origjinë është e Allahut të Lartmadhëruar sepse po të mos kishte dashur Allahu i Lartmadhëruar, nuk do ta posedoje atë pasuri.

Ajeti vazhdon me një ndalesë edhe më intime:

وَلَا تُكْرِهُوا فَتَيَاتِكُمْ عَلَى الْبِغَاءِ إِنْ أَرَدْنَ تَحَصُّنًا لِّبِتْعُو عَرَضَ الْحَيَاةِ
الدُّنْيَا وَمَنْ يُكْرِهْنَنَّ فَإِنَّ اللَّهَ مِنْ بَعْدِ إِكْرَاهِهِنَّ عَفُورٌ رَحِيمٌ

“...mos i detyroni robëreshat tuaja të bëjnë amoralitet, për shkak të ndonjë fitimi të kësaj bote, deri sa ato dëshirojnë të jenë të pastra.

7 Tema e skllëvërve është e gjerë, por meqë sot nuk ka skllëvër, nuk e shoh të dobishme diskutimin për një temë që mungon, por për fat të keq ne muslimanët jemi të robëruar ende në shumë fusha dhe nuk kemi liri për të vendosur vetë; robërim i civilizuar në aspektin politik, ekonomik, ideologjik, kulturor, tradicional, akademik, fetar si në trojet tona ashtu edhe nëpër botë.

E kush i detyron me dhunë të bëjnë atë, Allahu i fal ato pas atij detyrimi. Allahu fal dhe është mëshirues”.

Nga ky ajet na bëhet e qartë se është i ndaluar prostitucioni, kjo vepër e shëmtuar dhe padrejtësi e madhe që bëhej në kohët e mëhershme (injoranca paraislamike), por që po vazhdon edhe sot, madje ajo është bërë një formë për të arritur fitim material. Pra, kjo është një çështje (modë) shumë e hershme – paraislamike. Nga kjo konstatojmë se, nëse gjërat nuk gjykohen me Islam, atëherë janë të injorancës, pa e dalluar se çfarë kohe i takon, shekujve të mëhershëm a shekullit më të civilizuar siç mendon dikush.

Në qoftë se dikush thotë se kjo është e drejtë e njeriut, atëherë ne përgjigjemi: Vallë çfarë e drejte është që të detyrohen vajzat me dhunë në prostitucion?! Ajo që po detyrohet a nuk është njeri?!

E gjithë kjo bëhet nga disa individë të cilët pasurohen me nderin e dikujt, gjëja më e shtrenjtë që posedon njeriu. Edhe një herë themi se kjo është traditë e njerëzve të nivelit më të ulët.

Le t'i kthehemi komentimit të ajetit në fjalë. Shkaku i zbritjes së këtij ajeti është Abdullah ibën Ubej ibën Seluli, prijësi i munafikëve, i cili kishte një robëreshë me emrin Muadha. Ky munafik e kishte traditë që kur i vinin

mysafirë, ua linte robëreshën të kalonin natën me të, me qëllim që të merrte lëvdata prej tyre dhe ndonjë përfitim material. Kjo robëreshë shkoi tek Ebu Bekri, radijAllahu anhu, dhe iu ankua për një gjë të tillë, kurse Ebu Bekri, radijAllahu anhu, i tregoi Pejgamberit, alejhi selam, dhe ai urdhëroi që ajo t'i merrej atij, kurse munafiku bërtiti dhe tha: "Kush më ndihmon kundër Muhamedit, po m'i merr edhe robëreshat!"

Lidhur me këtë ngjarje Allahu i Lartmadhëruar përnjëherë shpalli këtë ajet kuranor.

Kjo ndalesë, e cila i bie me sëpatë imoralitetit të robëreshave me dhunë, derisa ato duan të jenë të pastra, për shkak të ndonjë fitimi të kësaj bote, u bë pjesë e Kuranit për ta pastruar ambientin e shoqërisë islame dhe për të mbyllur rrugët e fëlliqura për shfrenimin e epshit. Gjetja e vendeve dhe shkuarja pas prostitucionit largon shumë njerëz nga martesë, të cilët do të drejtoheshin përnjëherë kah ajo vepër e shëmtuar në vend që të martoheshin.

Nuk janë të vërteta thëniet e atyre që thonë se prostitucioni është metodë sigurie ndaj dhunës dhe se nuk ka rrugëdalje tjetër për përballimin e epshit, por vetëm në bazë të kësaj rruge të fëlliqur në rast të mungesës së martesës. Njerëzimi (muslimanët) duhet ta lehtësojnë një gjë të tillë (martesën) dhe mos t'i vonojnë fëmijët e tyre për martesë, bile ta lehtësojnë edhe në aspek-

tin ekonomik, me qëllim që individit i cili dëshiron të martohet, pa dallim gjinie, ta realizojë sa më lehtë një qëllim të tillë, përndryshe ai do të drejtohet drejt rrugëve të ndaluara dhe do të shtohen çrregullimet e ndryshme fetare, familjare, bashkëkohore, sëmundjet psikike, trupore e të tjera, ashtu siç po ndodhin gjëra të tilla çdo ditë. Mësuesi ynë, Muhamedi alejhi selam, thotë:

إذا جاءكم من ترضون خلقه و دينه فزوجوه إلا تفعلوا تكن فتنة في الأرض أ و فساد عريض
أخرجه الترمذي و ابن ماجه والحاكم و ذكره الشيخ الألباني في
الصحيحة برقم 1022

“Në qoftë se ju vjen ai të cilit ia pëlqeni moralin dhe fenë, martojeni. Më qoftë se nuk bëni këtë, do të bëhet sprovim (fitne) dhe çrregullim i madh.”

34 - وَلَقَدْ أَنْزَلْنَا إِلَيْكُمْ آيَاتٍ مُبَيِّنَاتٍ وَمَثَلًا مِّنَ الَّذِينَ خَلَوْا مِن قَبْلِكُمْ وَمَوْعِظَةً لِّلْمُتَّقِينَ

34. “Ne ju kemi shpallur juve argumente të qarta dhe shembuj nga ata që ishin para jush, e edhe kështu për të cilët duan ta ruajnë veten”.

Pra, Allahu i Lartmadhëruar në Kuranin Famëlartë ka zbritur argumente të qarta, në të cilat nuk ka asnjë lloj turbullire dhe as gjëra të dyshimta, qofshin ato që

kanë të bëjnë me besimin, rregulla dhe dispozita për çështje shoqërore mu në këtë sure, siç janë; akuzat, shpifjet, rregullat e imoralitetit, kërkimi i lejes për hyrje etj.. Allahu i Madhëruar në këtë Kuran zbriti edhe shembuj të popujve të mëhershëm, të cilët pasi kundërshtuan rrugën e Allahut, i goditi ndëshkimi pasi ia kthyen shpinën udhëzimit. Aliu, radijAllahu anhu, thotë për Kuranin :

“Në të (Kuran) ka dispozita për ju, tregime për ata të cilët ishin para jush, lajme për atë çka do të ndodhë. Ai është ndarës e nuk ka në të sende të paqarta, kush e lë (ia kthen shpinën), Allahu e ndan atë (njeri), e kush kërkon udhëzim jashtë Kuranit, Allahu e humb”.

35 - اللَّهُ نُورُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ مِثْلُ نُورِ كَمِشْكَاتٍ فِيهَا مِصْبَاحٌ الْمِصْبَاحُ فِي رُجَاجَةِ الرُّجَاجَةِ كَأَنَّهَا كَوْكَبٌ دُرِّيٌّ يُوقَدُ مِنْ شَجَرَةٍ مُبَارَكَةٍ زَيْتُونَةٍ لَا شَرْقِيَّةٍ وَلَا غَرْبِيَّةٍ يَكَادُ زَيْتُهَا يُضِيءُ وَلَوْ لَمْ تَمْسَسْهُ نَارٌ نُورٌ عَلَى نُورٍ يَهْدِي اللَّهُ لِنُورِهِ مَنْ يَشَاءُ وَيَضْرِبُ اللَّهُ الْأَمْثَالَ لِلنَّاسِ وَاللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

35. “Allahu është dritë (ndriçues, udhëzues) i qiejve e i tokës. Shembulli i dritës së Tij i ngjason kandilit të vendosur në një zgavër të errët. Kandili gjendet brenda një qelqi si të ishte yll flakërues e që ndizet prej (vajit të) një druri të bekuar, prej ullirit që nuk mund të quhet as

i lindjes e as i perëndimit, e vaji i tij ndriçon pothuajse edhe pa e prekur zjarri. Dritë mbi dritë. Allahu udhëzon kah drita e Vet atë që do Ai. Allahu sjell shembuj për njerëzit. Allahu çdo gjë di shumë mirë”.

Në mësimet e kaluara, Kurani ka shëruar gjërat më kryesore të njerëzimit, për ta pastruar dhe për ta ngritur atë deri në hapësirat e dritës. Ai ka shëruar çështjen e nderit dhe të gjakut, epshin e syrit dhe të organit. Ka shëruar me forcë dënimin e imoralitetit (zinasë) dhe shpifjes dhe ka shëruar gjerësisht një çështje të keqe dhe të turpshme, akuzimin e grave të ndershme, besimtare, të pafajshme, njëherësh ai ka shëruar me metoda të devotshmërisë lejen për hyrje nëpër shtëpi, ruajtjen e shikimeve dhe mosshfaqjen e bukurisë, ndalimin e gjërave provokuese, ngacmimin e epsheve, ndalimin e korrupsionit, çlirimin e robërve etj.. I gjithë ky shërim është bërë për mbrojtjen e origjinës dhe gjakut dhe për t'i përgatitur shpirtat për pastrim dhe lartësim, që ata të ndriçojnë.

Në ngjarjen e rrejshme (ifkun- iftiranë) janë shënuar disa gjëra që kanë sjellë pasoja të hidhërimit dhe urrejtjes dhe disa tronditje e mërzi te njerëzit. Mirëpo, pas një kohe vërejmë se Muhamedi, alejhi selam, është siguruar dhe qetësuar, po ashtu edhe Aishja, radijAllahu anha,

u qetësua, kurse Ebu Bekri, radijAllahu anhu, ua fali të gjithëve. Edhe Safuan ibën Muatili, radijAllahu anhu, u qetësua me dëshminë dhe pastrimin që ia bëri Allahu i Lartmadhëruar.

Në fund edhe shpirtrat e besimtarëve i gjen të pastër, të kthyer e të penduar, u sqarohen gjërat e dyshimta nga zemërligëtit, i kthehen Zotit të tyre falë mirësisë, mëshirës dhe udhëzimit të Tij. Me këto mësimë, sqarime e udhëzime është shëruar situata e njerëzimit derisa ndriçoi me dritë dhe arriti deri në kupë të qiellit e të tokës.

Pra, e gjithë kjo rezulton me dritë (e përdorur në mënyrë metaforike) dhe Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Allahu është ndriçues i qiejve dhe i tokës.”

اللَّهُ نُورُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ

Dijetarët islamë (komentuesit e Kuranit) kanë shprehur disa mendime gjatë komentimit të këtij ajeti, por ne do të përmbledhim dy më kryesoret:

1. Rregullues (Renditës) i qiejve dhe i tokës dhe prandaj ajo ndriçon.

2. Jeta e besimtarit, që i përmbahet besimit në Allah, Kuranit dhe udhëzimeve profetike, ndriçon.

Allahu është ndriçues i qiejve dhe i tokës.

اللَّهُ نُورُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ

Fillimisht ka filluar me ndriçimin e Vetvetes e pastaj ka cekur dritën e besimtarit, ku thotë: **“Shembulli i dritës”** مَثَلُ نُورِهِ – d.m.th. ai që beson në të.

Një komentues i Kuranit i quajtur En-Nesefij thotë: “Në komentimin e këtij ajeti: **“Allahu është dritë e qiejve dhe e tokës”**

اللَّهُ نُورُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ

kuptojmë se “me dritën e Tij janë ndriçuar qiejt dhe toka”, ndërsa në një transmetim të Ibën Mesudit, radij Allahu anhu, thuhet: “Te Zoti juaj nuk ka as natë e as ditë, drita e Arshit është nga ndriçimi i Tij”. Edhe në disa hadithe të Pejgamberit, alejhi selam, është cekur:

“O Zoti im, Ti je drita e qiejve dhe e tokës.”

اللهم أنت نور السموات والأرض

Në një tjetër hadith kur është pyetur Pejgamberi, alejhi selam, nga ana e shokëve kur shkoi në miraxh tek Allahu, se a e ka parë Zotin?, ai është përgjigjur: *“Dritë më është paraqitur* أَنَّى نَورَ أَرَادَ.”

Ndërsa në një transmetim tjetër thotë: *“Kam parë dritë”*.

مَثَلُ نُورِهِ كَمِشْكَاةٍ فِيهَا مِصْبَاحٌ

“Shembulli i dritës së Tij i ngjason kandilit të vendosur në një zgavër të errët...”

Qëllimi i kësaj pjese të ajetit merr dy kuptime:

a) kthehet tek Allahu i Madhëruar, d.m.th. shembulli i udhëzimit në zemër të besimtarit,

b) kthehet te vetë besimtari, që kuptohet sipas vetë fjalës, e cila nënkupton shembullin e dritës së besimtarit të cilit zemra i shndrit si kandil.

Nga kjo kuptojmë se besimtarin e përngjan me pastërtinë dhe origjinalitetin e vet, si një kandil qelqi i hollë e i ndritshëm, pra është ai që u përmbahet rregullave kuranore.

Në qoftë se i kthehemi ajetit, prapë do të hasim se Allahu i Lartmadhëruar ka cekur disa grada të dritës. Fillimisht cek se është një kandil i vendosur në zgavër të errët, kjo me të vërtetë ndriçon shumë, por Allahu i Lartmadhëruar nuk mjaftohet me këtë, por cek edhe disa shkallë të tjera, saqë në fund thotë:

Dritë mbi dritë. نُورٌ عَلَىٰ نُورٍ

Kandili gjendet brenda një qelqi... الْمَصْبَاحُ فِي زُجَاجَةٍ,
që do të thotë se kjo dritë ndriçon brenda qelqit.

Disa komentues, ndër ata edhe Ubeje ibën Kabi, thonë: “Kjo është e njëjtë si zemra e besimtarit, e cila gjendet brenda trupit.”

Qelqi si të ishte një yll flakëruar. الزُّجَاجَةُ كَأَنَّهَا كَوْكَبٌ دُرِّيٌّ

Kjo i përngjan atij ylli që shkëputet dhe bie, që gjatë rënies së tij ndriçon më shumë se kur është në një vend.

يُوقَدُ مِنْ شَحَرَةٍ مُبَارَكَةٍ زَيْتُونَةٍ لَا شَرْقِيَّةٍ وَلَا غَرْبِيَّةٍ

“E që ndizet prej (vajit) një drurit të bekuar – prej ullirit që nuk mund të quhet as i lindjes e as i perëndimit”.

Dmth aso lloj ndriçimi të fortë merr, aq sa të ndizet vaji i ullirit (meqë Allahu drurin e ullirit e ka bekuar saqë është betuar në të duke thënë:

“Betohem për fikun dhe ullirin”. (Tinë,1) وَاللَّيْنِ وَالزَّيْتُونِ

Është për çudi pse përmendet fjala:

“Që nuk mund të quhet as i lindjes e as i perëndimit”.

Dijetarët komentojnë se vaji më i mirë i ullirit është ai i cili është në një hapësirë (sahra) të cilën e kap dielli prej fillimit të lindjes e deri në mbarim të perëndimit, d.m.th. nuk i humb rrezja e diellit në asnjë moment, po ashtu edhe nuk e pengon asnjë hije tjetër, qoftë ajo hije e ndonjë peme tjetër apo ndonjë kodër etj.

Nga kjo konstatojmë se si Allahu i Lartmëdhëruar i do gjërat e kulluara dhe origjinale. Dmth, për të qenë vepra e pranuar, duhet të jetë e kulluar dhe e pastër si vaji që nxirret nga ulliri të cilin nuk e ka kapur asnjë lloj hije.

...Dritë mbi dritë... نُورٌ عَلَى نُورٍ

Ibën Abasi, radijAllahu anhumu, thotë: “Kjo do të thotë imani (besimi) i robit dhe puna e tij.”

Ndërsa të tjerët thonë: “Drita e zjarrit dhe drita e vajit”, kurse Ubeje ibën Kabi thotë: “Kjo radhitet në pesë drita:

1. Fjala është dritë.
2. Vepra është dritë.
3. Hyrja në vende të mira (xhami apo vende në të cilat është i kënaqur Allahu i Lartmadhëruar) është dritë.
4. Dalja është dritë (nga vendet e lartpërmendura) dhe
5. Shkuarja për në xhenet në Ditën e Gjykimit është dritë”.

Tefsir Ibën Kethir, komenti i këtij ajeti.

Njëherë Ibën Abasi, radijAllahu anhumu, shkoi te Kab el Ahbari dhe e pyeti: “Më trego për kuptimin e ajetit:

يَكَادُ رَيْثُهَا يُضِيءُ وَلَوْ لَمْ تَمْسَسْهُ نَارٌ

“Vaji i tij ndriçon pothuajse pa e prekur zjarri”.

Ai u përgjigj: “Muhamedi, alejhi selam, ua sqaronte njerëzve çështjet e fesë edhe nuk e pranonin se është Pejgamber, mirëpo ai e vazhdonte misionin e tij (dritën), edhe pse ata nuk e pranonin, si ai vaji që do të ndriçonte pa e prekur zjarri”.

“Allahu udhëzon kah drita e Vet atë që do Ai”.

يَهْدِي اللَّهُ لِنُورِهِ

Ibën Abasi, radijAllahu anhumâ, thotë: **“Allahu e udhëzon”** në fenë islame atë që do dhe ajo është drita e syrit. Këtë udhëzim e përfshin: imani (besimi), islami (dorëzimi) dhe ihsani (mirësia).

Dmth, Allahu i Lartmadhëruar udhëzon në të gjitha këto atë që do nga robërit e Tij, nga ata të cilët e duan dhe e kërkojnë udhëzimin dhe punojnë për të”.

وَيَضْرِبُ اللَّهُ الْأَمْثَالَ لِلنَّاسِ وَاللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

“Allahu sjell shembuj për njerëzit. Allahu është për çdo gjë i Gjithëditur”.

Kjo tregon se Allahu i Lartmadhëruar është më i ditur se kush e meriton udhëzimin dhe humbjen.

Transmetohet nga Ebu Seid el Hudrij, radijAllahu anhu, se Pejgamberi, alejhi selam, ka thënë:

“Zemrat janë katër llojesh:

- 1. zemër e kulluar (e pastër), si kandili që ndriçon,*
- 2. zemër e mbyllur, e lidhur në mbështjellësin e saj,*
- 3. zemër e rrotulluar dhe*
- 4. zemër e gjerë”.*

Imam Ibën Kethiri dhe Shevkani për këtë hadith kanë thënë se zinxhiri i këtij hadithi është i mirë, ndërsa Imam Albani thotë i vërtetë (sahih).

“Ajo zemër, e cila është e kulluar dhe e pastër, është zemra e besimtarit, e cila i ngjason kandilit që ndriçon. Zemra e cila është e mbyllur është zemra e jobesimtarit (qafirit).

Zemra e rrotulluar është zemra e hipokritit (munafikut), e cila e ka shijuar të vërtetën dhe e ka mohuar.

Zemra e gjerë është ajo e cila mban në vete imanin (besimin) dhe hipokrizinë (nifakun).

Shembulli i besimit të asaj (zemre) është sikur ajo toka pjellore, e cila e rrjedh (buron) ujin dhe jep fryte.

Ndërsa shembulli i saj (zembrës) që mban në vete hipokrizi (nifak) është sikur plaga (i thati që gjendet në bark), e cila rrjedh gjak dhe qelb. E cili rrjedhim (ujë i mirë apo gjaku dhe qelbi) e mund njëri-tjetrin, ai e mund edhe njeriun dhe në fund ai anon nga ajo”.

36 - فِي بُيُوتِ الَّذِينَ اللَّهُ أَنْ تَرْفَعَ وَيُذَكَّرَ فِيهَا اسْمُهُ يُسَبِّحُ لَهُ فِيهَا بِالْغُدُوِّ وَالْآصَالِ

36. “Në xhamitë (objektet) që u ngritën me urdhrin e Allahut, që në to të përmendet emri i Tij, për t’i bërë lutje Atij në mëngjes e mbrëmje”.

Kur Allahu i Lartmadhëruar solli shembull zemrën e besimtarit dhe çka përmban ajo nga udhëzimet e diturisë, me një kandil i cili është në një qelq flakërues, i cili ndizet nga një vaj i pastër dhe i bukur, të njëjtën gjë e

ka cekur me xhamitë, të cilat janë vendet më të dashura të Allahut të Lartmadhëruar se çdo vend tjetër në tokë, sepse ato janë shtëpitë e Tij në të cilat Ai adhurohet.

Për këtë Said ibën Xhubejri, radijAllahu anhu, transmeton nga Ibën Abasi, radijAllahu anhu, se ka thënë:

“Xhamitë janë shtëpitë e Allahut në tokë. E ato e ndriçojnë qiellin siç e ndriçojnë yjet tokën.” (Transmeton El Hejthemij në librin e tij “Muxhmea ez Zevahid”).

Ndërsa në disa transmetime të tjera është cekur se këtu ka për qëllim katër xhamitë që ndërtuan Pejgamberët:

- Qabenë e kanë ndërtuar (Ademi) kurse e ka riparuar Ibrahim i dhe Ismaili, alejhimu es-selam, dhe e kanë bërë kible.

- Bejtul Makdisin (Kudsin në Palestinë) e kanë ndërtuar Davudi, dhe Sulejmani, alejhi selam.

- Xhaminë e Kubasë, e cila është në Medinë, e cila është ndërtuar për devotshmëri, e ka ndërtuar Muhamedi, alejhi selam.

- Xhaminë e Medinës e ka ndërtuar Muhamedi, alejhi selam.

Sidoqoftë këtu përfshihen të gjitha xhamitë në të cilat ngrihet zëri dhe madhërohet Allahu i Lartmadhëruar, por këto katër xhami e kanë vlerën shumë më të madhe se të tjerat.

Për vlerën e tyre na tregon Muhamedi, alejhi selam, i cili thotë se: Një namaz në Qabe është sa njëqind mijë namaze në xhamitë e tjera, ndërsa një namaz në xhaminë e tij në Medinë është sa një mijë namaze në xhamitë e tjera.

Për xhaminë e Kuds Esh Sherif thotë se një namaz në të është sa pesëqind namaze.

Edhe për në Xhaminë Kuba ka dhënë vlerësim, për të cilën Pejgamberi, alejhi selam, thotë: *“Kush shkon në xhaminë Kuba dhe fal dy rekate, i llogaritet si të ketë bërë një umre.”*

Ndërsa për xhamitë e tjera Ebu Hurejra, radijAllahu anhu, thotë se Muhamedi, alejhi selam, ka thënë:

“Kush e fal namazin me xhemat në xhami ka vlerën sa njëzet e pesë herë më shumë,” ndërsa në një tjetër transmetim thotë: *“sa njëzet e shtatë sevape”*. Mutefekun alejhi.

Janë përmendur disa hadithe të cilat kanë të bëjnë me vlerën e xhamisë, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Prijësi i besimtarëve Othman ibën Afani, radijAllahu anhu, thotë: “Kam dëgjuar Pejgamberin, alejhi selam, duke thënë:

“Kush ndërton xhami dhe me atë shpreson pëlqimin e Allahut, Allahu të njëjtën do t’ia ndërtojë në xhenet.”
(Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi).

Transmetime të tjera kanë ardhur edhe mbi vlerësimin e ndërtimit apo të mirëmbajtjes së xhamisë. Allahu thotë:

أَنْ تَرْفَعُ وَيُذَكَّرَ فِيهَا اسْمُهُ يُسَبِّحُ لَهُ فِيهَا بِالْغُدُوِّ وَالْآصَالِ

“Emri i Tij ngrihet në qiell me madhështi në mëngjes dhe pasdite ose në mbrëmje”.

Komentuesit e Kuranit kanë thënë se këtu janë për qëllim pesë kohët e namazeve: në mëngjes është namazi i sabahut, ndërsa pasdite dreka dhe ikindia, ndërsa në mbrëmje akshami dhe jacia.

37- رِجَالٌ لَا تُلْهِيهِمْ تِجَارَةٌ وَلَا بَيْعٌ عَنْ ذِكْرِ اللَّهِ وَإِقَامِ الصَّلَاةِ وَإِيتَاءِ الزَّكَاةِ يَخَافُونَ يَوْمًا تَتَقَلَّبُ فِيهِ الْقُلُوبُ وَالْأَبْصَارُ

37. “Janë disa burra të cilëve as tregtia dhe as shitblerja nuk ua largon vëmendjen nga të kujtuarit e Allahut (përmendje e Tij), falja e namazit dhe dhënia e zekatit, të tillët i kanë frikë një dite e cilën do të tronditen zemrat dhe shikimet”.

Në goftë se ndalemi në këtë ajet dhe e krahasojmë me atë para tij, do të hasim se ka lidhshmëri të fortë, saqë disa thonë se është vazhdim i ajetit para tij. Në xhamitë e Allahut ka urdhëruar që të ngrihet zëri i Tij në qiell me madhështi paradite dhe pasdite.

Pyetja: Kush e ngre zërin në shtëpitë e Allahut të Lartmadhëruar pandërprerë?

Përgjigjja: Burrat të cilëve as tregtia e as shitblerja nuk ua largon vëmendjen nga të përkujtuarit e Allahut .

Në një ajet Allahu i Lartmadhëruar thot:

مِنَ الْمُؤْمِنِينَ رِجَالٌ صَدَقُوا مَا عَاهَدُوا اللَّهَ عَلَيْهِ فَمِنْهُمْ مَنْ قَضَىٰ نَحْبَهُ
وَمِنْهُمْ مَنْ يَنْتَظِرُ وَمَا بَدَّلُوا تَبْدِيلًا

“Nga besimtarët ka burra që e mbajtën me të vërtetë besën me Allahun”. (El Ahzab: 23)

Esma, bija e Jezidit thotë: “Muhamedi, alejhi selam, ka thënë: *“Allahu i bashkon njerëzit në Ditën e Gjykimit në një vend – i thërret një thirrës (zë) dhe ua lëshon shikimin, ngrihet një thirrës e thërret: “Ku janë ata të cilët e falënderonin Allahun në rehati dhe vështirësi?” E ata do të ngrihen, megjithëse ata janë pak e do të hyjnë në xhenet pa llogari. E prapë kthehet e thërret: “Ku janë ata të cilët pjesët e trupit të tyre ngrihen nga shtrati (për t’u falur)?”* Es Sexhdeh: 16

تَسْحَافِي جُنُوبُهُمْ عَنِ الْمَضَاجِعِ

Dhe ata ngrihen megjithëse janë pak dhe do të hyjnë në xhenet pa llogari. Prapë kthehet e thërret: “Ku janë ata të cilëve nuk ua largonte mendjen nga Allahu as shitja e as blerja?” Ata do të ngrihen megjithëse janë pak dhe do të hyjnë në xhenet pa llogari. E në fund ngrihen të gjithë

njerëzit dhe fillon llogaria e tyre." (Transmeton Hakimi dhe e kanë vërtetuar Bejhakiu dhe Mirdavejhu).

Mirëpo shtrohet pyetja:

Si është puna e namazit të grave?

Namazi më i mirë i gruas është ai që bëhet në shtëpi të vet, duke pasur parasysh pasojat që mund të ndodhin dhe se Pejgamberi, alejhi selam, na ka njoftuar në disa hadithe. Imam Ahmedi transmeton nga Umi Seleme, radijAllahu anha, se Pejgamberi, alejhi selam, ka thënë:

"Xhamia më e mirë e grave është brenda shtëpive të veta."

Lejohet që ato ndonjëherë të dalin në xhami, mirëpo kushtëzohet që të mos u shkaktojnë pengesa burrave duke mos u shfaqur diçka nga bukuria e tyre apo të jenë të parfumuara.

Kjo është e transmetuar nga Abdullah ibën Omeri, radijAllahu anhum, se Pejgamberi, alejhi selam, ka thënë: *"Mos i ndaloni robëreshat e Allahut nga xhamitë e Allahut!"* (Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi).

Ndërsa në një tjetër hadith, i cili transmetohet nga Ibën Mesudi, radijAllahu anhu, Resulullahu, alejhi selam, ka thënë: *"Në qoftë se del ndonjëra prej jush (gratë), mos përdorni parfum!"*

Nga këto hadithe të Pejgamberit, alejhi selam, konstatojmë se dalja e gruas në xhami është e kufi-

zuar, por edhe ai kufizim kushtëzohet, që të mos shfaqë diçka prej stolive të saj dhe të mos jetë e parfumuar, përndryshe nuk i lejohej të shkojë as në xhami.

Do të flasim për gratë e muslimanëve sot apo do të bëjmë një krahasim me to:

1. Nuk dalin në xhami kurrë (edhe pse nuk kërkohet prej tyre).
2. Çdo ditë gjejnë nga një vizitë diku, fqinje, të afërme, përgëzime, ngushëllime, në treg, te mjeku e të tjera, d.m.th. nuk u ngel ditë pa dalë nga shtëpitë e tyre.
3. Edhe pse dalin, vallë si dalin ato? Ndoshta për burrat e tyre kurrë nuk u shkon mendja që të parfumohen e të zbukurohen! Kur pyeten pse, ato përgjigjen se kanë shumë ngarkesa, shumë punë dhe nuk mund të gjejnë kohë, ndërsa kur dalin jashtë shtëpisë, qoftë edhe për ngushëllime, pa u zbukuruar bile pak nuk dalin.

Ndërsa Pejgamberi, alejhi selam , thotë:

“Ajo grua e cila del nga shtëpia e vet e parfumuar dhe te tjerët ia ndiejnë erën, ajo është lavire (zinaqare)”.

4. Ajo që është më e keqja dhe më brengosëse është se burri i saj shkon çdo ditë në xhami dhe në aspektin material është bukur ngushtë, por për t’ia plotësuar këto dëshira gruas, vajzës, të rejës së tij, nuk ndien asnjë lloj pengese, edhe pse e di se të tjerët ia shohin stolitë kur ajo del nga shtëpia.

Kur Pejgamberi, alejhi selam, ishte duke i këshilluar shokët e vet, njëherë u tha: *“Dejuthi kurrë nuk do të hyjë në xhenet.” Të pranishmit e pyetën: “Kush është dejuth, o i Dërguari i Allahut?” Ai u përgjigj: “Ai që nuk ka xhelozin (nuk xhelozon) ndaj nderit të vet.”*

Vallë, çfarë krahasimi bëhet mes burrave të cilët i ka lavdëruar Allahu dhe burrave sot...?!

Allahu i Lartmadhëruar i ka vlerësuar këta burra të cilët nuk i pengon shitblerja në kohët e namazit, d.m.th. kur vjen koha e namazit, ata menjëherë i ndërpresin punët, saqë thuhet se disa nga këta burra kur dëgjonin ezanin, në qoftë se kishin peshoren në dorë, menjëherë e lëshonin në tokë.

Pra, ata që i nënshtrohen namazit në këtë mënyrë, ashtu i nënshtrohen edhe zekatit.

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تُلْهِكُمْ أَمْوَالُكُمْ وَلَا أَوْلَادُكُمْ عَنْ ذِكْرِ اللَّهِ وَمَنْ يَفْعَلْ ذَلِكَ فَأُولَئِكَ هُمُ الْخَاسِرُونَ

“O ju që besuat, as pasuria juaj e as fëmijët tuaj të mos u shmangin prej adhurimit të Allahut...”

(Munafikun, 9)

Dhe në një tjetër ajet Allahu i Lartmadhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَى ذِكْرِ اللَّهِ وَذَرُوا الْبَيْعَ

“O ju që besuat, kur bëhet thirrja për namaz, ditën e xhumasë, nxitoni shpejt për aty ku përmendet Allahu (dëgjojeni hutben, faleni namazin), e lini shitblerjen (dhe çdo punë tjetër)...” (El Xhuma, 9)

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

يَخَافُونَ يَوْمًا تَتَقَلَّبُ فِيهِ الْقُلُوبُ وَالْأَبْصَارُ

“Ata i frikësohen një dite kur të tronditen zemrat dhe shikimet (nga tmërri i ndëshkimit të Ditës së Llogarisë)”.

38 - لِيَجْزِيَ اللَّهُ أَحْسَنَ مَا عَمِلُوا وَيَزِيدَهُمْ مِنْ فَضْلِهِ وَاللَّهُ يَرْزُقُ
مَنْ يَشَاءُ بِغَيْرِ حِسَابٍ

38. “(Ata bëjnë këto vepra të mira – adhurime që) Allahu t’i shpërblejë më së miri për atë që punuan dhe për t’ua shtuar të mirat nga Ai. Allahu i dhuron pa masë atij që do”.

Komentuesit e Kuranit janë të një mendimi se shpërblimi më i mirë me të cilin Allahu shpërblen është xheneti dhe nga kjo konstatojmë se ata të cilët nuk i pengon shitblerja (tregtia në kohën e namazit apo çdo vepër tjetër) dhe falin namazin e japin zekatin dhe i frikësohen Ditës së Gjykimit, shpërblimi i tyre do të jetë xheneti.

Dihet se Allahu i Lartmadhëruar për veprat e mira nuk e shpërblen besimtarin një për një, por një për dhjetë, d.m.th. çdo vepër ka shpërblimin sa dhjetë, bile edhe namazin kur e fal, nuk shpërblehet sa një namaz, po sa dhjetë namaze.

Këtë e dimë nga ajo se në fillim kanë qenë të obliguara pesëdhjetë namaze, mirëpo Pejgamberi, alejhi selam, kur ishte tek Allahu i Lartmadhëruar në miraxh, e luti që të na e lehtësonte dhe pastaj Allahu i Lartmadhëruar e zbriti deri në pesë dhe tha:

“Këto pesë me vlerë sa pesëdhjetë”.

روى مسلم من حديث أبي ذر رضي الله عنه قال:
قال النبي صلى الله عليه وسلم : يقول الله عز وجل من جاء
بالحسنة فله عشر أمثالها .

Imam Muslimi transmeton nga Ebi Dherri, radijAllahu anhu, i cili thotë se Resulullahu, alejhi selam, ka thënë: “Allahu i Lartmadhëruar thotë: “Kush e bën një vepër të mirë, shpërblimin e ka sa dhjetë të tilla”.

Nga kjo konstatojmë se Allahu i Lartmadhëruar dhuron pa masë dhe kjo është vetëm për besimtarin.

Por, si është çështja e jobesimtarit, që ndonjëherë bën edhe ndonjë vepër të mirë? Allahu i Lartmadhëruar për këtë thotë:

39 - وَالَّذِينَ كَفَرُوا أَعْمَاهُمْ كَسْرَابٍ بِقَيْعَةٍ يَحْسَبُهُ الظَّمَانُ مَاءً حَتَّىٰ
إِذَا جَاءَهُمْ لَمْ يَجِدْهُ شَيْئًا وَوَجَدَ اللَّهَ عِنْدَهُ قَوَّاهُ حِسَابُهُ وَاللَّهُ سَرِيعُ
الْحِسَابِ

39. “E veprat e atyre që nuk besuan janë si valët (nga rrezet e diellit - fatamorgana) në një rrafshinë ku i etshmi mendon se është ujë derisa kur t’i afrohet atij nuk gjen asgjë, por aty e gjen Allahun dhe ai do t’ia japë llogarinë e tij. Allahu është i shpejtë në llogaritje”.

Në këtë ajet dhe në atë vijues përshkruhet gjendja e jobesimtarëve në mënyrë shumë interesante. Pikësëpari veprat e tyre përshkruhen si valë (mjegullat ***fatamorgana***) në një tokë të shtrirë (rrafshinë), e cila ndriçon me një ndriçim të rrejshëm dhe të cilin i eturi e ndjek. Ai pret të gjejë atë që është duke parë (ujin), mirëpo i shkreti nuk di se çka do ta gjejë atje... papritmas ndryshon gjendja me një befasi të fortë.

Ky njeri, i cili vrapon pas valëve, i eturi që shpreson të gjejë ujë, injoranti që injoron se ç’po e pret atje, arrin te vendi, por nuk gjen ujin e shpresuar, mirëpo e pret befasia e papritur, për të cilën as që i shkon ndër mend.

Ajo është befasia e trishtueshme që ia këput shpresat dhe që shkakton çmendje e shkatërrim, por aty e gjen

Allahun, të Cilin e ka mohuar gjatë jetës, e ka kundërshtuar e nuk e ka respektuar dhe as që e ka adhuruar.

Në atë vend do ta gjejë duke e pritur. Po ta gjente në këtë befasi armikun e vet nga radhët e njerëzve, ai do të trishtohej sepse është i papërgatitur. Si do të jetë gjendja e atij që do të ballafaqohet me Allahun e Lartmadhëruar, të fortin, hakmarrësin, mbizotëruesin...? Aty për aty do të bëhet llogaria e tij. Kështu në shpejtësi bëhet llogaria e tij, befas dhe papritmas sepse **“Allahu është i shpejtë në llogaritje.”** (El-Bekare: 202).

وَاللَّهُ سَرِيعُ الْحِسَابِ

Kjo është një pasqyrë se si do të jetë gjendja e jobesimtarëve në Ditën e Kiametit, ku çdo moment për jobesimtarin do të jetë i papritur.

Po ata që kanë bërë vepra të mira, edhe pse janë jobesimtarë? Drejtësia e Allahut ka bërë që ata të shpërblehen me të mira në këtë botë, ndërsa në botën tjetër ato vepra do t’u bëhen pluhur e hi. Ata para veprave të mira duhet të kishin poseduar një gjë edhe më të rëndësishme se veprat e tyre, që është besimi në Zotin një, sepse ajo është më e rëndësishmja. E kundërta e këtij është ai i cili kurrë nuk ka vepruar vepra të mira, por ka besuar në Allahun një, ai nuk do të jetë i përhershëm në xhehenem, d.m.th. pasi t’i lajë mëkatet e veta, do të hyjë

në xhenet edhe pse kurrë në jetë nuk ka vepruar vepër të banorëve të xhenetit. Për jobesimtarët që posedojnë ndonjë vepër të mirë, por nuk posedojnë besim, Allahu i Lartmadhëruar thotë:

وَقَدِمْنَا إِلَىٰ مَا عَمِلُوا مِنْ عَمَلٍ فَجَعَلْنَاهُ هَبَاءً مَّنْثُورًا

“E Ne i kthehemi ndonjë vepre që e bënë ata (jobesimtarët) dhe e bëjmë atë për hi e pluhur”.

(El Furkan, 23)

40 - أَوْ كَظُلُمَاتٍ فِي بَحْرِ لُّجِّيٍّ يَعْشَاهُ مَوْجٌ مِنْ فَوْقِهِ مَوْجٌ مِنْ فَوْقِهِ
سَحَابٌ ظُلُمَاتٌ بَعْضُهَا فَوْقَ بَعْضٍ إِذَا أَخْرَجَ يَدَهُ لَمْ يَكِدْ يَرَاهَا وَمَنْ
لَمْ يَجْعَلِ اللَّهُ لَهُ نُورًا فَمَا لَهُ مِنْ نُّورٍ

40. “Ose (gjendja e mosbesimtarit apo veprat e tyre) janë si errësirat në det të thellë të cilin e mbulojnë valët mbi valë dhe mbi ato retë e dendura, pra errësira njëra mbi tjetrën, saqë nuk mund ta shohë ai as dorën e vet. Atij të cilit Allahu nuk jep dritë, ai nuk ka për të pasur dritë”.

Kjo është pasqyra e dytë në të cilën Allahu i Lartmadhëruar përshkruan gjendjen e jobesimtarëve.

E para ishte ajo që u përmend më lart (në ajetin e mëparshëm), ndërsa e dyta kjo. Pas çdo rrezatimi të

rrejshëm rezulton errësira⁸ dhe paraqitet trishtimi në errësirën e detit të thellë të mbuluar valë mbi valë, mbi të cilin ka re, shkallëzohen errësirat njëra mbi tjetrën, saqë edhe nëse e vendos dorën e tij përpara vetes, atë nuk do ta shohë nga trishtimi dhe nga errësira e madhe. Ky është kufri (mohimi), errësirë e shkëputur nga drita e Zotit, i humbur në errësirë, një humbje ku nuk sheh zemra asnjë shenjë të afërt për udhëzim.

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

وَمَنْ لَّمْ يَجْعَلِ اللَّهُ لَهُ نُورًا فَمَا لَهُ مِنْ نُّورٍ

“Dhe atij që nuk i jep Allahu dritë, ai nuk mund të gjejë dritë.”

Kurse drita e Allahut të Lartmadhëruar është udhëzimi në zemër, hapja e syve dhe lidhshmëria me natyrshmërinë dhe argumentet që ka sjellë Allahu i Lartmadhëruar në qiej dhe në tokë. Ndërsa takimi me

8 Qëllimi i fjalës **errësirë** është vepra e mohuesit (jobsimtarit), ndërsa **deti i gjerë** – zemra e tij, kurse **valë mbi valë** – të mbuluarit e zemrës nga injoranca, dyshimi dhe mospërfillja, kurse **retë** – ngurtësimi dhe vulosja në zemrën e tij.

Për këtë Ubej Ibën Kabi thotë: “Jobsimtari rrotullohet në pesë errësira:

1. fjala e tij është errësirë,
2. veprat e tij janë në errësirë,
3. hyrja errësirë,
4. dalja errësirë dhe
5. vajtja në Ditën e Gjykimit në errësirë të zjarrit (xhehenemit).”

ato (argumente) është drita e Allahut të Lartmadhëruar në qiej dhe në tokë.

Kush nuk i bashkëngjitet kësaj drite, ai do të jetë në errësirë të pazbuluar, në një kundërshtim të pasigurt, në një humbje pa kthim dhe fundi i punës së tij është si valët që rrezatojnë për të eturin e të humburin, të cilat e dërgojnë në një shkatërrim dhe dënim, sepse nuk ka vepër pa besim, e nuk ka përmirësim pa besim. Udhëzimi dhe drita e Allahut të Lartmadhëruar janë më të vërteta.

41 - أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ يُسَبِّحُ لَهُ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَالطَّيْرِ صَاقَاتٍ كُلِّ قَدْ عَلِمَ صَلَاتَهُ وَتَسْبِيحَهُ وَاللَّهُ عَلِيمٌ بِمَا يَفْعَلُونَ

41. “A nuk e vëren ti (o Muhamed) se Allahu është Ai të cilin e madhëron gjithkush që është në qiej e në tokë, madje edhe shpezët duke i hapur krahët e tyre gjatë fluturimit. Ai (Zotì) di lutjen dhe lavdërimet e çdonjërit (nga ata)”.

Në këtë ajet kuranor vërejmë se Allahun e Madhëruar e madhëron çdo krijesë, qofshin ato melaïke, njerëz, xhinë, kafshë dhe sende të ngurta, ashtu siç thotë Allahu i Madhëruar në një tjetër ajet, në suren Isra, 44:

تُسَبِّحُ لَهُ السَّمَاوَاتُ السَّبْعُ وَالْأَرْضُ وَمَنْ فِيهِنَّ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ وَلَكِنْ لَا تَفْقَهُونَ تَسْبِيحَهُمْ

“Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt e toka dhe çka ka në to, e nuk ka asnjë send që nuk e madhëron (nuk i bën tesbih) duke i shprehur Atij falënderim, por ju nuk e kuptoni atë madhërim...” (El-Israë, 44)

Njeriu nuk qenka i vetmi në këtë hapësirë të gjerë, rreth tij dhathtas dhe majtas, sipër e poshtë, kah t'i kthejë sytë a t'i shkojë mendja, ka të tjerë që e adhurojnë Zotin, melaiket, xhinët, qiejt, toka kodrat, thjesht çdo send Atë e madhëron, por ne nuk e kuptojmë.

Kurani e orienton njeriun të shikojë përreth tij krijesat që ka krijuar Allahu i Lartmadhëruar, po ashtu edhe krijesat që janë edhe më larg, qofshin ato në qiej e në tokë, se si ato e madhërojnë Zotin e tyre, madje kur t'i kthehet shikimi edhe te shpezët që qarkullojnë dhe fluturojnë, me këmbë ecin nëpër tokë e me krahët e tyre fluturojnë, në të njëjtën kohë e madhërojnë Zotin.

Çdonjëri prej tyre e falënderon Allahun e Madhëruar sipas mënyrës që i ka mësuar Allahu, ndërsa njeriu është i vetmi që e injoron falënderimin e Zotit të vet, edhe pse është më i obliguari që të besojë dhe ta adhurojë Zotin e vet. Domethënë, krejt hapësira është e orientuar të adhurojë Zotin e vet, ta falënderojë (të bëjë tesbih), sepse për atë është e krijuar. Muhamedi, alejhi selam, kur ecte, dëgjonte gurët duke e madhëruar Zotin.

Këtë e argumenton hadithi i Xhabirit, të birit të Semures, radijAllahu anhu, se Resulullahu, alejhi salam, ka thënë: “Unë njoh gurë në Mekë, i cili më jepte salam (përshëndeste) edhe para se të isha Pejgamber”. (Transmeton Muslimi) .

Ndërsa në një tjetër transmetim nga Aliu, i biri i Talibit, radijAllahu anhu, ai thotë: “Isha me Resulullahun, alejhi salam, në Mekë dhe dolëm të shëtisim nëpër periferi të saj. Sa herë që takonte ndonjë gur apo pemë, nuk e linin pa e përshëndetur e duke i thënë: -Esselamu alejke ja Resulullah!” (Transmeton Tirmidhiu).

42 - وَلِلَّهِ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَإِلَى اللَّهِ الْمَصِيرُ

42. “Vetëm i Allahut është i tërë sundimi i qiejve e i tokës dhe vetëm tek Ai kthehet çdo gjë”.

Çdo send që adhuron Zotin e vet, i gjithë ai adhurim në Ditën e Gjykimit kthehet te Zoti për t’u shpërblyer secili për atë që ka vepruar.

Ai gjykon siç do dhe për këtë Allahu i Lartmadhëruar në suren En Nexhm thotë:

وَلِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ لِيَجْزِيَ الَّذِينَ أَسَاءُوا بِمَا عَمِلُوا
وَيَجْزِيَ الَّذِينَ أَحْسَنُوا بِالْحُسْنَى

“Dhe vetëm të Allahut janë ç’ka në qiej dhe në tokë - për t’i shpërblyer ata që bënë keq me të

keqen e tyre dhe për t'i shpërblyer ata që bënë mirë me të mirën e tyre". (En-Nexhm 31)

43 - أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ يَرْجِي سَحَابًا ثُمَّ يُؤَلِّفُ بَيْنَهُ ثُمَّ يَجْعَلُهُ رُكَامًا فَتَرَى الْوَدْقَ يَخْرُجُ مِنْ خِلَالِهِ وَيُنَزِّلُ مِنَ السَّمَاءِ مِنْ جِبَالٍ فِيهَا مِنْ بَرَدٍ فَيُصِيبُ بِهِ مَنْ يَشَاءُ وَيَصْرِفُهُ عَنِ مَنْ يَشَاءُ يَكَادُ سَنَا بَرْقِهِ يَذْهَبُ بِالْأَبْصَارِ

43. "A nuk e vëren se si Allahu drejton retë me ngadalësi, pastaj i bashkon, i grumbullon njëra mbi tjetrën e ti e sheh shiun se si rrjedh prej tyre. Ai lëshon nga qielli edhe male me breshër dhe me te goditë këdo, e ia largon atij që do. Drita e shpejtë e shkrepjes së tyre (reve) sa nuk t'i merr sytë".

Gjatë përkthimit dhe hulumtimit të këtij ajeti, kam hasur vështirësi më shumë se në çdo ajet tjetër deri tani. Pas një hulumtimi bukur të gjatë, arrita ta kuptoja dhe të përmbledhja këtë, se në tefsirin e tij El-Begaviu thotë: "Allahu i Lartmadhëruar i drejton retë kah të dojë, retë shpërndahen dhe të copëtuara i bashkon një mbi një, e pas kësaj sheh se si shiu del nga mesi i tyre dhe me ato re si kodra nxjerr breshrin". Ky ishte njëri kuptim, ndërsa kuptimi tjetër thotë: "Aq breshër bie nga qielli, saqë bëhet si malet nga sasia e rënë në tokë⁹".

9 Allahu i Lartmadhëruar e di më mirë, por për këtë kam mundur ta kuptoj nga tefsiri i el-Kurtubiut, po edhe komentuesit e tjerë janë të

Për këtë Ibën Abasi, radijAllahu anhumâ , thotë: “Allahu i Lartmadhëruar ka treguar se në qiell gjenden kodra nga akulli (breshri), pra lëshon nga qielli breshër prej kodrave që e përbëjnë atë.”

Ndërsa disa dijetarë të gjuhës arabe thonë: “Allahu i Lartmadhëruar në këtë ajet ka cekur tri etapa të rënies së breshrit:

- a- fillimi i rënies së tij nga qielli,
- b- nga disa kodra, pasi nga kjo mund të konstatojmë se në qiell ka kodra të llojllojshme,
- c- lloji i lëshimit apo lënda e lëshimit është breshër e jo tjetër gjë, d.m.th. konstatojmë se gjenden edhe gjëra të tjera në qiell.

Këtë e argumentojmë edhe nga historia e njerëzimit, ku Allahu i Lartmadhëruar disa popuj të lashtë i ka dënuar me lloj-lloj dënimi.

فَكُلًّا أَخَذْنَا بِذَنبِهِ فَمِنْهُمْ مَنْ أَرْسَلْنَا عَلَيْهِ حَاصِبًا وَمِنْهُمْ مَنْ أَخَذَتْهُ
الصَّيْحَةُ وَمِنْهُمْ مَنْ خَسَفْنَا بِهِ الْأَرْضَ وَمِنْهُمْ مَنْ أَغْرَقْنَا وَمَا كَانَ اللَّهُ
لِيُظْلِمَهُمْ وَلَكِنْ كَانُوا أَنْفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ

**“Ne të gjithë i kemi dënuar për mëkatin e vet.
Ne disave u kemi dërguar furtunën dhe disa
të tjerë i ka goditur zëri i tmerrshëm, ndërsa
disa prej tyre i kemi sharruar në tokë; e disa**

afërt në këto mendime, si Esh Shevkani, Ibn Kethiri, etj..

prej tyre i kemi fundosë në ujë. E, Allahu nuk u ka bërë atyre zullum, por ata vetes i kanë bërë zullum". (Ankebut: 40)

Pra, ai dënim ka qenë prej qiellit. Edhe shkenca bash-këkohore e vërteton një gjë të tillë, se në qiej gjenden krijesa të llojllojshme. Në fund Allahu i Lartmadhëruar tregon se me atë breshër godet dhe se edhe goditja është një lloj dënimi, kështu që Allahu i Lartmadhëruar me breshër qëllon kë të dojë dhe cilën pjesë të tokës të dojë, kurse pjesa tjetër shpëton. Dhe në fund të ajetit Allahu i Lartmadhëruar përshkruan madhërinë e Vet të pakufishme:

يَكَادُ سَنًا يَرْقِيهِ يَذْهَبُ بِالْأَبْصَارِ

"...Shkëlqimi i vetëtimës së dritës së resë gati të merr sytë."

44- يُعَلِّبُ اللَّهُ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَعِبْرَةً لِّأُولِي الْأَبْصَارِ

44. "Allahu bën rrotullimin e natës e të ditës dhe në të gjitha këto ka fakte për ata që janë të pajisur me mprehtësi".

Në këtë ajet Allahu i Lartmadhëruar na e sjell edhe një argument mbi madhërinë e Tij, duke na dhënë rast që të ndalemi e të mendojmë mbi rrotullimet dhe

ndryshimet e kohëve, si nata herë zgjatet e herë shkurtohet, po ashtu edhe dita, se si ato (dita dhe nata) bëhen të ngrohta e të ftohta, të ndriçuara me diell e hënë ose të errëta etj..

Të gjitha këto na sjellin argumente mbi madhërinë e Allahut, ndërsa individit i mundësohet të bindet sa më shumë e t'i lehtësohet adhurimi. Domethënë, të gjitha këto janë argumente për ata që posedojnë mendje të mprehtë e të shëndoshë.

45- وَاللَّهُ خَلَقَ كُلَّ دَابَّةٍ مِنْ مَاءٍ فَمِنْهُمْ مَنْ يَمْشِي عَلَى بَطْنِهِ وَمِنْهُمْ مَنْ يَمْشِي عَلَى رِجْلَيْنِ وَمِنْهُمْ مَنْ يَمْشِي عَلَى أَرْبَعٍ يَخْلُقُ اللَّهُ مَا يَشَاءُ إِنَّ اللَّهَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

45. “Allahu krijoi secilën gjallesë prej uji, e prej tyre ka disa që zvarriten në barkun e tyre, ka që ecin në të dyja këmbët e edhe asosh që ecin në të katër këmbët. Allahu krijon çka të dojë, vërtet Allahu ka mundësi për çdo gjë”.

Fillimisht do të theksojmë se disa prej lexuesve të Kuranit këtë ajet e kanë lexuar: **“Allahu krijoi – وَاللَّهُ خَلَقَ”**, ndërsa një grup tjetër e ka lexuar: **“Allahu është Krijues i çdo gjëje وَاللَّهُ خَالِقٌ”**. Të dy leximet janë të vërteta, pasi është lexuar nga të dyja palët. Në këtë temë nuk e kam parë të arsyeshme të zgjerohem për leximet e Kuranit¹⁰.

10 Imam Hamza dhe imam El Kisai (dy prej 7 kurrave ose lexuesve të Kuranit) dhe imam Khalef el Bezzar (njëri prej 10 lexuesve të Kuranit) e kanë

Në këtë ajet, Allahu tregon madhërinë dhe fuqinë e Tij të plotë dhe mundësinë që Ai mundëson krijimin e krijeve në forma të ndryshme nga një origjinë, e ajo është uji, saqë disa prej tyre zvarriten, si gjarpërinjtë etj., disa ecin në dy këmbë, si njeriu dhe shpezët, e disa ecin në katër këmbë si kafshët e ndryshme.

Nuk i ka treguar ato që ecin me më shumë se katër këmbë për shkak se janë pak, ndërsa disa prej komentuesve thonë se ato që posedojnë më shumë se katër këmbë, edhe pse kanë më shumë këmbë, ato ecin me katër, por kjo nuk na pengon gjë.

Qëllimi është të medituarit rreth asaj që ka krijuar Allahu i Lartmadhëruar dhe të besohet në fuqinë dhe madhërinë e Tij të pakufishme. Nga kjo konstatojmë se Allahu i Lartmadhëruar krijon çka të dojë, në forma dhe pamje të ndryshme, pasi Ai ka mundësi.

إِنَّمَا أَمْرُهُ إِذَا أَرَادَ شَيْئًا أَنْ يَقُولَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ

“Kur Allahu dëshiron ndonjë send, urdhri i Tij është vetëm t’i thotë: “BËHU”, ai menjëherë bëhet”. (Jasin: 82)

lexuar ajetin kuranor “vallahu khaliku kul-li daabbetin ...”, ndërsa kurratë e tjerë (Nafi el Medeni, Ibnu Kethir el Meki, Ebu Amr el Basri, Ibnu Amir el Shami, Asim el Kufi, Ebu Xhafer el Medeni, Jakub el Hadremi e kanë lexuar ajetin kuranor “vallahu khaleka kul-le daabbetin”. Dallimi gjuhësor është se leximi i parë nënkupton se Allahu është Krijuesi i çdo krijese apo gjallese, ndërsa leximi i dytë nënkupton se Allahu ka krijuar çdo gjallesë apo çdo krijesë. Shih si referencë: Al budur al zahira fi el kiraat el ashr el mutevatire, fq. 224, shejh Abdulfettah el Kadij, Darul kitab el Arabi, Bejrut, Liban.

“Allahu është i gjithëfuqishëm për çdo send”. (Al Imran: 189)

وَاللَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ
وَالْحَيْلُ وَالْبِعَالُ وَالْحَمِيرُ لِيَتَرَكِبُوهَا وَزِينَهُ وَيَخْلُقُ مَا لَا تَعْلَمُونَ

“Edhe kuajt (i krijoi), edhe mushkat edhe gomarët, për t’u hipur atyre dhe si stoli, e Ai krijon (për hipje) çka ju (tash) nuk dini”. (En-Nahl: 8)

46- لَقَدْ أَنْزَلْنَا آيَاتٍ مُبَيِّنَاتٍ وَاللَّهُ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ

46. “Ne kemi shpallur argumente të qarta, e Allahu vë në rrugën e drejtë atë që do”.

Pas paraqitjes së disa argumenteve të ndryshme, qofshin ato rreth dritës ose vështirimit të hapësirës së madhe (kozmosit), Kurani kthehet në temat e veta esen- ciale, tema të cilat kanë të bëjnë me edukatën me të cilat është edukuar bashkësia islame, që të pastrohen zemrat e tyre dhe të ndriçojnë e të lidhen në dritën e Zotit në qiej e në tokë.

Në ajetet e mëparshme Kurani ka treguar për burrat të cilët tregtia nuk i pengon apo nuk i ndal nga të përmendur- rit e Allahut të Lartmadhëruar, nga falja e namazit dhe nga dhënia e zekatit. Tani vërejtëm ajete të cilat kanë të bëjnë me mohuesit e fesë së Allahut të Lartmadhëruar (qafirët),

me veprat e tyre dhe fundin e tyre, me përjetimet e tyre në errësira si në ujë.

Argumentet e Allahut të Lartmadhëruar janë të qarta. Ato paraqesin dritën e Zotit, sqarojnë burimet e udhëzimit, përcaktojnë të mirat dhe të këqijat, të këndshmet dhe të pakëndshmet, tregojnë programin e Islamit në jetën e përditshme me shumë precizitet, pa kurrfarë turbullire dhe caktojnë ligjet e Allahut të Lartmadhëruar në tokë pa kurrfarë dyshimi.

Në qoftë se njerëzit gjykohen me argumentet e Allahut të Lartmadhëruar, janë gjykuar me një shariat (dispozitë) të qartë, të drejtë e të saktë; nuk ka frikë ai që gjykohet për hakun e vet (të drejtën e vet), sepse në shariat nuk përzihen e vërteta me të pavërtetën e as hallalli me haramin.

Dëshira e Allahut është e përgjithshme, nuk mund ta kufizojë ndokush, mirëpo Allahu i Madhëruar udhëzimit ia ka treguar rrugët apo kushtet e veta. Kush e drejton veten tek udhëzimi i Allahut, ai do të gjejë aty udhëzimin e Allahut dhe dritën e Tij. Ai kapet për të dhe vazhdon në atë rrugë, derisa të arrijë te mëshira e Allahut, e kush e kundërshton dhe ia kthen shpinën rrugës së Allahut, ka humbur dritën e Udhëzuesit dhe është futur në rrugën e humbjes.

Allahu vë në rrugën e drejtë atë që do.

وَاللَّهُ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ

Në këto ajete flitet për hipokritët, të cilët përfitojnë nga argumentet e qarta të Zotit, por nuk udhëzohen – ata shfaqin në dukje Islamin, por nuk edukohen me edukatë islame, nuk janë respektues të të Dërguarit, alejhi selam, nuk e pëlqejnë gjykimin e tij e as nuk janë të kënaqur me të.

Këto ajete bëjnë krahasimin mes munafikëve dhe besimtarëve të vërtetë në imanin e tyre. Allahu i Lartmadhëruar u ka premtuar besimtarëve që do të jenë zëvendësues në tokë dhe mbajtës të fesë dhe do të vendosin siguri në vend. Allahu i Lartmadhëruar do t'i shpërblejë ata për faktin që e respektuan Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe që ishin të ndërgjegjshëm ndaj të Dërguarit Muhamed, alejhi selam.

Për atë Allahu e përshkruan shumë qartë gjendjen e tyre të vërtetë:

47 - وَيَقُولُونَ آمَنَّا بِاللَّهِ وَبِالرَّسُولِ وَأَطَعْنَا ثُمَّ يَتَوَلَّى فَرِيقٌ مِّنْهُمْ مِّنْ بَعْدِ ذَلِكَ وَمَا أُولَئِكَ بِالْمُؤْمِنِينَ

47. “Ata (hipokritët) thonë: “Ne i kemi besuar Allahut, të Dërguarit të Tij, dhe u jemi bindur. Por, pas asaj një grup prej tyre zmbarsën. Të tillët nuk janë besimtarë.”

Shembulli i tyre (në hipokrizi) është si shembulli i atij që ndez një zjarr dhe posa ndriçohet vendi përreth

tij, Allahu ua shuan dritën e tyre dhe i lë në errësira që nuk shohin.

Kjo është shprehi e munafikëve, se ata çdo herë thonë se ne besojmë në Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e thonë në prani të njerëzve, ndërsa pas shpine ata nuk janë besimtarë, nuk besojnë.

Shtrohet pyetja pse e bëjnë këtë?

Sepse ata duan t'i shfrytëzojnë situatat dhe të përfitojnë prej tyre që të mbahen nga të dyja anët, besimtarët dhe jobesimtarët.

Karakteristikë e tyre është se ata zakonisht anojnë kah ana e fortë, p.sh. në periudhën mekase apo gjatë qëndrimit të Resulullahut, alejhi selam, në Mekë, këta nuk ekzistonin sepse jobesimtarët ishin më të fortë dhe nuk kishin nevojë t'u paraqisnin muslimanëve dyfytyrësi pasi muslimanët në Mekë ishin të dobët.

Këta u paraqitën në Medinë, kur muslimanët u bënë të fortë dhe formuan shtet e këta e fshehën mosbesimin e tyre dhe u bënë kinse besimtarë, ndërsa mohimin (kufrin) e kishin në zemër, derisa Allahu ua shfaqti vërtetësinë e tyre në fillim të suret El-Bekare:

وَمِنَ النَّاسِ مَن يَقُولُ آمَنَّا بِاللَّهِ وَبِالْيَوْمِ الْآخِرِ وَمَا هُمْ بِمُؤْمِنِينَ (8)
يُخَادِعُونَ اللَّهَ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَمَا يَخْدَعُونَ إِلَّا أَنفُسَهُمْ وَمَا يَشْعُرُونَ (9)
فِي قُلُوبِهِمْ مَّرَضٌ فَزَادَهُمُ اللَّهُ مَرَضًا وَهُمْ عَذَابُ أَلِيمٍ ۖ إِنَّمَا كَانُوا يَكْذِبُونَ (10)
وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ لَا تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ قَالُوا إِنَّمَا نَحْنُ مُصْلِحُونَ (11)

أَلَا إِنَّهُمْ هُمُ الْمُفْسِدُونَ وَلَكِنْ لَا يَشْعُرُونَ (12) وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ آمِنُوا
كَمَا آمَنَ النَّاسُ قَالُوا أَنُؤْمِنُ كَمَا آمَنَ السُّفَهَاءُ أَلَا إِنَّهُمْ هُمُ السُّفَهَاءُ
وَلَكِنْ لَا يَعْلَمُونَ (13) وَإِذَا لَقُوا الَّذِينَ آمَنُوا قَالُوا آمَنَّا وَإِذَا خَلَوْا إِلَى
شَيَاطِينِهِمْ قَالُوا إِنَّا مَعَكُمْ إِنَّمَا نَحْنُ مُسْتَهْزَؤُونَ (14) اللَّهُ يَسْتَهْزِئُ بِهِمْ
وَيَمُدُّهُمْ فِي طُغْيَانِهِمْ يَعْمَهُونَ (15)

8- Ka disa njerëz që thonë: “Ne i kemi besuar Allahut dhe jetës tjetër (ahiretit), po në realitet ata nuk janë besimtarë.

9- Ata përpiqen ta mashtrojnë Allahun dhe ata që besuan, po në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër, pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë.

10- Në zemrat e tyre kanë sëmundje, e Allahu u shton sëmundje edhe më shumë, e për shkak se ata përgënjeshtruan, pësojnë dënim të dhembshëm.

11- E kur atyre u thuhet: “Mos e prishni rendin në tokë!” Ata thonë: “Ne jemi vetëm përmirësues (paqtues)!”

12- Vini re, ata në të vërtetë janë shkatërruesit, por nuk e kuptojnë.

13- Dhe kur atyre u thuhet: besoni, sikurse besuan njerëzit, ata thonë: “A të besojmë ashtu sikurse besuan mendjelehtët?” Në të vërtetë ata, dhe mu ata janë mendjelehtit, por nuk e dinë.

14- E kur i takojnë ata që besuan thonë: “Ne kemi besuar!” Por kur veçohen me djajtë (parinë) e vet

u thonë: “Ne jemi me ju, ne vetëm jemi tallur (me besimtarët)”.

15- Allahu i ndëshkon talljet e tyre, duke i lënë të bredhin edhe më shumë në mosbesimin e tyre”.

(El-Bekare 8-15)

Këta janë munafikët. Është e vërtetë se kur besimi i sinqertë rrënjohet në zemër, atëherë kemi rezultate në sjellje, sepse Islami është besim i lëvizshëm, nuk pranon ngurtësi në momentet kur paraqitet, menjëherë lëviz që të paraqesë atë që posedon në brendi dhe fillon veprën në jetën praktike.

Platforma e Islamit, e cila është e qartë në edukimin e individit, bën që individit fillimisht të përqendrohet te ndjenjat e brendshme, të cilat kanë të bëjnë me besimin, dhe paralelisht të paraqesë lëvizjet edukative në jetën e përditshme.

Besimtarët kanë për model Resulullahun, alejhi selam, i cili i vuri menjëherë shokët e vet në praktikë të Islamit, edhe pse ata në fillim nuk ishin aq dijetarë të mëdhenj, por Resulullahu, alejhi selam, i aktivizonte me atë që posedonin shokët e vet, nuk e donte Islamit pasiv.

Këtë na e argumenton ngjarja me Muadhin, të birin e Xhebelit, kur e dërgoi për në Jemen që të ftonte në Islam, edhe pse kjo ishte në fillim. Rasti tjetër na tregon se shokët e Muhamedit, alejhi selam, kur mësonin

Kuran, mësonin nga pak, por atë që mësonin, e vepronin menjëherë. Neve na duhet një Islam praktik në tokë (jetën e përditshme), jo një Islam pasiv, vetëm në xhami dhe kaq. Islami është jetë.

Islami ka platformën e vet të veprimit për shoqërinë në gjitha fushat e jetës, qoftë në adhurim, në politikë, në tregti (ekonomi), mbrojtje (ushtri), pra në çdo aspekt.

Ndërsa këta thoshin: وَيَعْمَلُونَ أَمَنًا بِاللَّهِ وَبِالرَّسُولِ وَأَطَعْنَا

“Ne i kemi besuar Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe e kemi respektuar...”, por këtë fjalë e thanë vetëm me gojë, mirëpo kjo nuk u vërtetua në jetën e përditshme, sepse me veprat dhe sjelljet e tyre ata përgënjeshtroan atë që deklaruan me gojë.

Allahu i Lartmadhëruar ua hodhi poshtë këtë duke u thënë:

“Të tillët nuk janë besimtarë” وَمَا أُولَئِكَ بِالْمُؤْمِنِينَ

Sepse besimtari nuk bie ndesh me atë që thotë, fjala me veprën e tij nuk kundërshtohen.

Besimi nuk është një lojë me të cilën njeriu tallet, pastaj e lë dhe shkon, mirëpo ai është një bindje e individit, rrënjosje në zemër dhe vepër në praktikë,

48- وَإِذَا دُعُوا إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ لِيَحْكُمَ بَيْنَهُمْ إِذَا فَرِيقٌ مِنْهُمْ مُعْرِضُونَ

48. “Kur ata (hipokritët) thirren që të gjykohen tek Allahu dhe tek i Dërguari i Tij, do të hasësh se një grup prej tyre mohojnë”.

Këta ishin ata që shfaqnin besimin, mirëpo kur u ndodhte të gjykoheshin tek Allahu i Lartmadhëruar dhe tek i Dërguari i Tij, ata e mohonin një gjë të tillë sepse nuk ishin të sinqertë në deklarimin se ishin besimtarë.

49 - وَإِنْ يَكُنْ لَهُمُ الْحَقُّ يَأْتُوا إِلَيْهِ مُذْعِنِينَ

49. “Vetëm nëse dinë se drejtësia është në anën e tyre, ata vijnë të përlur (me shpejtim)”.

Allahu i Lartmadhëruar u shpalos një ves ose sjellje hipokritëve, të cilën ata urrejnë që t’u dalë në shesh, mirëpo Allahu i Lartmadhëruar ua di qëllimet më mirë se ata vetvetes. Ata e dinin se ligji i Allahut të Lartmadhëruar nuk shmanget nga e vërteta, nuk anon kah e pavërteta, nuk ndryshon as kur gjykohet për ndonjë të afërm as për ndonjë të largët.

Ky grup njerëzish nuk e do të vërtetën dhe s’mund ta durojë drejtësinë. Pas kësaj, ata refuzonin që të gjykoheshin para Pejgamberit, madje urrenin që të shkonin tek ai. Mirëpo, kur ishin në të drejtë për ndonjë çështje, ata shpejtonin që të gjykoheshin te Pejgamberi, alejhi selam, të kënaqur dhe të nënshtruar sepse ishin të bindur se do të gjykoheshin drejt – në bazë të dispozitave të sheriatit, i cili nuk bën padrejtësi.

Ky ishte grupi i atyre që shfaqnin besimin, por pas kësaj ndiqnin rrugë të njëanshme. Pra, kjo është

një metodë hipokrite për çdo kohë dhe vend. Muna-fikët, të cilët nuk guxonin ta thoshin fjalën mohuese (kufrin), deklaroheshin muslimanë, por nuk u pëlqente që të gjykoreshin me dispozitat e sheriatit islam kur thirreshin që të gjykoreshin me ligjet e Allahut të Lartmadhëruar dhe të Dërguarit të Tij, por refuzonin dhe gjenin arsye time. Pra, të tillët:

“Nuk janë nga besimtarët”. وَمَا أَوْلَيْكَ بِالْمُؤْمِنِينَ

Ligjet e Allahut të Lartmadhëruar dhe të të Dërguarit të Tij, alejhi selam, i refuzon vetëm ai që është i pamoralshëm, që nuk është edukuar me edukatë islame dhe nuk i ndriçon zemra nga drita e besimit. Nga kjo konstatojmë se është e domosdoshme t’i përgjigjemi gjykatësit në rastet kur thirremi për gjykim sepse Allahu i Lartmadhëruar i ka nënçmuar me nënçmimet më të këqija ata që thirren për t’u gjykuar dhe nuk i përgjigjen thirrjes duke i pyetur: **“A mos i kanë zemrat e sëmura...”**

50- أَيْنِ قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ أَمْ ارْتَابُوا أَمْ يَخَافُونَ أَنْ يَحِيفَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ وَرَسُولُهُ
بَلْ أَوْلَيْكَ هُمُ الظَّالِمُونَ

50. “A thua janë të sëmurë në zemrat e tyre apo mos dyshojnë a frikësohen se Allahu dhe i Dërguari i Tij mund t’u bëjnë atyre padrejtësi në gjykim? Por jo, ata vetë janë zullumqarë”.

Nëse i referohemi gjykimit, shtrohet pyetja: A vlen kjo vetëm për munafikët apo vlen për këdo që i thotë vetes besimtar? A duhet të gjykohemi edhe ne me këto ligje përderisa janë ligjet e Allahut dhe të Dërguarit të Tij? Kuptohet që ekzekutimet e ligjeve bëhen përmes institucioneve në mënyrë zyrtare. Përderisa bashkësitë islame janë legjitime në gjitha trojet e Ballkanit, pse nuk e ngritën zërin të paktën njëherë për disa ligje apo dispozita, si për shembull trashëgimia e femrës, që është harruar nga institucionet apo edhe për disa rregulla bankare, të cilat e kanë ngulfatur popullin me kamata të llojllojshme edhe askush nuk e ngre zërin. Të paktën njeriu që i dëshiron ligjet e sheritativit, të ketë zgjedhje në gjykatë në raste divorci apo trashëgimie ose të ketë zgjedhje në bankë, duke mos qenë i robëruar apo i imponuar. Këto nuk janë kërkesa absurde përderisa në bankat e Perëndimit njerëzit kanë zgjedhje. Këtë gjë mund ta zgjidhin bashkësitë fetare përderisa janë legjitime.

Është interesante se në këtë ajet Allahu i Lartmadhëruar parashton tri pyetje për hipokritët.

Pyetja e parë është për zemrat e tyre, se mos janë të sëmura:

A thua janë të sëmure në zemra أَفِي قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ

Pyetja e dytë shfaq habi:

– **apo mos dyshojnë** أَمْ اِذْتَابُوا

Pyetja e tretë shfaq dyshimin e tyre në Allahun dhe të Dërguarin e Tij:

أَمْ يَخَافُونَ أَنْ يَخِيفَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ وَرَسُولُهُ

a frikësohen se Allahu dhe i Dërguari i Tij mund t'u bëjnë atyre padrejtësi në gjykim?

Nga këto pyetje duhet të marrin mësim të gjithë ata predikues të kësaj feje, të cilët janë të përkushtuar ndaj Kuranit dhe Sunetit, pa dallim pozite. Çdokush duhet ta marrë për vete këtë ajet, se Allahu u drejtohet të gjithëve. Nuk duhet pasur frikë nga askush sepse dispozitat e Allahut janë të ardhura për të mirën e njerëzimit dhe zhvillimin e shoqërisë.

Vallë kanë frikë se Allahu i Lartmadhëruar dhe i Dërguari i Tij, alejhi selam, u bëjnë padrejtësi në gjykim...?!

Me të vërtetë është për t'u habitur si mund të ndodhë një gjë e tillë te njeriu. Allahu i Madhëruar është Krijuesi i gjithësisë, si mund të bëjë Ai padrejtësi në ligjet e Veta ndaj njerëzve, kur Ai është Zot i të gjithëve?!

Është e vërtetë se ligjet e Allahut të Lartmadhëruar janë ligjet e vetme që largojnë çdo padrejtësi sepse Allahu i Lartmadhëruar është më i drejti, që nuk i bën askujt padrejtësi dhe të gjitha krijesat e Veta para Tij janë të njëjta. Ai nuk i bën askujt padrejtësi në interes

të dikujt tjetër. Çdo ligj jashtë ligjit të Tij mund të ketë padrejtësi, sepse njerëzit nuk mund ta përmbajnë veten kur vendosin rregulla apo dispozita.

Ata, kur gjykojnë, anojnë kah interesat e tyre, qofshin ata njerëz, shtresa njerëzish apo shtete.

Kur rregullat apo dispozitat burojnë apo gjykohen nga njeriu, patjetër do të hasim se ai i ka përgatitur ato dispozita apo ligje për interesat e veta ose për mbrojtjen e vetvetes, ndërsa kur gjykon Allahu i Lartmadhëruar, nuk ka mbrojtje e as interes sepse është gjykim i drejtë e i përgjithshëm, në të cilin nuk ka anshmëri.

Ata që nuk pajtohen me ligjet e Zotit dhe të Resullullahut, alejhi selam, janë zullumqarë (të padrejtë), të cilët nuk duan që të vendoset drejtësia dhe nuk dëshirojnë të dalë e vërteta në shesh sepse ata e dinë mirë që në Ligjet e Allahut të Madhërishëm nuk ka mashtrime dhe dyshime.

Besimtarët e vërtetë kanë tjetër edukatë me Allahun e Lartmadhëruar dhe me të Dërguarin e Tij, alejhi selam. Ata kanë edukatë tjetër kur thirren për gjykim para Allahut të Madhëruar dhe të Dërguarit të Tij, alejhi selam.

Kjo është fjala që i takon besimtarit dhe kjo fjalë buron nga zemra e përfshirë nga drita e Allahut, e cila reflekton në vepër. Ajo është:

51 - إِنَّمَا كَانَ قَوْلَ الْمُؤْمِنِينَ إِذَا دُعُوا إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ لِيَحْكُمَ بَيْنَهُمْ أَنْ يَقُولُوا سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

51. “Fjalë e vetmja e besimtarëve të sinqertë kur ata thirren tek Allahu dhe tek i Dërguari i Tij për gjykim është: “Dëgjuam dhe respektoam!” Të tillët janë ata të shpëtuarit.”

Kështu është dëgjimi dhe respektimi i vërtetë, i padyshimtë, pa polemika e mënjanim: dëgjim dhe respektim i bazuar nga vetëbesimi se ligji i Allahut të Lartmadhëruar dhe i të Dërguarit të Tij, alejhi selam, është i vetmi gjykim i drejtë, të gjitha gjykimet e tjera jashtë këtij janë gjykime të pasuara me epshe. Ky është dorëzimi dhe nënshtrimi i plotë ndaj Allahut të Lartmadhëruar, flijimi i jetës për Allahun e Lartmadhëruar dhe bindjet se ajo që ka zgjedhur Allahu i Lartmadhëruar për njerëzimin, është më i mirë sesa ajo që njerëzit ia zgjedhin vetes sepse Allahu i Lartmadhëruar është më i ditur sesa krijesat.

“Të tillët janë të shpëtuarit”. وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

Të shpëtuar sepse Allahu i Lartmadhëruar ua ka rregulluar programin e jetës dhe lidhjet jetësore dhe gjykon mes tyre me dituri dhe drejtësi. Patjetër që do të jetë më e mirë për ta sepse Ai ua ka programuar

këtë program. Do të jenë të shpëtuar sepse ndjekin një program në të cilin nuk ka mangësi e as padrejtësi. Të bindur dhe të pushuar shpirtërisht ata ecin, vazhdojnë nëpër të, nuk bëjnë përzierje e as përçarje dhe nuk shkojnë pas epsheve të tyre, ky është programi i Allahut të Madhëruar para tyre, i cili është i qartë dhe i drejtë.

52- وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَخْشَ اللَّهَ وَيَتَّقْهُ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفَائِزُونَ

52. “Kush respekton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ia ka frikën Allahut dhe i përmbahet udhëzimit të Tij, të tillët janë ata të lumturit (të shpëtuarit)”.

Deri më tani ajetet kishin të bënin me respektimin dhe dorëzimin ndaj ligjeve të Zotit, kurse tani ajetet flasin për respektin e përgjithshëm në çdo urdhër dhe ndalesë, duke tërhequr me vete frikën dhe përmbajtjen. Pra, këta janë shpëtimtarët në këtë botë dhe në botën tjetër. Allahu i Madhëruar na ka premtuar, ndërsa Ai nuk e thyen premtimin e dhënë.

Edukata e respektimit të Allahut të Madhëruar dhe të Dërguarit të Tij duke pasur frikë dhe përmbajtje është një edukatë shumë e lartë sepse buron nga brendia e zemrës së shkëlqyer nën dritën e Zotit, pasi ajo është fort e lidhur me Të dhe e ndien madhërinë e Tij.

Besimtari i vërtetë nuk e ul kokën, përpos para Allahut të Madhëruar (ligjeve të Tij), që është një, i vetmi, i papërballueshmi, më i larti. Besimtari dëshiron të jetë nga ata të cilët Allahu i ka përshkruar në këtë ajet:

“ata janë të lumturit”. فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفَائِزُونَ.

Është transmetuar se Omeri, radijAllahu anhu, ishte brenda xhamisë së Pejgamberit, alejhi selam, kur pa një njeri prej romakëve, i cili ishte në xhami dhe shqiptonte shehadetin duke thënë:

“Ena eshhedu en La ilahe ila llahu ve eshhedu ene Muhameden Resulullah”, d.m.th. “Unë dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij”.

Pasi e dëgjoi, iu drejtua dhe e pyeti: “Si është puna jote?”

Ai tha: “Besova në Zot”. Omeri, radijAllahu anhu, i tha: “A ke ndonjë shkak (që po beson)?” Ai tha: “Po, unë kam lexuar Teveratin, Zeburin, Ungjillin dhe shumë libra pejgamberikë dhe dëgjova një person i cili lexonte një ajet kuranor, i cili përmbledhte gjithçka që ishte në librat e mëparshëm. Aty u binda se është prej Allahut të Lartmadhëruar dhe besova”. Omeri, radijAllahu anhu, iu drejtua:

“Po cili është ai ajet?” Ai tha: “Fjala e Allahut: “Kush respekton Allahun (وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ) në gjërat obligative, farzet, dhe të Dërguarin e Tij (وَرَسُولَهُ) në Sunetet e Pejgamberit, alejhi salam, dhe ka frikë nga Allahu (وَيُحْشِ اللَّهَ) në atë që ka kaluar nga jeta e vet dhe i përmbahet (وَيَتَّقِهِ) nga ajo që i ka ngelur nga jeta, të tillët janë fitues, shpëtimtarë (فَأُولَئِكَ هُمُ الْفَائِزُونَ). Fitues është ai i cili shpëton nga zjarri dhe ka hyrë në xhenet”.

Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, iu drejtua atij që besoi duke i thënë: “Pejgamberi, alejhi salam, ka thënë: *“Më është dhënë fjala përmbledhëse”. Tefsir El-Kurtubi.*

53 - وَأَقْسَمُوا بِاللَّهِ جَهْدَ أَيْمَانِهِمْ لَئِنْ أَمَرْتَهُمْ لَيَخْرُجُنَّ قُلْ لَا تُقْسِمُوا طَاعَةً مَعْرُوفَةً إِنَّ اللَّهَ يَخْبِرُ بِمَا تَعْمَلُونَ

53. “Ata (hipokritët) betohen me një betim të fortë në Allahun, se sikur t’i urdhëroje ti, ata gjithsesi do të dilnin (për në luftë).

Thuaju: “Mos u betoni”. Bindja është ditur, (ju vetëm me gojë thoni e jo me zemër). S’ka dyshim, Allahu hollësisht di çka veproni”.

Ky ajet na tregon të vërtetën e munafikëve dhe sjelljet e tyre, se ata për çdo vepër premtojnë dhe betohen me betime më të forta, por kur vjen koha e realizimit, ata zhduken. Ndërsa Allahu i Lartmadhëruar ua di qëlli-

met dhe brenditë e tyre dhe na tregon në Kuran se si mendojnë ata dhe sa janë realizues të premtimeve.

Ata i thoshin Muhamedit, alejhi selam: “Po qe se del ti, o Muhamed, në xhihad, ne do të dalim me siguri dhe kudo që të shkosh, ne do të të shoqërojmë”. Ndërsa Allahu i Lartmadhëruar i tha Muhamedit, alejhi selam:

“Thuaji ti (O Muhamed) atyre mos u përbetoni. Ne e dimë se sa jeni të sinqertë. Se ju çdo vepër e keni vetëm me fjalë e asgjë nuk e realizoni.”

Allahu i Lartmadhëruar ka cekur edhe disa raste të tjera të tyre, si për shembull në suren Et Teube, ajeti 96:

يَخْلِفُونَ لَكُمْ لِتَرْضَوْا عَنْهُمْ فَإِنْ تَرْضَوْا عَنْهُمْ فَإِنَّ اللَّهَ لَا يَرْضَىٰ عَنِ الْقَوْمِ الْفَاسِقِينَ

“Ata (hipokritët) ju betohen juve (muslimanëve) që të jeni të kënaqur ndaj tyre, e nëse ju shprehni kënaqësi, Allahu nuk është i kënaqur me popullin e paturpshëm”.

Në një ajet tjetër në suren Muxhadele, 16,

Allahu i Madhëruar thotë:

اتَّخِذُوا أَيْمَانَهُمْ جُنَّةً فَصَدُّوا عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ فَلَهُمْ عَذَابٌ مُّهِينٌ

“Ata betimin e tyre e kanë marrë si mbrojtje dhe kanë penguar prej rrugës së Allahut, andaj ata i pret një dënim poshtërues”.

Këto janë sjelljet e tyre të hershme, të tashme dhe të ardhshme, por s’ka dyshim se Allahu i Lartmadhëruar di hollësisht se çka veprojnë ata.

54 - قُلْ أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ فَإِنْ تَوَلَّوْا فَإِنَّمَا عَلَيْهِ مَا حُمِّلَ وَعَلَيْكُمْ مَا حُمِّلْتُمْ وَإِنْ تُطِيعُوهُ تَهْتَدُوا وَمَا عَلَى الرَّسُولِ إِلَّا الْبَلَاغُ الْمُبِينُ

54. “Thuaj: “Respektojeni Allahun, respektojeni të Dërguarin!” por nëse ju shmangeni ai (Muhamedi) atij i takon përgjegjësia vetëm për atë që është i ngarkuar, ndërsa juve përgjegjësia me çka jeni ngarkuar, nëse i bindeni atij, atëherë keni gjetur të vërtetën. Detyra e të Dërguarit është vetëm të shpallë në mënyrë të qartë”.

Allahu i Lartmadhëruar u drejtohet të gjithë njerëzve që t'i përmbahen Librit të Tij, Kuranit, dhe ligjeve të Muhamedit, alejhi selam, Sunetit, d.m.th. një urdhër paralel: **“Respektojeni Allahun, respektojeni të Dërguarin!”**

Ka disa ajete të tilla të ngjashme në Kuran, ku Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Kush e respekton Allahun dhe të Dërguarin e Tij”. (En-Nisaë: 69)

وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَالرَّسُولَ

Në një ajet tjetër, En-Nisaë, 80, thotë:

مَنْ يُطِيعِ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ

“Kush respekton të Dërguarin, ai ka respektuar Allahun”.

Nga kjo konstatojmë se respektimi i të Dërguarit, alejhi selam, është gjë e domosdoshme sepse ajo që ka sjellë Muhamedi, alejhi selam, nuk është prej tij, individualisht, por ato janë urdhëresa apo rregulla të fesë, të cilat burojnë vetëm nga Allahu i Lartmadhëruar.

Pra, nuk kemi guximin të bëjmë tolerime qëllimisht në Sunetin e Pejgamberit, alejhi selam, sepse ai duhet të respektohet pasi është urdhër paralel. Kush dëshiron ta respektojë Allahun e Lartmadhëruar, le ta respektojë të Dërguarin e Tij, sepse të respektuarit e të Dërguarit është shenjë e të respektuarit të Allahut të Madhërishëm.

Në qoftë se njerëzit nuk e respektojnë Pejgamberin, alejhi selam, kjo nuk do të thotë se ai (Pejgamberi) nuk ka dhënë kontributin e duhur, por ai e ka kryer misionin dhe përgjegjësinë e vet, tani u ngelet njerëzve përgjegjësia se sa i përgjigjen asaj thirrjeje, që nesër para Allahut të mos kemi asnjë arsyetim.

Në qoftë se i përgjigjesh asaj thirrjeje, je i shkarkuar nga kjo ngarkesë.

وَمَا عَلَى الرَّسُولِ إِلَّا الْبَلَاغُ الْمُبِينُ

“...detyra e të Dërguarit është vetëm të shpallë në mënyrë të qartë”. (En-Nur 54)

D.m.th. ai nuk është përgjegjës për faktin që ju nuk po i përgjigjeni, e as për besimin tuaj.

Ndërsa për udhëzimin të cilit ia kthejnë shpinën, çdokush do të llogaritet para Allahut të Lartmadhëruar aq sa ka vepruar. Për misionin e Pejgamberit alejhi salam, Allahu i Madhëruar thotë:

مَا عَلَى الرَّسُولِ إِلَّا الْبَلَاغُ وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا تُبْدُونَ وَمَا تَكْتُمُونَ

“I Dërguari nuk ka tjetër obligim vetëm të kumtojë (shpalljen); Allahu di ç’publikoni dhe ç’mbani fshehtë”. (El Maide, 99)

وَإِنْ مَا نُبِّئَكَ بَعْضَ الَّذِي نَعِدُهُمْ أَوْ تُتَوَقَّعُ فَإِنَّمَا عَلَيْكَ الْبَلَاغُ وَعَلَيْنَا الْحِسَابُ

“Ne mund të mundësojmë ty ta shohësh atë (dënimin) që u premtojmë atyre, ose ta marrin (shpirtin) ty. Obligim i yti është vetëm kumtimi, kurse e Jona është llogaria”. (Er Rrad, 40)

Pasi u paraqit e vërteta e tyre (munafikëve), që të mos bien nën ndikimin e tyre dhe të mos u kushtojnë shumë rëndësi atyre, Allahu i Lartmadhëruar u drejtohet besimtarëve të respektueshëm dhe u tregon për shpërblimin e sinqertë dhe besimin (në vepër) në këtë botë para se t’u vijë llogaria e fundit.

Allahu i Madhëruar thotë:

55- وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا مِنْكُمْ وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ كَمَا اسْتَخْلَفَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ وَلَيُمَكِّنَنَّ لَهُمْ دِينَهُمُ الَّذِي

ارْتَضَىٰ لَهُمْ وَلَيُبَدِّلَنَّهُمْ مِنْ بَعْدِ خَوْفِهِمْ أَمْنًا يَعْبُدُونَنِي لَا يُشْرِكُونَ بِي شَيْئًا وَمَنْ كَفَرَ بَعْدَ ذَلِكَ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ

55. “Allahu u ka premtuar disa prej jush që kanë besuar dhe që punojnë vepra të mira se do t’i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si i pati bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe se Ai do t’u sigurojë fuqinë për të zbatuar e përmbushur fenë e tyre. Atë të cilën Ai e ka zgjedhur për ta (islamin) do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t’ju dhuroj siguri (e këtë siguri do ta kenë) pasi që ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë Fasikunë (kryeneç, të pabindur ndaj Allahut dhe më të prishurit)”.

Para se të fillojmë të komentojmë këtë ajet, vlen të cekim shkakun e zbritjes së tij dhe pas shkakut sqarohet kuptimi i plotë.

Ky ajet zbriti pasi disa shokë të Muhamedit, alejhi selam, iu ankuan atij për pasigurinë që kishin, pasi tërë kohën rrinin të armatosur, madje edhe kur flinin armët i linin pranë vetes nga frika se mos sulmoheshin nga armiqtë, derisa disa prej tyre i thanë Pejgamberit, alejhi selam:

“Deri kur kështu do të jetojmë (me frikë), a nuk do të vijë një ditë që ne t’i hedhim armët nga dora e të jetojmë të lirë?”

Pejgamberi, alejhi selam, iu përgjigj: *“Nuk do të zgjasë një kohë e shkurtër derisa njeriu (besimtari) do të rrijë në një hapësirë të madhe i çarmatosur”,* e pastaj u shpall ky ajet.

Kështu ndodhi, pasi brenda një kohe të shkurtër Allahu i Madhëruar ia mundësoi Pejgamberit, alejhi selam, çlirimin e Gadishullit Arabik, duke u liruar dhe siguruar njerëzit.

Disa dijetarë për këtë ajet thonë: “Nga kjo vërtetohet vërtetësia e Pejgamberit, alejhi selam, apo e pejgamberllëkut të tij, sepse ajeti u shpall para se të ndodhte kjo dhe Allahu i Lartmadhëruar e realizoi premtimin”.

Premtim i Allahut të *Lartmadhëruar* - وَعَدَ اللَّهُ

*** Allahu nuk e thyen premtimin** (Ez-Zumer: 20) – لَا يُخْلِفُ اللَّهُ الْمِيعَادَ

Allahu i Lartmadhëruar nuk mundësoi vetëm çlirimin e Gadishullit Arabik, në të cilin përfshihen Meka, Hajberi, Bahrejni etj., por edhe vende të tjera.

U çlirua toka e Jemenit në tërësi, disa pjesë të Shamit, por edhe vende të tjera, si territoret e mbretit romak Herakliut, prijësit të Egjiptit – el-Makuklis (Makaukisi), mbretërve të Omanit, Afrika Veriore, Etiopia, e të tjera.

Këto çlirime ndodhën gjatë jetës së Pejgamberit, alejhi selam.

Pas vdekjes së tij misioni i Allahut të Lartmadhëruar vazhdoi me burra të cilët i përgatiti Muhamedi, alejhi selam, kur udhëheqjen e mori Ebu Bekri, radijAllahu anhu, i cili mori Gadishullin Arabik në tërësi, dërgoi ushtri islame në shtetet persiane (Irani i sotëm) me në krye komandantin Halid ibën Velidin, radijAllahu anhu, dhe e çliruan një pjesë të saj.

Nga ana tjetër, ushtria e Ebu Ubejdes, radijAllahu anhu, dhe e disa komandantëve të tjerë morën tokat e Shamit. Ushtria e tretë, me në krye Amër ibën el Asin, radijAllahu anhu, depërtoi në Egjipt (Afrikën Veriore).

Pas kësaj, Allahu i Lartmadhëruar ua mundësoi muslimanëve që për udhëheqës (kalif) të kishin Omerin, radijAllahu anhu, pas vdekjes së Ebu Bekrit, radijAllahu anhu.

Edhe Omeri, radijAllahu anhu, vazhdoi të njëjtin mision, burrë për të cilin ky planet nuk njeh tjetër njeri pas Pejgamberëve që t'i ketë shërbyer kësaj feje më shumë.

Nën udhëheqjen e tij u çliruan zonat e Shamit tërësisht, edhe tokat e Egjiptit dhe shumica e tokave të Persisë. Ai e theu Perandorinë Bizantine, po ashtu edhe atë romake, kështu që iu afrua edhe Kostandinopojës (Stambollit të sotëm) dhe pasurinë e tyre e shpenzoi për hir të Allahut të Lartmadhëruar.

Pas tij erdhi Othmani, radijAllahu anhu, i cili vazhdoi misionin e të parëve, kështu që ushtritë e muslimanëve mbërritën në tokat e Kaukazit dhe në një pjesë të Kinës në lindje.

Ushtria e Uthmanit, radijAllahu anhu, mbërriti edhe në perëndim në shtetet e Andaluzisë (Spanjë e Portugali si dhe një pjesë e Francës), kurse nga ana e Stambollit deri në vendet ballkanike.

E gjithë kjo ishte nga mirësia e Kuranit, të cilit ai i kushtoi rëndësi shumë të madhe në lexim, mësim dhe tubim. Për këtë ka garantuar Pejgamberi, alejhi selam, ku Theubani thotë se Resulullahu, alejhi selam, ka thënë;

“Allahu ma ka shtrirë tokën, kështu që pashë lindjen dhe perëndimin e saj. Do të arrijë umeti im aq sa më është shtrirë mua”. (E transmeton Imam Muslimi në sahihun e tij me nr. 2889).

Imam Ahmedi transmeton në sahihun e tij me nr. 5/220/ 21969, nga Said ibën Xhemhan, se Pejgamberi, alejhi selam, ka thënë: *“Hilafeti pas meje do të zgjasë 30 vjet, pas kësaj do të jetë një mbretëri.”* (Këtë e ka vërtetuar edhe Shuajb El-Arnauti).

Kur i llogarisim këto vite, na dalin saktë: kalifati i Ebu Bekrit zgjati 2 (dy vite), kalifati i Omerit zgjati 10 (dhjetë) vite, kalifati i Othmanit zgjati 12 (dymbëdhjetë) vite dhe i Aliut 6 (gjashtë) vite, që në total bëjnë 30 (tridhjetë) vite.

Por, kjo nuk do të thotë se me mbarimin e kalifatit do të mbarojë Islami, përkundrazi, Islami ka vazhduar dhe do të vazhdojë deri në fund të kësaj bote dhe do të depërtojë në çdo vend e shtëpi, ashtu siç është cekur në hadithin e Pejgamberit, alejhi selam:

“Allahu ma ka shtrirë tokën, kështu që pashë lindjen dhe perëndimin e saj. Do të arrijë umeti im aq sa më është shtrirë mua”. (E transmeton Imam Muslimi në sahihun e tij me nr. 2889).

Nga Rebij ibën Enesi transmetohet se Ebi el Alije për këtë ajet ka thënë: “Pejgamberi, alejhi selam, me shokët e vet në Mekë për mbi 10 vite thirrën për të besuar Allahun një dhe për ta adhuruar të vetmin, pa shok, mirëpo ata ishin në numër të vogël dhe nuk ishin të urdhëruar që të bënin luftë, derisa u urdhëruan për të bërë emigrimin (hixhretin) në Medinë.

Pasi u përqendruan aty dhe vendosën pushtetin, Allahu i Lartmadhëruar i urdhëroi për luftë.

Ata prapë filluan të frikësoheshin sepse me armë zgjoheshin e me to e bënin gjumin. Ata duruan në këtë pozitë derisa deshi Allahu i Madhëruar.

Pas kësaj njëri prej shokëve të Muhamedit, alejhi selam, i tha:

“O i Dërguari i Allahut, çdo herë ne do të jemi në frikë? A do na vijë një ditë që të jemi të sigurt dhe t'i lëmë armët anësh?”

Pejgamberi, alejhi selam, iu përgjigj:

“Nuk do të duroi vetëm se edhe pak, derisa të ulet njëri prej jush në një hapësirë të madhe e i shtrirë e nuk do të ketë me vete kurrfarë arme”.

Allahu i Madhëruar e shpalli këtë ajet dhe ia shfaqti Gadishullin Arabik të Dërguarit të Vet. Ata u siguruan dhe i lanë armët, siguri e cila vazhdoi sa ishte Pejgamberi, alejhi selam, gjallë, pastaj erdhën Ebu Bekri, Omeri, Othmani dhe Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me ta.

Imam Ahmedi, Hakimi dhe Bejhakiu transmetojnë nga Ubej ibën Kabi, radijAllahu anhu, i cili ka thënë: “I Dërguari i Allahut, alejhi selam, ka thënë: *“Përgëzoje këtë umet (popullin islam) me dominim, ngritje, fe, ndihmë, përparësi në tokë. Kush punon prej tyre me vepra të ahiretit (të asaj bote) për këtë botë, ai nuk do të ketë kurrfarë hise në atë botë”.* “Sahih et Tergib”, shejh Albani me nr. 1332.

يَعْبُدُونِي لَا يُشْرِكُونَ بِي شَيْئًا

“...Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë me asgjë...”

1. Në këtë pjesë të ajetit, dijetarët apo komentuesit e Kuranit kanë dhënë katër mendime:
2. Nuk adhurojnë zot tjetër përveç Allahut – këtë mendim e ka dhënë En Nekashi.
3. Nuk mund të paramendojnë ndonjë të adhuruar përveç Allahut.

4. Nuk i frikësohen askujt përveç Allahut – këtë mendim e ka dhënë Ibën Abasi.
5. Nuk duan askënd përveç Allahut – këtë ka thënë Muxhahidi.

(Tefsir El- Kurtubi (Darul Hadith), vëllimi 12, fq. 299. Ndërsa Kurtubiu e ka transmetuar nga El-Maverdij, 3/139.)

Imam Ahmedi transmeton nga Muadh ibën Xhebeli, radijAllahu anhu, të ketë thënë:

Isha njëherë pas Pejgamberit, alejhi selam, hipur në një gomar e më tha: “O Muadh!” I thashë: “Të përgjigjem!” Pas pak çastesh prapë më tha: “O Muadh!” Unë i thashë: “Të përgjigjem!” Po ashtu vazhduan disa çaste dhe prapë m’u drejtua duke më thënë:

“O Muadh!” Unë prapë ia ktheva të njëjtën: “Të përgjigjem, o i Dërguari i Allahut. E më tha: “A e di se çka është borxhi i robërve ndaj Allahut?” I thashë: “Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë”. Më tha: “Borxhi (haku) i robërve ndaj Allahut është që ta adhurojnë Atë dhe të mos i bëjnë shok me diçka tjetër”. (Muadhi tha) “Kaluan disa çaste e prapë më tha: “O Muadh ibën Xhebel!” I thashë: “Urdhëro, o i Dërguari i Allahut, të përgjigjem!” Më tha: “Po, a e di çka është haku (borxhi) i Allahut, në qoftë se ata (robërit) e kryejnë një gjë të tillë?” (Tha Muadhi) I thashë: “Allahu dhe Dërguari i Tij e dinë.” Tha (Pejgamberi, alejhi selam): “Është e vërtetë se haku i

robërve ndaj Allahut është të mos i dënojë.” (Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Katadeja).

وَمَنْ كَفَرَ بَعْدَ ذَلِكَ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفَٰسِقُونَ

“... E kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë fasikunë (kryeneç, të pabindur ndaj Allahut dhe më të prishurit)”.

Domethënë, kush del nga respekti pas kësaj të mire që u dha prej Allahut, ka dalë nga rruga e Zotit të vet. Mjafton me këtë të ketë bërë një mëkat të madh.

Sahabët (shokët e Pejgamberit, alejhi selam), Allahu qoftë i kënaqur me ta, ishin njerëzit në rrugë më të drejtë pas Pejgamberit, alejhi selam, duke i zbatuar ligjet e Allahut të Lartmadhëruar dhe më të respektueshmit ndaj Allahut të Lartmadhëruar.

Ndihmën ata e meritonin sipas veprave që bënë, prandaj Allahu i Lartmadhëruar ua mundësoi që të shpërndahet feja e Tij në lindje e perëndim dhe i forcoi me një forcë shumë të madhe, duke sunduar në të gjitha trojet dhe njerëzit. Kur pas tyre njerëzit filluan ta linin pas dore një gjë të tillë, ndihma filloi t’u pakësohet (sipas veprave) dhe kështu është gjendja e besimtarëve gjatë historisë së tyre. Ky është ligji i Allahut në këtë tokë. Allahu ka bërë që nëse njerëzit i përkushtohen fesë së Allahut, Ai e zbret ndihmën e Tij. Allahu në një ajet kuranor thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِن تَنْصُرُوا اللَّهَ يَنْصُرْكُمْ وَيُثَبِّتْ أَقْدَامَكُمْ

**“O besimtarë, nëse ju ndihmoni (fenë) Allahun,
Ai ju ndihmon juve dhe u forcon këmbët tuaja”.**

(Muhamed: 7)

Pra, ky është kushti i Allahut. Shtrohet pyetja pse Allahu nuk i ndihmon muslimanët? Përgjigjja është e qartë: Sa po e ndihmojmë ne fenë e Allahut? Shtëpitë e besimtarëve janë mbushur me harame, në ushqim, veshmbathje, lakuriqësi, kamatë, muzikë, mosfalje e namazit e të tjera. Si po e presim ndihmën e Allahut kur Allahu ka kushtëzuar që nuk e ndryshon gjendjen e një populli përderisa populli ta ndryshojë veten? Allahu i Madhëruar thotë:

إِنَّ اللَّهَ لَا يَغَيِّرُ مَا بَقِيَمْ حَتَّى يَغْيُرُوا مَا بِأَنْفُسِهِمْ

“Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre”.

(Er-Rad: 11)

56- وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ

56. “Falen i namazin, jepen i zekatin dhe respektojeni të Dërguarin në mënyrë që të mëshiroheni”.

Në këtë ajet hasim një lidhje shumë të fortë për jetën e njeriut. Pikësëpari, Allahu i Lartmadhëruar kërkon

faljen e namazit, lidhjen direkte me Allahun e Lartmadhëruar, d.m.th. namazi të falet me të gjitha kushtet e veta (farzet, vaxhibet, sunetet etj.) në mënyrë që lidhja të jetë direkte me Allahun e Lartmadhëruar, por jo një herë në jetë a një herë në vit, një herë në muaj apo javë, por pesë herë në ditë.

Kur njeriu e forcon mirë këtë lidhje (me Allahun e Lartmadhëruar), të tjerat janë shumë më të lehta, prandaj jo rastësisht hasim se sjelljet e njeriut në jetën e përditshme janë siç i ka sjelljet me Zotin e vet. Dijetarët e vjetër për të gjykuar për një njeri, kanë shikuar se a i përfill rregullat e Zotit (sidomos faljen e namazeve).

Pas lidhjes së ngushtë që duhet të ketë njeriu me Krijuesin e vet, pastaj duhet lidhja me krijesat (njerëzit), pra të jepet zekati, sepse me dhënien e zekatit bëhen dy lidhje: zbatim i urdhrave të Allahut të Lartmadhëruar dhe lidhja me njerëzit e varfër.

Njëkohësisht me dhënien e zekatit bëhet luftë kundër koprracisë, një ves shumë i urryer nga Allahu i Lartmadhëruar, kështu që me dhënien e zekatit arrihet pëlqimi i Allahut të Lartmadhëruar, lidhja e ngushtë me njerëzit dhe sulmohet koprracia.

Pas kësaj vjen një urdhër i rreptë dhe i fortë, një urdhër i përsëritur shumë herë në Kuran, pra: وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ - **Respektojeni të Dërguarin.**

Këtij urdhri sot muslimanët i kushtojnë më së paku rëndësi, duke u arsyetuar se nuk prish punë, sunet është...!?

Por, Allahu i Lartmadhëruar sa e sa herë ka porositur në Kuran që të respektohet Muhamedi, alejhi selam. Gjeneratat e mëhershme kanë zbatuar disa gjëra të fesë sepse janë sunet (nga dashuria dhe respekti ndaj Resulullahut, alejhi selam), ndërsa sot lihen shumë rregulla me neglizhencën se është sunet (nuk ka dert). Subhannallah, fjala apo vepra sunet si mund të neglizhohet dhe ofendohet nga besimtari? Këtu u drejtohem disa hoxhallarëve, të cilët lëre që nuk e zbatojnë Sunetin e Resulullahut, por edhe e ofendojnë me ofendimet më të ulëta, për shembull kur bëhet fjalë për mjekrën, që jo vetëm nuk e mbajnë, por edhe e ofendojnë me fjalë të ulëta.

Allahu ua ka tërhequr vëmendjen atyre që kundërshtojnë urdhrat e Resulullahut, alejhi selam, ajet që do të vijë më vonë (fundi i ajetit 63).

Allahu i Madhëruar respektin ndaj Pejgamberit e ka vendosur paralelisht me urdhrat e Tij, p.sh:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ

“Respektojeni Allahun dhe respektojeni të Dërguarin.”

Apo me tjetër ajet thotë: مَنْ يُطِيعِ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ

“Kush e respekton Pejgamberin, ai e ka respektuar Allahun.”

Pyetësi mund të thotë: Po pse duhet respektuar aq shumë Pejgamberi, alejhi selam, kur është thjesht një njeri?

Themi se së pari është i Dërguari i Allahut të Lartmadhëruar dhe se çdo fjalë që flet, e ka me shpallje nga Allahu. Këtë e argumenton Kurani Famëlartë:

وَمَا يَنْطِقُ عَنِ الْهَوَىٰ ۖ إِنْ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ

“Dhe ai nuk flet nga mendja e tij. Është vetëm shpallje që i frymëzohet”. (En-Nexhm: 3-4)

Allahu i Lartmadhëruar madje na qorton nëse i thyejmë urdhrat e Muhamedit, alejhi selam, duke na thënë:

فَلْيَحْذَرِ الَّذِينَ يُخَالِفُونَ عَنْ أَمْرِهِ أَنْ تُصِيبَهُمْ فِتْنَةٌ أَوْ يُصِيبَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ

“Le të ruhen ata të cilët kundërshtojnë rrugën e tij se ata mund t’i godet ndonjë telashe , ose do t’i godasë dënim i hidhët”. (En-Nur: 63)

Vetë Muhamedi, alejhi selam, e ka ngritur Sunetin në një gradë të lartë, kur ka thënë:

أَلَا إِنِّي أُوتِيتُ الْكِتَابَ وَ مِثْلَهُ مَعَهُ

“Më është dhënë mua Kurani dhe sikur ai (Kurani) edhe Suneti.” (Transmeton Ebu Davudi me nr. 4604 dhe të tjerët).

Gjeneratat e hershme i janë përmbajtur Sunetit shumë dhe fort. Jo rastësisht Pejgamberi, alejhi selam, thotë në hadithin e gjatë e të njohur nga Irban ibn Sarijete, ku në pjesën e fundit të hadithit thotë:

“Shtrëngojeni atë fort me dhëmballa”. عضوا عليها بالنواجذ

Kur muslimanët gradualisht filluan t'i largohen Sunetit duke mos i kushtuar rëndësi, e lanë tërë fenë e Allahut të Madhëruar dhe u dobësuan deri në atë shkallë, saqë dihet sot gjendja e tyre në botë. Kjo nuk është asgjë përveç asaj që ka thënë Allahu i Madhëruar në Kuran:

وَمَا أَصَابَكُمْ مِنْ مُصِيبَةٍ فَمَا كَسَبَتْ أَيْدِيكُمْ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ

“Çka u godet ndonjë e keqe, është atë çka e keni përfituar me duart tuaja”. (Esh-Shura: 30)

Allahu i Madhëruar në Kuran thotë:

إِنَّ اللَّهَ لَا يُغَيِّرُ مَا بِقَوْمٍ حَتَّى يُغَيِّرُوا مَا بِأَنْفُسِهِمْ

“Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli përderisa ata nuk e ndryshojnë vetveten.”

(Er-Rad: 11)

Në luftën e Uhudit muslimanët, edhe pse ishin shokë të Muhamedit, alejhi selam, shkelën një urdhër të tij (një

sunet) dhe i goditi më e keqja, saqë humbën edhe luftën, u sulmua Pejgamberi, alejhi selam, vdiqën një numër i konsiderueshëm i shokëve të Muhamedit, alejhi selam, me në krye Hamzën, radijAllahu anhu (xhaxhain e Resullullahut, alejhi selam). Ata shkelën vetëm një sunet, edhe pse nuk e bënë me qëllim, por e keqkuptuan dhe në fund e pësuan keq. Vallë muslimanët sot sa sunete e farze i lënë? Po për ta kthyer krenarinë e duhur, sa sunete e farze duhet të veprojnë? Pa e ndryshuar veten, nuk ka ndryshim të gjendjes!

اللَّهُ إِنَّ اللَّهَ لَا يُغَيِّرُ مَا بِقَوْمٍ حَتَّى يُغَيِّرُوا مَا بِأَنْفُسِهِمْ

“Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli përderisa ata të mos e ndryshojnë veten”.

(Er-Rad: 11)

Edhe pse ka ende shumë argumente të tjera që e lartësojnë gradën e sunetit, na mjaftojnë vetëm këto që të bindemi dhe të vërtetojmë se sa vlerë dhe gradë të lartë posedon ai.

Allahu i Madhëruar ka urdhëruar të bëhet kjo lidhje:

1. me Allahun e Madhëruar (duke iu përkushtuar namazit),
2. me njerëzit (dhënien e zekatit),
3. me respektimin e Pejgamberit, alejhi selam.

Në fund, si rezultat i këtyre, Allahu i Madhërishëm do të na mëshirojë, në qoftë se u përmbahemi si duhet.

57- لَا تَحْسَبَنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا مُعْجِزِينَ فِي الْأَرْضِ وَمَأْوَاهُمُ النَّارُ وَلَبِئْسَ
الْمَصِيرُ

57. “Kurrresi mos mendoni se jobesimtarët (qafirët) mund të shpëtojnë në tokë (prej dënim-it). Vendbanimi i tyre do të jetë zjarri, vërtet vendbanim i keq është ai”.

Ky është përgënjeshttrim i atyre që pretendojnë se jobesimtarët jetojnë jetë komode, edhe pse nuk u përmbahen rregullave dhe dispozitave që kërkojnë prej Allahut të Lartmadhëruar. Pra, ky përgënjeshttrim njëkohësisht është vërtetim i fjalës së Allahut të Lartmadhëruar, se kushdo që nuk i përmbahet fesë së Allahut, ka për t’ia bërë jetën terr në këtë botë dhe në tjetrën. Allahu thotë:

124- وَمَنْ أَعْرَضَ عَنْ دِكْرِي فَإِنَّ لَهُ مَعِيشَةً ضَنْكًا وَنَحْشُرُهُ يَوْمَ
الْقِيَامَةِ أَعْمَى

“Kush i largohet fesë time, unë do t’ia bëj jetën e ngushtë...” (Taha: 124)

58- يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لِيَسْتَأْذِنَكُمْ الَّذِينَ مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ وَالَّذِينَ لَمْ
يَبْلُغُوا الْحُلُمَ مِنْكُمْ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ مِنْ قَبْلِ صَلَاةِ الْفَجْرِ وَحِينَ تَضَعُونَ
ثِيَابَكُمْ مِنَ الظَّهِيرَةِ وَمِنْ بَعْدِ صَلَاةِ الْعِشَاءِ ثَلَاثُ عَوْرَاتٍ لَكُمْ لَيْسَ

عَلَيْكُمْ وَلَا عَلَيْهِمْ جُنَاحٌ بَعْدَهُنَّ طَوَافُونَ عَلَيْكُمْ بَعْضُكُمْ عَلَى بَعْضٍ
كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ الْآيَاتِ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ

58. “O ju të cilët besuat, le të kërkojnë lejen prej jush robërit dhe robëreshat (shërbëtorët dhe shërbëtoret) dhe ata që nuk kanë arritur moshën e pjekurisë, para se të hyjnë te ju, në tri kohë: para namazit të sabahut, në kohën e drekës kur i hiqni rrobat tuaja (për të pushuar) dhe pas namazit të jaciesë (natën) . Këto tri kohë janë të fshehtësisë (pushimit) vetjake për ju. Pos këtyre kohëve nuk është mëkat as për ju e as për ata për të hyrë te njëri-tjetri duke ndenjur e ndihmuar njëri-tjetrin. Kështu Allahu jua sqaron argumentet e veta. Allahu është i Dijshmi, i Urti”.

Ky ajet përmbledh kërkimin e lejes mes të afërmeve, ndërsa ajo që është cekur në fillim të sures është kërkitimi i lejes mes të huajve në ajetin. Domethënë në fillim jepen rregullat e hyrjes së të huajve nëpër shtëpi të huaja, kurse tani rregullat brenda shtëpisë.

Shërbëtorët dhe fëmijët e vegjël, të cilët nuk kanë arritur moshën e pjekurisë, hyjnë e qarkullojnë nëpër shtëpi pa leje, përveç në tri kohë kur zakonisht njerëzit pushojnë, ndërrojnë rrobat e tyre ose flenë vetë a me

gratë e tyre, kështu që njeriu dëshiron të jetë i vetmuar në këto raste.

Këto tri kohë kur duhet të kërkojnë leje edhe vetë shërbëtorët dhe të vegjlit janë:

1. Koha para namazit të sabahut, sepse njerëzit zakonisht janë duke fjetur e nuk dihet se në cilën pozitë qëllojnë.
2. Në kohën e drekës, që është koha e pushimit dhe koha kur njerëzit i heqin apo i ndërrojnë rrobat e veta.
3. Pas kohës së jaciesë, e cila është koha e pushimit apo kohë kur njeriu preferon të jetë i vetmuar në dhomën e vet, për të qenë më i lirë.

Pse Allahu i Lartmadhëruar i ka quajtur këto tri kohë të avretit (fshehtësisë)?

Për shkak se në këto tri kohë njeriut ndodh që t'i zbulohet avreti (pjesët e turpshme të trupit) ose t'i ndërrojë rrobat e veta dhe në atë moment t'i shihet trupi (pjesa e turpshme).

Për të mos ndodhur një gjë e tillë, Allahu i Lartmadhëruar e ka bërë obligim kërkimin e lejes. Këtu shihet korrektësia e fesë së Allahut së Lartmadhëruar, e cila mbron edhe interesin e fëmijëve, sepse nëse ndodh një gjë e tillë (që fëmija të shohë ndonjë skenë jo të preferuar), kjo do të shkaktojë pengesë a dëme psikike

në të ardhmen, të cilat vështirë se shërohen. Këtë e kanë vërtetuar edhe psikologët, pasi shkenca bashkëkohore ka përparuar shumë. Më i dituri dhe më i përsosuri (Allahu) i ka edukuar besimtarët me këto rregulla sepse dëshiron të krijojë një shoqëri të shëndoshë dhe pa brenga.

Kjo ishte pjesa e parë e ajetit, e cila kërkon që të merret leje për hyrje në tri kohët e lartpërmendura. Po në kohët e tjera vallë?

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

لَيْسَ عَلَيْكُمْ وَلَا عَلَيْهِمْ جُنَاحٌ بَعْدَهُنَّ طَوَافُونَ عَلَيْكُمْ بَعْضُكُمْ عَلَى
بَعْضٍ

**“...Pos këtyre kohëve nuk është mëkat as për ju
e as për ata për të hyrë te njëri-tjetri...”**

U është lejuar atyre për hyrje e dalje sepse është nevoja për shërbim etj.. Kjo është e veçantë për ta e jo për të tjerët (edhe pse janë të vegjël apo shërbëtorë). Këtu vlen të përmendet shkaku i shpalljes së ajetit.

Transmetohet se Pejgamberi, alejhi selam, dërgoi një vogëlush prej ensarëve, i cili quhej Mudlixh, tek Omer ibën Hatabi, radijAllahu anhu, në kohën e drekës për ta thirrur atë. Kur vogëlushi arriti, pa se Omeri ishte duke fjetur dhe derën e kishte të mbyllur. Vogëlushi i ra derës, thirri dhe hyri.

U zgjua Omeri, radijAllahu anhu, u ul dhe iu zbulua diçka nga trupi i tij. Omeri, radijAllahu anhu, tha: “Shpre-soj që Allahu i Lartmadhëruar t’i ndalojë fëmijët, gratë dhe shërbëtorët tanë të hyjnë në këto kohë, vetëm se me leje.”

Omeri, radijAllahu anhu, shkoi te Pejgamberi, alejhi selam, dhe mori vesh se kishte zbritur ky ajet. Omeri, radijAllahu anhu, i ra Zotit në sexhde falënderimi për këtë ajet.

Ky ajet është shpallur në Mekë. Komentuesit e Kura-nit kanë cekur edhe disa transmetime të tjera, por ne zgjodhëm këtë për të cilin kishte më shumë transme-time (Tefsir Ebu Bekr El-Xhezairi (Ejser tefasir), 2/1013)

Ky është njëri prej ajeteve që janë shpallur në përputhje me kërkesën apo propozimin e Omerit, radi-jAllahu anhu.

59 - وَإِذَا بَلَغَ الْأَطْفَالُ مِنْكُمُ الْحُلُمَ فَلْيَسْتَأْذِنُوا كَمَا اسْتَأْذَنَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ آيَاتِهِ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ

59. “E kur fëmijët tuaj ta arrijnë moshën e pjekurisë (pubertetit), le të kërkojnë leje (për hyrje) ashtu si kërkuan ata para tyre. Allahu ju shpjegon dispozitat e veta, sepse Ai di më së miri dhe është më i Urti”.

Allahu i Madhëruar këtu sqaron rregullat për fëmi-jët, që kur të hyjnë në kohën e pjekurisë (puberte-

tit), patjetër duhet të kërkojnë leje për të hyrë sepse bëhen të mëdhenj dhe rregullat për ta vlejné si të ishin të huaj, edhe pse më herët mund të hynin pa leje, por pasi të arrijnë kohën e pubertetit, duhen të marrin leje si të mëdhenjtë. Këtu dëshmohet vërtetësia e Kuranit Famëllartë, pasi Allahu i Madhëruar nuk ka lënë gjë pa e cekur në këtë libër, siç thotë:

مَا فَطَرْنَا فِي الْكِتَابِ مِنْ شَيْءٍ

“Nuk kemi lënë send pa e cekur në këtë libër”.

(En-Amë: 38)

As çështjet më të imëta nuk janë lënë pas dore sepse Allahu dëshiron të na shpjegojë dispozitat e Veta. Ai di më së miri dhe është më i urti.

60- وَالْقَوَاعِدُ مِنَ النِّسَاءِ اللَّاتِي لَا يَرْجُونَ نِكَاحًا فَلَيْسَ عَلَيْهِنَّ جُنَاحٌ أَنْ يَضَعْنَ ثِيَابَهُنَّ غَيْرَ مُتَبَرِّجَاتٍ بِزِينَةٍ وَأَنْ يَسْتَعْفِفْنَ خَيْرٌ لَهُنَّ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ

60. “E gratë e moshuara të cilat nuk kanë ndjenja martese (epshi), për to nuk është mëkat ta heqin petkun mbulues të bukurive, megjithatë më së miri për to është të jenë të vazhdojnë me të e të jenë të përmbajtura – Allahu është Gjithëdëgjues dhe i Gjithëdituri”.

Allahu i Madhëruar këtu bën një lehtësim për gratë e moshuara, të cilat nuk kanë më ndjenja për martesë apo u janë ndërprerë menstruacionet e nuk kanë shpresë që të lindin fëmijë. Atyre u lejohet ta heqin petkun mbulues (mantelin) për shkak se ato kanë arritur në një moshë që nuk e tërheqin syrin e mashkullit, me një fjalë nuk janë më provokuese, sepse qëllimi i mbulimit të gruas është që të mos i provokojë njerëzit në rrugë apo t'ua tërheqë shikimin e të ndodhin çrregullime në shoqëri.

Kjo është e kundërta e asaj që kuptojnë gratë dhe që e praktikojnë sepse të rejat po zbulohen dhe po mundohen t'i sa më shumë shfaqin bukuritë, stolitë apo pjesët e trupit të tyre, ndërsa të moshuarat bëjnë të kundërtën, mundohen të mbulohen sa më shumë, ndërsa Allahu i Madhëruar kërkon të kundërtën.

Kohëve të fundit për fat të keq po hasim rrugëve disa gra të ashtuquajtura të mbuluara, por që në mbulesat e tyre kanë lloj-lloj zbukurimesh, madje ato po lyhen me parfume të ndryshme dhe në fund pretendojnë se janë të mbuluara. Të mjerat harrojnë se Allahu i Madhëruar nuk dëshiron që besimtari e besimtarja të kenë formalitet, por Ai dëshiron devotshmëri. Në qoftë se mbulesa nuk i plotëson kushtet e veta, ajo nuk llogaritet mbulesë, edhe pse femra e ka të mbuluar tërë trupin.

Kushtet e mbulesës janë tetë:

- 1) të mbulojë tërë trupin e gruas (me përjash-tim të fytyrës duarve dhe këmbëve, edhe pse këtu ka shumë mendime, por prapë themi se nuk është obli-gativ mbulimi i këtyre gjymtyrëve, ndërsa është më e preferuar dhe më afër devotshmërisë);
- 2) të mos jetë tërheqëse për shikimin;
- 3) të mos jetë e tejdukshme;
- 4) të jetë e gjerë, të mos jetë e ngushtë që t'i definohen a t'i shihen gjymtyrët;
- 5) të mos jetë e parfumuar;
- 6) të mos i përngjajë veshjes së burrave;
- 7) të mos i përngjajë veshjes së jobesimtareve;
- 8) të mos ketë qëllim afirmimin në popull.

Pra, këto janë kushtet e mbulesës. Në qoftë se bie ndonjë prej këtyre kushteve, ajo mbulesë është e pavlefshme, si te namazi, në qoftë se lë ndonjërin prej kushteve të namazit, namazi është i papranuar.

Pejgamberi, alejhi selam, thotë:

عن أبي هريرة رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه قال: صِنْفَانِ مِنْ أَهْلِ النَّارِ لَمْ أَرَهُمَا، قَوْمٌ مَعَهُمْ سِيَاطٌ كَأَذْنَابِ الْبَقَرِ يَضْرِبُونَ بِهَا النَّاسَ، وَنِسَاءٌ كَاسِيَاتٌ عَارِيَّاتٌ مُمِيلَاتٌ مَائِلَاتٌ، رُؤُوسُهُنَّ كَأَسْنِمَةِ الْبُخْتِ الْمَائِلَةِ، لَا يَدْخُلْنَ الْجَنَّةَ، وَلَا يَجِدْنَ رِيحَهَا، وَإِنَّ رِيحَهَا لَيُوجَدُ مِنْ مَسِيرَةِ كَذَا وَكَذَا.

رواه مسلم :

Nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu, transmetohet se Resulullahu, alejhi salam, ka thënë: “Dy lloje të banorëve të zjarrit nuk i kam parë ende: një grup të cilët mbajnë shkopinj në duar si bishtat e lopëve dhe me to rrahin njerëzit dhe gra të cilat janë të mbuluara, por në realitet të zbuluara, lakohen gjatë ecjes së tyre, kokat e tyre i kanë si gunga e devesë. Të tillat nuk do të hynë në xhenet e as që e nuhasin erën e tij, edhe pse era e tij nuhatet shumë larg”. (Transmeton Muslimi)

Atëherë le të kenë frikë Allahun në lidhje me mbulesën pasi Pejgamberi, alejhi salam, thotë:

إِنَّ اللَّهَ يَحِبُّ عَمَلْ أَحَدِكُمْ إِذَا عَمَلَهُ أَنْ يَتَّقَنَهُ . رواه الطبراني و قد صححه الالباني.

“Allahu dëshiron nga ju që kur t’i bëni veprat, t’i bëni mirë”. Transmeton Et-Teberanij dhe e ka vërtetuar shejh Albani.

Në këtë ajet vërejmë se Allahu u drejtohet të moshuarave që ato megjithatë të mos dalin të parfumuara e të lyera me grim. Edhe pse janë të moshuara, dalja e tyre me petkun mbulues do të ishte më mirë për to me qëllim që t’i mbyllen rrugët djallit.

61 - لَيْسَ عَلَى الْأَعْمَى حَرَجٌ وَلَا عَلَى الْأَعْرَجِ حَرَجٌ وَلَا عَلَى الْمَرِيضِ حَرَجٌ وَلَا عَلَى أَنْفُسِكُمْ أَنْ تَأْكُلُوا مِنْ بُيُوتِكُمْ أَوْ بُيُوتِ آبَائِكُمْ أَوْ بُيُوتِ أُمَّهَاتِكُمْ أَوْ بُيُوتِ إِخْوَانِكُمْ أَوْ بُيُوتِ أَخَوَاتِكُمْ أَوْ بُيُوتِ أَعْمَامِكُمْ أَوْ بُيُوتِ عَمَّاتِكُمْ أَوْ بُيُوتِ أَخْوَالِكُمْ أَوْ بُيُوتِ خَالَاتِكُمْ أَوْ

مَا مَلَكَتُمْ مَفَاحَهُ أَوْ صَدِيقُكُمْ لَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ أَنْ تَأْكُلُوا جَمِيعًا أَوْ أَشْتَاتًا فَإِذَا دَخَلْتُمْ بُيُوتًا فَسَلِّمُوا عَلَى أَنْفُسِكُمْ تَحِيَّةٌ مِنْ عِنْدِ اللَّهِ مُبَارَكَةٌ طَيِّبَةٌ كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ الْآيَاتِ لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ

61. “Nuk është mëkat për të verbrin, as për të çalin, as për të sëmurin, as për ju në qoftë se hani në shtëpitë tuaja, ose në shtëpitë e baballarëve tuaj, ose në shtëpitë e nënave tuaja, ose në shtëpitë e vëllezërve tuaj, ose në shtëpitë e motrave tuaja, në shtëpitë e xhaxhallarëve tuaj, hallave, dajallarëve, tezeve tuaja ose në shtëpinë e të cilës ju i mbani çelësat, ose në shtëpinë e ndonjë shoku tuaj. Mund të hani bashkërisht ose veçmas, nuk është mëkat. Kur të hyni në shtëpi përshëndeteni njëri-tjetrin me një përshëndetje të caktuar nga Allahu (Es selamu alejkum – paqja dhe mëshira qoftë mbi ju) që është e bekuar dhe e këndshme. Kështu Allahu jua sqaron argumentet që t’i kuptoni”.

Në këtë ajet kuranor Allahu i Madhëruar na tregon për ata që kanë arsye (kanë të meta fizike, si i verbri, i çali, i sëmuri), që të mos ngushtohen duke mos ngrënë me të shëndoshët sepse Allahu i Madhëruar e urren mendjemadhësinë dhe mendjemëdhenjtë. Ai nga robërit e Vet do modesti.

Nuk prish punë, o ju besimtarë, që të hani në shtëpitë e të afërmve tuaj, apo të shokëve, apo në shtëpitë e atyre që mbani çelësat e shtëpive, në të cilat shërbeni si shërbëtorë apo ju janë lënë ato çelësa në besim për ruajtje etj.. Njëkohësisht nuk është mëkat të hanë bashkërisht apo ndaras.

Arabët që para Islamit e urrenin të hanin ushqim të ndarë, aq sa kur dikush ishte i uritur, detyrohej të kërkonte një tjetër që ta shoqëronte në ushqim e të mos hante i vetëm.

Allahu i Madhëruar ua largoi këtë ngarkesë, u lejoi të hanë veçmas apo bashkë, mirëpo është e preferuar që nëse ka mundësi, ushqimi të hahet bashkërisht sepse është më mirë. Imam Ahmedi transmeton një hadith të Pejgamberit, alejhi selam, se një njeri i tha Pejgamberit, alejhi selam:

“Ne po hamë ushqim, por nuk po ngopemi!”

Pejgamberi, alejhi selam, iu drejtua duke i thënë:

“Ndoshta mos jeni duke ngrënë të vetmuar? Bashkohuni në ushqimin tuaj e përmendeni emrin e Allahut, do t’ju japë bereqet në të.” (Transmetojnë Ebu Davudi dhe Ibën Maxhe).

Vlen të shtohet se komentuesit e tefsirit kanë cekur disa mendime mbi zbritjen e këtij ajeti, por do të përmendim vetëm dy prej tyre:

1. Nga Seid ibën el Musejibi, radijAllahu anhu, i cili ka thënë: “Kur njerëzit dilnin me Pejgamberin, alejhi selam (në luftëra, udhëtime të ndryshme e të tjera), i linin çelësat e shtëpive të tyre te të verbrit, te njerëzit me të meta fizike e te të sëmurit, te të afërmit e tyre, ndërsa (pronarët e shtëpive) u lejonin atyre që gjatë kësaj periudhe të hanin në shtëpitë e tyre në qoftë se kishin nevojë, mirëpo ata kishin frikë të merrnin diçka në ato shtëpi duke pasur parasysh se është amanet dhe thoshin se ndoshta pronarëve nuk u fle zemra që të merrnin nga ato shtëpi. Për këtë arsye u shpall ky ajet”.

2. Nga Muxhahidi transmetohet të ketë thënë: “Njerëzit që kishin të meta fizike, që ishin të verbër, çalamane, memecë a të shurdhër, secili që kishte nevojë, i merrte njerëzit dhe i dërgonte nëpër shtëpitë e familjarëve të vet për t’i ushqyer. Nëse nuk gjendej ushqim nëpër shtëpitë e tyre, i dërgonin nëpër shtëpitë e të afërme të tyre për t’i ushqyer këta nevojtarë, por këtyre që i ushqenin, u vinte rëndë se mos ndoshta po i ngushtonin apo pengonin familjarët me këta nevojtarë. Për këtë Allahu i Madhëruar e shpalli këtë ajet:

62 - إِمَّا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ آمَنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ وَإِذَا كَانُوا مَعَهُ عَلَى أَمْرٍ جَامِعٍ لَمْ يَذْهَبُوا حَتَّى يَسْتَأْذِنُوهُ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَأْذِنُونَكَ أُولَئِكَ الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ فَإِذَا اسْتَأْذَنُوكَ لِيُعْضِ شَأْنِهِمْ فَأَذَنْ لِمَنْ شِئْتَ مِنْهُمْ وَاسْتَغْفِرْ لَهُمُ اللَّهُ إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ

62. “Besimtarë të vërtetë janë ata të cilët besojnë në Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe kur janë me të (Dërguarin) për ndonjë çështje të përbashkët – nuk largohen pa i kërkuar leje Atij. S’ka dyshim se ata që kërkojnë leje prej Teje, ata i besojnë Allahut dhe të Dërguarit të Tij – e kur të kërkojnë leje për ndonjë punë të tyre, jepu leje kujt të duash prej tyre – dhe lute Allahun e kërko falje për ta, vërtet Allahu është Falës dhe Mëshirues”.

Ky është udhëzim i Allahut për robërit besimtarë, pasi Ai nuk ka lënë asnjë çështje të jetës pa e rregulluar. Prej rregullimit të lidhjes farefisnore dhe shoqërore transferohet në rregullimin e familjes më të gjerë, që është familja islame, ku kryefamiljari dhe udhëheqësi i kësaj familjeje islame është Muhamedi, alejhi selam.

Allahu i urdhëron besimtarët që kur ata të kenë ndonjë çështje të përbashkët për të punuar – qoftë në xhami, në xhihad apo konsultime e të tjera, duhet të jenë të bashkuar e mendimet e tyre të mos jenë të ndara. Besimtari i vërtetë në këso lloj rastesh (të përbashkëta) duhet të kërkojë leje nga udhëheqësi, në atë kohë nga Muhamedi, alejhi selam, ndërsa në këtë kohë nga zëvendësi i tij (qoftë prind në shtëpi, drejtor në shkollë apo shef në punë etj.).

Allahu i Madhëruar e ka bërë këtë për të kompletuar besimin, që të mos largohen nga ajo shoqëri ose nga ajo vepër e nisur pa kërkimin e lejes, madje i lavdëroi ata që kërkonin leje për ndonjë çështje personale (sëmundje, nevojë etj.) apo familjare, saqë Allahu i Madhëruar u tha:

إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَأْذِنُونَكَ أُولَٰئِكَ الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ

“Vërtet se ata që kërkojnë lejen Tënde, mu këta janë ata të cilët vërtet kanë besuar në Allahun dhe Dërguarin”.

Kur të kërkojnë leje për ndonjë punë të tyre, lejo kë të duash prej njerëzve, por nëse është interesi më i madh për mosdhënien e lejes, atëherë mos jep leje. Nëse meriton t'i jepet leja apo ka ndonjë arsye, atëherë jepi leje, madje lute Allahun për të. Komentuesit nëpër tefsire për këtë ajet a për këtë ngjarje kanë cekur edhe shkakun e zbritjes. “Kur Pejgamberi, alejhi selam, vendosi të hapte kanalin ose hendekun, mbledhi shokët e vet dhe u konsultua me ta. Pasi vendosi ta hapte, atëherë i urdhëroi dhe filluan ta hapnin, mirëpo si zakonisht hipokritët filluan të arsyetohen me arsyetime të rrejshme, duke thënë se janë të dobët ose ankohen nga shëndeti, nganjëherë iknin te familjet e tyre pa dijen e Pejgamberit, alejhi selam, e pa lejen e tij, ndërsa besimtarët e vërtetë (sahabët) e pyetnin Pejgamberin, alejhi

selam, vetëm kur kishin ndonjë rast urgjent a për ndonjë arsye, por pastaj ktheheshin menjëherë te puna e tyre, duke shpresuar për të vepruar punë të hairit dhe përfitim të sevapeve. Për këtë Allahu i Madhëruar e zbriti ajetin e sipërpërmendur.”

Këtyre u jepet leja, por duhet të plotësojnë dy kushte:

1. Kjo leje duhet të jepet për çështje të rëndësishme, përndryshe nuk lejohet.
2. Leja duhet të jetë në interes të tyre dhe të shoqërisë.

63 - لَا تَجْعَلُوا دُعَاءَ الرَّسُولِ بَيْنَكُمْ كَدُعَاءِ بَعْضِكُمْ بَعْضًا قَدْ يَعْلَمُ اللَّهُ الَّذِينَ يَسْتَلْلُونَ مِنْكُمْ لَوْ آذًا فَلْيَحْذَرِ الَّذِينَ يُخَالِفُونَ عَنْ أَمْرِهِ أَنْ تُصِيبَهُمْ فِتْنَةٌ أَوْ يُصِيبَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ

63. “Mos e bëni (llogaritni) thirrjen (duanë) e të Dërguarit mes jush siç u thërrisni (bëni dua) mes vete me njëri tjetrin. Allahu i di ata të cilët përvidhen prej jush fshehurazi, prandaj le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e tij (të Dërguarit) se ata do t’i godasë ndonjë sprovë ose do t’u jepet ndonjë dënim i dhembshëm”.

Allahu i Madhëruar ua tërheq vërejtjen këtu njerëzve që të mos e thërrasin Pejgamberin, alejhi selam, me çfarëdo emri të thjeshtë sepse ai ishte edukatori i tyre,

përgjegjësi, komandanti, prandaj thirrja e tij me emra të thjeshtë ia ul pozitën atij, alejhi selatu ve salam.

Vlen të përmendet se kjo nuk është nga mendjemadhësia, por secilit duhet t'i jepet titulli i vet dhe të thirret me titullin që posedon, veçanërisht kur është fjala për Muhamedin, alejhi salam, sepse kemi urdhëresa direkte për këtë çështje (ajete kuranore).

Allahu i Lartmadhëruar në suren el-Huxhurat, në ajetin 3 thotë:

إِنَّ الَّذِينَ يَعْضُونَ أَصْوَاتَهُمْ عِنْدَ رَسُولِ اللَّهِ

“Ata që ulin zërat e tyre pranë të Dërguarit të Allahut”.

Ka edhe ajete të tjera rreth kësaj, por na mjafton një sa për argument. Pra, qëllimi apo kuptimi i vërtetë i këtij ajeti mund të jetë:

1. Ua tërheq vërejtjen besimtarëve nga hidhërimi i Pejgamberit, alejhi salam, sepse nëse ai do të bënte lutje (dua) kundër tyre, ata do të shkatërroheshin sepse lutja e Pejgamberit, alejhi salam, nuk është si çdo lutje e njerëzve të rëndomtë. Ky është mendim i Ibën Abasit, radijAllahu anhu.

2. Të mos e thërrasin të Dërguarin në emër, p.sh. “o Muhamed”, “o Ahmed”, sepse edhe munafikët e thërrisnin Pejgamberin, alejhi salam, me emra të thjeshtë,

por është obligim ta thërrasim me emra sa më të mirë e të bukur, me butësi dhe urtësi, si p.sh.: “O i Dërguari i Allahut”, “o Pejgamber i Allahut” etj.. Këtë mendim e kanë thënë Seid ibën Xhubejri, Muxhahidi dhe Katadeja.

Taberiu i ka dhënë përparësi mendimit që thotë: “Ruajuni lutjes së Pejgamberit, që të mos bëjë dua (lutje) kundër jush, se lutja e tij nuk është sikur lutja e çdokujt prej jush, sepse në qoftë se ai (Muhamedi alejhi selam) i lutet Allahut, me siguri do ta pranonte lutjen e tij”.

Allahu i Madhëruar prapë vazhdon duke thënë:

قَدْ يَعْلَمُ اللَّهُ الَّذِينَ يَسْأَلُونَ مِنْكُمْ لَوَادًا فَلْيَحْذَرِ

“Është e vërtetë që Allahu i di ata që tërhiqen prej jush tinëzisht”.

Komentuesit janë të një mendimi se këtu është fjala për munafikët, të cilët tërhiqeshin a largoheshin nga urdhrat e Pejgamberit, alejhi selam. Madje disa prej tyre në xhuma (gjatë hutbes) nuk mund të duronin, kështu që kërkonin leje direkte dhe indirekte për të dalë nga xhamia. Ndërkaq, një grup tjetër komentuesish thonë se kur Pejgamberi, alejhi selam, i tubonte për bisedime të ndryshme, ata fshiheshin dhe largoheshin duke ikur nga përgjegjësitë.

Grupi i tretë thonë se ata u iknin rregullave dhe dispozitave të Kuranit dhe të Muhamedit, alejhi selam.

Domethënë, të gjithë janë të mendimit se ky ajet ka për qëllim hipokritët.

فَلْيَحْذَرِ الَّذِينَ يُخَالِفُونَ عَنْ أَمْرِهِ أَنْ تُصِيبَهُمْ فِتْنَةٌ أَوْ يُصِيبَهُمْ عَذَابٌ
أَلِيمٌ

**“Le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e tij
(të Dërguarit) se ata do t’i zë ndonjë telashe
ose do t’i godasë dënim i dhimbshëm”.**

Kërcënim dhe tërheqje e vërejtjes ndaj atyre që thyejnë urdhrin e Pejgamberit, alejhi salam, sepse rruga e Pejgamberit është rrugë që na ka orientuar Allahu i Lartmadhëruar.

Këtë pjesë të ajetit Allahu e ka bërë vazhdim të pjesës së parë, në të cilën u tërhoqi vërejtjen munafikëve dhe u tha se edhe pse syri i Muhamedit nuk ju sheh, Allahu i Madhëruar, sado që të fshiheni, ju sheh. Për këtë arsye duhet të keni kujdes të madh sepse shkelja e urdhrave të Muhamedit, alejhi salam, është traditë ose shenjë e munafikëve, madje mund të shpjerë në dënim a në ndonjë sprovë në këtë botë. Këtë mendim e ka thënë Ibën Abasi, kurse Ataiu thotë: “Shkatërrim dhe tërmet”.

Xhafer ibën Muhamedi thotë: “Do të sprovohen njerëzit me një sundimtar mizor”, ndërsa disa të tjerë thonë: “Vulosje e zemrës në rast të kundërshtimit të Sunetit të

Muhamedit, alejhi selam, i mbyllet në zemër kufri ose dyfytyrësia (nifaku) apo risitë e bidatet”.

Kjo është sprova në këtë botë, kurse në ahiret pason dënimi i hidhur (xhehenemi), Allahu na mbrojtë nga ai!

Këtu shihet rëndësia e Sunetit në fenë e Allahut të Madhëruar, saqë Allahu i Madhëruar e ka ngritur Sunetin paralel me Kuranin. Pejgamberi, alejhi selam, thotë:

“Më është dhënë (zbritur) Kurani dhe sikur ai me të (Suneti).”

Në vazhdim do t’i cekim disa ajete dhe hadithe që dëshmojnë për vlerën dhe pozitën e Sunetit të Muhamedit, alejhi selam.

Allahu i Madhëruar thotë:

وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ

1- “Atë që ua ka dhënë Pejgamberi, merreni dhe atë që ua ka ndaluar, ndërpriteni”. (El Hashr, 7)

قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ

2- “Thuaj në qoftë se pretendoni që ju e doni Allahun, atëherë më pasoni mua (Pejgamberin), që t’ju dojë Allahu”. (Ali Imran, 31)

Pra, pasimi i Pejgamberit, alejhi selam, është kusht që të të dojë Allahu.

مَنْ يُطِيعِ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ

3- “Kush respekton Pejgamberin, ka respektuar Allahun”. (En Nisa. 80)

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اسْتَجِيبُوا لِلَّهِ وَلِلرَّسُولِ إِذَا دَعَاكُمْ لِمَا يُحْيِيكُمْ

4- “O ju që besuat, përgjigjuni (thirrjes së Allahut) dhe të Dërguarit kur ai (i Dërguari) ju fton për atë që ju jep jetë”. (El Enfal, 24)

فَلَا وَرَبِّكَ لَا يُؤْمِنُونَ حَتَّى يُحَكِّمُوكَ فِيمَا شَجَرَ بَيْنَهُمْ ثُمَّ لَا يَجِدُوا فِي أَنْفُسِهِمْ حَرَجًا مِمَّا قَضَيْتَ وَيُسَلِّمُوا تَسْلِيمًا

5. “Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë derisa të mos zgjedhin ty (o Muhamed) për të gjykuar në atë konflikt mes tyre”. (En Nisaë 65)

Këto ishin vetëm disa ajete sa për argument, edhe pse ka edhe ajete të tjera, mirëpo na mjaftojnë këta, ndërsa në vazhdim do të cekim disa hadithe të Pejgamberit, alejhi selam:

Pejgamberi, alejhi selam, thotë:

الْأَوَّلَىٰ أَعْطِيتَ الْكِتَابَ وَ مِثْلَهُ مَعَهُ

1- “Më është zbritur mua Kurani dhe i ngjashëm si ai me të (Suneti).” (Sahih Ebu Daudi).

الآ و إِنَّ مَا حَرَّمَهُ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَ سَلَّمَ مِثْلُ الَّذِي حَرَّمَ
اللَّهُ. رواه البخاري و مسلم عن عمر ابن الخطاب

2 – “Ajo që ka ndaluar Resulullahu, alejhi selam, është
e njëjtë sikur ajo që e ka ndaluar Allahu. (Transmeton Buha-
riu dhe muslimi nga Omer I biri Katabit)

—عن أبي هريرة رضي الله عنه عن النبي صلى الله عليه و سلم قال:
تركت فيكم شيئان ما إن تمسكنم بهما لن تضلوا أبدا كتاب الله و
سنتي . صحيح الجامع لشيخ الالباني ص. 2937

3- Nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu, transmetohet
se Resulullahu, alejhi selam, ka thënë: “Po ju lë dy çështje,
në qoftë se do t’u përmbahuni atyre, nuk do të humbni
kurrë: Libri i Allahut dhe Suneti im.” Transmeton Muslimi.

عن أنس ابن مالك رضي الله عنه قال فمن رغب عن سنتي
فليس بمسي .
أخرجه البخاري 5063

4- “Kush ia kthen shpinën Sunetit tim, nuk është prej
meje (umetit tim).” Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga
Enes ibën Maliku.

Pra, këto janë argumentet që dëshmojnë për parale-
lizmin ose për rëndësinë e Sunetit në fenë e Allahut të
Madhëruar.

Me këto argumente u drejtohem atyre që me plot guxim ndalen e thonë se nuk është me rëndësi kjo apo ajo sepse është sunet.

Vallë, a nuk kemi frikë se disa sunete mund të shkaktojnë që Allahu mund të zbresë ndonjë sprovë në këtë botë apo ndonjë dënim të dhembshëm në ahiret, rreth të cilit u cek ajeti më herët, në të cilin Allahu thotë:

63- فَلْيَحْذَرِ الَّذِينَ يُخَالِفُونَ عَنْ أَمْرِهِ أَنْ تُصِيبَهُمْ فِتْنَةٌ أَوْ يُصِيبَهُمْ
عَذَابٌ أَلِيمٌ

63. “Le të kenë kujdes ata të cilët kundërshtojnë urdhrat e tij, se mund t’i godasë ndonjë sprovë (në këtë botë) a ndonjë dënim i madh në ahiret”.

Kujdes, o ju të cilët nuk i kushtoni rëndësi Sunetit të Pejgamberit alejhi selam, pasi Muhamedi, alejhi selam, thotë:

عن المقدم ابن معد يكرب الكندي رضي الله عنه : أن النبي صلى
الله عليه وسلم قال:
يوشك رجلاً منكم متكئاً على أريكته يحدث بحديث عني فيقول بيننا
و بينكم كتاب الله فما وجدنا فيه من حلالٍ إستحللناه وما وجدنا
فيه من حرامٍ حرّمناه ألا وإن ما حرّمه رسول الله صلى الله عليه و
سَلَّمَ مثل الذي حرّم الله. رواه ابن ماجه 12 و أحمد 17194

*“Kam frikë se dikush prej jush, i shtrirë në mbësh-
tetësen e tij, thotë ndonjë hadith për mua duke u shprehur:
“Mes nesh dhe jush qëndron libri i Allahut, atë që e gjejmë
aty nga hallallet, e bëjmë hallall, e atë që e gjejmë haram,
e bëjmë haram.” Sahih nga Ibën Maxhe dhe Ahmedi.*

Është e vërtetë se atë që e ka bërë Pejgamberi haram,
është e njëjtë sikur ta kishte bërë haram Allahu. Unë nuk
di që pas këtyre argumenteve t’u ketë ngelur diçka atyre
që bëjnë tolerime, të mos them edhe tallje me Sune-
tin e Pejgamberit, alejhi selam! Allahu na udhëzofte të
gjithëve në përmbajtjen ndaj librit të Tij dhe Sunetit të
Muhamedit, alejhi selam!

64 - أَلَا إِنَّ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ قَدْ يَعْلَمُ مَا أَنتُمْ عَلَيْهِ وَيَوْمَ
يُرْجَعُونَ إِلَيْهِ فَيُنَبِّئُهُمْ بِمَا عَمِلُوا وَاللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

**64. “E me të vërtetë, vetëm i Allahut është i tërë
pushteti qoftë në qiej apo në tokë”.**

Ai e di gjendjen në të cilën janë, Ai e di edhe ditën kur
ata sillen prapë tek Ai, pastaj Ai do t’i njoftojë për veprat
që kanë punuar. Allahu është i Dijshëm për çdo send.

Në ajetin e fundit të kësaj kaptine Allahu i Madhëruar
përfundon duke i rikujtuar robërit e Vet për madhërinë
e Tij, pasi i ka informuar për rregullat dhe dispozitat e
shumta të kësaj feje, duke u rikujtuar atyre se i tërë push-

teti dhe të gjitha krijesat, qofshin ato në tokë apo në qiej, janë nën sundimin e Tij - të Lartmadhëruarit, madje edhe ato të thellësive – fshehtësirave, po ashtu Ai di edhe çdo vepër që veprojnë robërit e Tij.

“Pra, Ai e di gjendjen tuaj”. قَدْ يَعْلَمُ مَا أَنْتُمْ عَلَيْهِ

Ai e dinte kur ata përvidheshin gjatë hapjes së hendekut, po ashtu edhe ata gjatë hutbes së xhumasë. Pas gjithë këtyre dispozitave të lartpërmendura, dijeni se Allahu ju sheh dhe se Atij nuk i shpëton asnjë gjë, madje e di edhe gjethin që bie në mal.

وَعِنْدَهُ مَفَاتِيحُ الْغَيْبِ لَا يَعْلَمُهَا إِلَّا هُوَ وَيَعْلَمُ مَا فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ وَمَا تَسْقُطُ مِنْ وَرَقَةٍ إِلَّا يَعْلَمُهَا وَلَا حَبَّةٍ فِي ظِلْمَاتِ الْأَرْضِ وَلَا رَطْبٍ وَلَا يَابِسٍ إِلَّا فِي كِتَابٍ مُبِينٍ

“Çelësat e fshehtësisë janë vetëm tek Ai, atë (fshehtësinë) nuk e di kush pos Tij. Ai e di çka ka në tokë dhe në det – Ai e di për çdo gjeth që bie dhe nuk ka kokërr në thellësi të tokës, s’ka të njomë dhe nuk ka të thatë që nuk është (shënuar) në librin e qartë (Levhi Mahfudh)”.

(El En’am, 59)

“Në atë ditë kur ata do të kthehen tek Ai”.

وَيَوْمَ يُرْجَعُونَ إِلَيْهِ

Kur do të kthehen krijesat tek Ai për gjykim, në Ditën e Gjykimit ato do të informohen për çdo vepër që kanë vepruar, qoftë e vogël apo e madhe, e mirë apo e keqe.

يَوْمَئِذٍ يَصْدُرُ النَّاسُ أَشْتَاتًا لِيُرَوْا أَعْمَالَهُمْ 6 فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ 7 وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ

“Atë ditë njerëzit shfaqen të ndarë në grupe që të shpërblehen për veprat e tyre – e kush punoi ndonjë të mirë që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe që peshon sa grimca, atë do ta gjejë”. (Ez-Zelzele)

يُنَبِّئُ الْإِنْسَانَ يَوْمَئِذٍ بِمَا قَدَّمَ وَأَخَّرَ

“Atë ditë njeriu do të njihet me atë që çoi para dhe me atë që la prapa”. (El Kijame, 13)

وَيَوْمَ يُرْجَعُونَ إِلَيْهِ فَيُنَبِّئُهُمْ بِمَا عَمَلُوا وَاللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

“Atë ditë kur do të kthehen tek Ai, Ai do t'i njohë ata për veprat që kanë punuar – Allahu është i Dijshëm për çdo send”.

Kështu përfundon surja Nur, duke i lidhur zemrat dhe sytë vetëm me Allahun, duke i përkujtuar besimtarët që të kenë frikë dhe respekt dhe kjo është siguria e vetme. Pra, kjo është roja dhe siguria e këtyre urdhëre-

save dhe ndalesave, këto janë moralet dhe edukatat që i ka bërë Allahu obligative në këtë sure dhe i ka bërë të gjitha të barabarta. Allahu e mbaron këtë sure duke na porositur se për të gjitha dispozitat e kërkuara, Ai do të na shpërblejë apo ndëshkojë në atë ditë që do të kthehemi tek Ai, se Ai është përcjellësi dhe i dituri për çdo send që veprojnë robërit, Atij nuk mund t'i fshihet asgjë.

Ve ahir da'vana en il hamdulilahi Rabi- Alemin.

PËRFUNDIM

Falënderimet i takojnë vetëm Allahut, vetëm Atë e adhurojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Atë të cilin e udhëzon Allahu, nuk ka kush e humb e atë që e humb Allahu, nuk ka kush që e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar askush përpos Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

Falënderoj Allahun që më mundësoi ta mbaroja këtë koment të kësaj sure të ndritshme.

Edhe pse kaloi një kohë e gjatë për komentimin e kësaj sureje, kushtet dhe rrethanat ishin ato të cilat na vonuan, mirëpo në fund deshi Allahu dhe ia arritëm ta përfundonim.

Nuk do të thotë se ky koment është i përsosur. Jam shumë i bindur se ka të meta në të, por jam munduar që sa më thjesht lexuesit t'i ofrojmë një koment pak më të gjerë, duke përfshirë ajetet me koment – rregullat, dispozitat, shkakun e zbritjes e të tjera si nevoja të komentit.

Sa u përket materialeve ndihmëse gjatë komentit, jam bazuar në librat dhe në tefsiret më të njohura. Vlen të ceket se materiali i përdorur është në gjuhën shqipe dhe arabe..

Materiali në gjuhën shqipe

- 1- Kurani, përkthim me komentim–H. prof. Sherif Ahmedi (Allahu e mëshiroftë).
- 2- Shpjegimi i komentimeve të Kuranit të lartë në gjuhën shqipe i botuar në Daru Es-Selam.
- 3- Kurani i Madhëruar – prof. Hasan Nahi.
- 4- Fjalori i gjuhës së sotme shqipe.

Materiali në gjuhën arabe

1. Tefsir Ibën Kethir – Mektebetul Menar.
2. Tefsir El- Kurtubij Dar Kutub El Ilmije.
3. Tefsir El Begavij – Dar El Marife.
4. Fet-h El Kadir El Mektebetu Et-Tixharije Mekke.
5. Tefsir Et- Tabarij Muessesetu –Er-Risale.
6. Tefsir Es-Sadij – Xhem’ijetu Et Turath El Islamij.
7. Fi Dhilal El-Kuran Sejjid Kutub Daru Eshuruk.
8. Edvaul Bejan – Esh-Shenkitij Darul Kutub El Ilmije.
9. Ejseru Et Tefasir Ebu Bekr El Xhezairij.
10. El Mu’xhem El- mevduij liajatil Kuran – Darul Fadile.
11. El mu’xhem el Mufehehres li elfadh El Kurani El Kerim.
12. Revail Bejan Sabunij Darul Kalem (këtë e kam përdorur në fillim të sures, tek ajetet që flasin për rregullat e zinasë dhe shpifjes, si libër të fikhut e jo më shumë...)

Këto ishin bazat dhe materialet që kam përdorur gjatë komentimit të kësaj sureje. Në fund, nuk mbetet tjetër vetëm se ta falënderoj Allahun që më ka mundësuar ta realizoj një ëndërr të kamotshme.

VE EL HAMDULILAHİ RABİL ALEMIN.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент
Охридски", Скопје
28-23-254
NEZIRI, Llukam
Komenti i sures Nur / autorë Llukam Neziri. - Shkup : Nun, 2022.
176 стр. ; 21 см
Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4955-97-9

а) Куран -- Толкувања
COBISS.MK-ID 56284677